



AUTORITETI I MBROJTJES FINANCIARE

2024

Raport Vjetor

© 2025

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni AMF.

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.

Adresa: Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10, Tiranë

Tel: +355 4 2251 355/6

Faks: +355 4 2250 686

E-mail: amf@amf.gov.al

URL: www.amf.gov.al



Mesazh i Kryetarit të Bordit të AMF-së	5
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	7
Bordi i Autoritetit	8
Përmbledhje Ekzekutive: Zhvillimet Kryesore të Vitit 2024 dhe Sfidat në Vazhdim	10
Roli i Autoritetit në Procesin e Integritimit Evropian	17
Kapitulli 1	
ECURIA E TREGJEVE NËN MBIKËQYRJE	19
1.1 Tregu i Kapitalit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	19
1.2 Tregu i Sigurimeve	23
1.3 Tregu i Fondeve të Pensionit Privat	25
Kapitulli 2	
AKTIVITETI MBIKËQYRËS	26
2.1 Mbikëqyrja e Tregut të Kapitalit e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	26
2.1.1 Pozicioni Financiar	26
2.1.2 Inspektimet	29
2.2 Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve	33
2.2.1 Pozicioni Financiar	33
2.2.2 Inspektimet	44
2.2.3 Mbikëqyrja e Grupeve	45
2.2.4 Provigjonet Teknike	46
2.2.5 Risigurimet	50
2.2.6 Ecuria e Fondit të Kompensimit	53
2.3 Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Pensionit Privat	55
2.3.1 Pozicioni Financiar	55
Kapitulli 3	
AKTIVITETI RREGULLUES DHE LICENCUES	60
3.1 Rregullimi i Tregut të Sigurimeve	60
3.2 Rregullimi i Tregjeve të Fondeve të Pensionit Privat	62
3.3 Rregullimi i Tregjeve të Kapitalit e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	65
3.4 Licencimi dhe Qeverisja	66
3.4.1 Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	66

3.4.2	Tregjet e Kapitalit	69
3.4.3	Tregu i Sigurimeve	69
3.5	Masat Mbikëqyrëse dhe Administrative	73

Kapitulli 4

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL 74

4.1	Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit	74
4.2	Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar	75
4.2.1.	Memorandume Mirëkuptimi gjatë vitit 2024	75
4.2.2.	Bashkëpunime me Autoritete Homologe	76
4.2.3.	Bashkëpunimi me Organizata Ndërkombëtare dhe Rregullatore	77
4.3	Projekte	82
4.4	Bashkëpunimi me Institucionet e Vendit	85

Kapitulli 5

MBROJTJA KONSUMATORE DHE EDUKIMI FINANCIAR 86

5.1	Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit	86
5.2	Monitorimi i Ndërmjetësve Financiarë	88
5.3	Edukimi Financiar dhe Marrëdhëniet me Publikun	89

Kapitulli 6

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL 93

6.1	Burime Njerëzore	93
6.2	Sistemet e Teknologjisë së Informacionit	95
6.3	Auditi i Brendshëm	98

STRATEGJI DHE OBJEKTIVA 98

SHTOJCA

A.	Struktura Organizative e AMF-së	102
B.	Raport i Audituesit të Pavarur	103



I nderuar lexues,

Dëshiroj t'ju prezantoj Raportin Vjetor 2024 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, i cili pasqyron veprimtarinë dhe zhvillimet kryesore në tregjet financiare jobankare gjatë këtij viti, në kuadër të ushtrimit të përgjegjësive ligjore dhe institucionale të Autoritetit.

Viti 2024 u karakterizua nga sfida të vazhdueshme, por edhe nga arritje të rëndësishme në tregjet financiare nën mbikëqyrje. Autoriteti vijoi punën për forcimin e stabilitetit financiar, përafrimin e kuadrit rregullator me standardet evropiane dhe rritjen e mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve.

Hapja e negociatave për grupkapitullin e parë gjatë vitit 2024 shënoi një etapë të rëndësishme në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë. Në këtë kuadër, Autoriteti, në cilësinë e institucionit përgjegjës për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, kontribuoi në mënyrë të vazhdueshme në procesin e përafrimit të kuadrit ligjor dhe rregullator me *acquis* të Bashkimit Evropian.

Ecuria e këtij procesi u reflektua edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2024, ku Shqipëria vlerësohet në një nivel nga i moderuar deri në i mirë përparim në fushën e shërbimeve financiare.

Në fund të vitit 2024, tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit u paraqitën të kapitalizuara dhe me përmirësim të mëtijshëm të treguesve kryesorë të shëndetit financiar. Në tregun e sigurimeve u shënuar rritje e raportit dëme/prime, i cili arriti rreth 41%, si dhe vijoi rënia e dëmeve pezull, objekt i fondit të kompensimit, duke arritur nivelet më të ulëta të vërejtura historikisht. Licencimi dhe hyrja në tregun e sigurimeve të Jetës i një shoqërie të re, pjesë e një grupi ndërkombëtar sigurimi, përbën një zhvillim të rëndësishëm për diversifikimin dhe forcimin e këtij tregu.

Tregjet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondet e pensionit privat vijuan tendencën rritëse, si në drejtim të aktiveve neto, ashtu edhe të numrit të anëtarëve. Gjithashtu, puna për zbatimin e planeve të veprimit të Dokumentit Politik “Për Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit në Shqipëri” vijoi edhe gjatë vitit 2024.

Gjatë vitit 2024, Autoriteti punoi për plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator. Bordi i Autoritetit, në ushtrim të kompetencave të tij kolegjiale, mori 219 vendime, një pjesë e të cilave lidhen me hartimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore. Në këtë kuadër, u miratua projektligji për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit me VKM nr. 862, datë 30.12.2024, si dhe u përgatitën amendimet e ligjit organik për Autoritetin. Në tregun e pensioneve private, u përmbyll procesi i hartimit dhe miratimit të rregulloreve në zbatim të Ligjit nr. 76/2023, duke forcuar transparencën, qeverisjen korporative dhe mbrojtjen e anëtarëve të fondeve të pensionit.

Në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, përafrimi i kuadrit rregullator me direktivat përkatëse evropiane krijoi mundësi më të gjera investimi për qytetarët shqiptarë në fondet e licencuara në Bashkimin Evropian dhe të njohura nga Autoriteti.

Gjatë vitit 2024, Autoriteti miratoi gjithashtu aktin rregullator për tarifimin e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, bazuar në faktorët e riskut, me qëllim rritjen e drejtësisë dhe transparencës në sistemin e tarifimit për konsumatorët.


Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërinstitucional u forcua edhe gjatë vitit 2024, përmes shkëmbimit të informacionit, marrëveshjeve me autoritetet homologe dhe angazhimit aktiv në organizatat ndërkombëtare të mbikëqyrjes. Në këtë kuadër, Shqipëria u përfshi në organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare të rëndësishme në fushën e sigurimeve, duke reflektuar rritjen e rolit të Autoritetit në bashkëpunimin ndërkombëtar.

Raporti Vjetor për vitin 2024 përbën një pasqyrë të veprimtarisë së institucionit dhe të zhvillimeve kryesore në tregjet financiare jobankare, duke shërbyer si bazë referimi për vijimin e punës në përmbushje të misionit dhe objektivave ligjore të Autoritetit.

Ju uroj lexim të këndshëm!

Saimir Tola

Kryetar i Bordit të AMF-së





Misioni dhe Funkcionet e Autoritetit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (Autoriteti) u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si institucion juridik publik, i pavarur në ushtrimin e kompetencave të tij, që raporton në Kuvendin e Shqipërisë.

Ai licencon, rregullon dhe mbikëqyr aktivitetin e tregut të sigurimeve, tregut të letrave me vlerë, tregut të fondeve të pensioneve vullnetare dhe operatorëve të tyre, si dhe veprimtari të tjera financiare jobankare.

Misioni themelor i Autoritetit është të sigurojë funksionimin efektiv të tregjeve financiare jobankare nën mbikëqyrje, si dhe stabilitetin, promovimin dhe zhvillimin e tyre. Përbushjen e misionit të tij, Autoriteti e ushtron me anë të funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës. Objektivi parësor i Autoritetit është mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit. Në ushtrimin e veprimtarisë rregullative dhe mbikëqyrëse, Autoriteti udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, transparencës dhe integritetit.



BORDI I AUTORITETIT

Në vitin 2024, Bordi i Autoritetit përbëhej nga:

Kryetar:	Z. Olsi Çoku,	Kryetar Bordi, Anëtar Joekzekutiv*
Anëtarë:	Zj. Mimoza Kaçi,	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv**
	Zj. Merita Gurabardhi,	Nëndrejtor Ekzekutive***
	Z. Ildir Gjata,	Anëtar Joekzekutiv
	Z. Deniz Deralla,	Anëtar Joekzekutiv

Funksionet dhe kompetencat e Bordit të Autoritetit janë parashikuar në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar. Në zbatim të tij, Bordi miraton politikat dhe strategjitë e zhvillimit të Autoritetit dhe të tregjeve nën mbikëqyrje, si edhe aktet nënligjore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtyre tregjeve, institucioneve e personave që ushtrojnë veprimtari në tregjet financiare jobankare, që mbikëqyren nga Autoriteti.

Gjatë vitit 2024, Bordi ka zhvilluar 13 mbledhje dhe ka marrë 219 vendime. Vendimet që lidhen me tregun e sigurimeve zënë numrin më të madh të vendimeve të miratuara. Në vëmendje të Bordit kanë qenë edhe zhvillimet e tregjeve të tjera, si ai i sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe tregut të titujve, për të cilat janë marrë vendime të rëndësishme.

Duke e cilësuar plotësimin e kuadrit rregullator për tregjet nën mbikëqyrje si një ndër prioritetet e punës së tij, Bordi i Autoritetit ka miratuar 18 rregullore të reja. Gjatë 2024, Bordi miratoi dy memorandume mirëkuptimi me autoritetet mbikëqyrëse homologe si edhe një marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucional.

Tabelë 1: Detajimi i vendimeve të Bordit të Autoritetit gjatë vitit 2024 sipas llojit të vendimit

Llojet e vendimeve	Numër
Vendime për shoqëritë dhe subjekte të tjera që veprojnë në tregun e sigurimeve	132
Vendime për bursën dhe shoqëritë që veprojnë në tregun e titujve	12
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private dhe SIK	23
Vendime për bashkëpunimin institucional	3
Vendime për masa administrative e korigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura	15
Vendime për kuadrin rregullues të Autoritetit dhe tregjeve të mbikëqyrura	34
Vendime në tërësi	219

* Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin Nr. 9/2025, datë 17.02.2025, ka emëruar Z. Saimir Tola në funksionin e Kryetarit të Bordit të Autoritetit.

** Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 102/2025, datë 4 dhjetor 2025, miratoi emërimin e Znj. Adela Xhemali në detyrën e anëtares së Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), e cila do të ushtrojë funksionin e Drejtoreshës së Përgjithshme Ekzekutive.

*** Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin Nr. 76/2024, datë 26.07.2024, ka emëruar Znj. Merita Gurabardhi, në funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv të Autoritetit.



Veprimtaria e Autoritetit gjatë vitit 2024 ka qenë e orientuar drejt prioriteteve dhe objektivave strategjike me qëllim garantimin e stabilitetit financiar, zhvillimin e qëndrueshëm të tregjeve financiare dhe përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullator me acquis të Bashkimit Evropian.

Ecuria e tregjeve nën mbikëqyrje dhe konsolidimi i treguesve financiarë

Tregjet financiare nën mbikëqyrje, në fund të vitit 2024, paraqiten të mirëkapitalizuara dhe me tregues të mirë të shëndetit financiar. Vlera totale e aktiveve arriti në 131 miliardë lekë, me një rritje prej 17%, krahasuar me një vit më parë.

Në tregun e sigurimeve u shënua një përmirësim i mëtejshëm i treguesve financiarë kryesorë që monitorohen nga Autoriteti. Aktivitetet e tregut të sigurimeve u rritën me rreth 6.4 miliardë lekë, ose 12.6% më shumë krahasuar me vitin 2023. Rritje u shënua edhe sa i përket nivelit të provigjoneve teknike me rreth 2.43 miliardë lekë, ose 9.6% më shumë se në 2023, si dhe u përmirësua më tej treguesi kyç i mbulimit të provigjoneve teknike me aktive të përshtatshme. Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve për vitin 2024 u rritën me 7% krahasuar me vitin 2023, duke arritur në rreth 25 miliardë lekë të ardhura. Dëmet e paguara bruto shënuan rritje të konsiderueshme, me 24.5%, krahasuar me vitin 2023, duke arritur në 8.2 miliardë lekë.

Autoriteti ka vijuar monitorimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS), me fokus uljen e mëtejshme të dëmeve pezull objekt i fondit të kompensimit, të cilat u ulën me 18%, duke arritur nivelin më të ulët historik. Gjatë vitit 2024, rezulton se 70% e rasteve të aksidenteve të shkaktuara nga mjetet e pasiguruara apo të paidentifikuara, janë trajtuar dhe paguar me procedura të përshpejtuara, drejtpërdrejt nga shoqëritë e sigurimit. Dëmet e paguara të fondit të kompensimit rezultojnë me një tejkalim prej 45.5% kundrejt fondit të miratuar për vitin 2024, ose rreth 109 milionë lekë më shumë. Gjithashtu, është punuar ngushtësisht me BSHS në zbatim të rekomandimeve të CEFTA-s për të lehtësuar lëvizjen e qytetarëve drejt vendeve kufitare, anëtare të CEFTA-s.

Autoriteti ka monitoruar në vazhdimësi komisionet e ndërmjetësimit për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik, të cilat në nivel tregu zbritën më tej përgjatë vitit 2024 në mesatarisht 15.4%. Rënia e nivelit të komisioneve të ndërmjetësimit dhe shpenzimeve të marrjes në sigurim ka ndikuar në rritjen e likuiditetit të shoqërive të sigurimit.

Raporti Evropian i Aksidenteve rezulton të jetë përdorur në rreth 42.3% të rasteve për dëmet e trajtuara gjatë vitit 2024. Kjo praktikë mundësoi zgjidhjen me marrëveshje mes drejtuesve të mjeteve të përfshira në aksident, në rastet e dëmeve me vlerë deri në 30.000 lekë, duke lehtësuar dhe përshpejtuar procedurat e trajtimit të dëmeve.

Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (SIK) ka treguar qëndrueshmëri gjatë vitit 2024 dhe ka shfaqur tendencë në rritje, si në nivel aktivesh, ashtu edhe sa i përket nivelit të flukseve neto pozitive, kthimit nga investimi dhe numrit të investitorëve.

Totali i aktiveve neto të tregut të SIK arriti në 61.36 miliardë lekë në fund të vitit 2024, me një rritje prej 22% krahasuar me fundvitin e kaluar, si rezultat i rritjes së aktiveve neto të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike. Numri i investitorëve në tregun e fondeve të investimit arriti në 37,786, duke u rritur me rreth 17.4% krahasuar me një vit më parë.

Gjatë vitit 2024, tregu i SIK ka shfaqur zhvillim dhe zgjerim, si edhe rritje të kërkesave për regjistrimin dhe miratimin e formave të reja të fondeve të investimit. Gjatë këtij viti, filluan aktivitetin dy fonde investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, një prej të cilëve është fond me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm si fond furnizues i një fondi kryesor që administrohet nga një shoqëri administruese e licencuar në BE. Gjatë vitit 2024 u regjistruan edhe dy fonde investimi alternative.

Gjithashtu, filluan aktivitetin e marketimit dhe shitjes në Shqipëri edhe gjashtë nënfonde të dy fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të licencuara në BE dhe të njohura nga Autoriteti, duke sjellë risi, për shkak të karakteristikave ESG (mjedisore, sociale dhe të qeverisjes korporative) që mbartin këto fonde.


Tregu i fondeve të pensionit privat ka vijuar tendencën rritëse, sa i përket vlerës së aktiveve neto dhe numrit të anëtarëve. Në fund të vitit 2024, vlera neto e aktiveve të këtij tregu arriti në 8.11 miliardë lekë, me një rritje prej 20.33% krahasuar me fundvitin 2023 dhe numri i anëtarëve arriti në 44,263, duke u rritur me 15.93%.

Në tregun e fondeve të pensionit privat ushtruan aktivitetin e tyre gjashtë fonde pensioni të administruara nga katër shoqëri administruese, të cilat përveç administrimit të fondeve të pensionit janë licencuar për të administruar edhe sipërmarrje të investimeve kolektive.

Investimet e tregut të fondeve të pensionit privat në 31.12.2024 arritën në 7.86 miliardë lekë, me rritje prej 21.31% krahasuar me një vit më parë. Këto investime u përqendruan kryesisht në obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me një peshë prej 96.75% ndaj totalit të aktiveve të tregut të fondeve të pensionit.

Në tregjet e kapitalit, tregu i obligacioneve të emetuara me ofertë private është konsoliduar me rritje të konsiderueshme vit pas viti. Shuma e pashlyer e këtij instrumenti financiar arriti në rreth 28 miliardë lekë në fund të vitit 2024, me një rritje prej rreth 40%.

Krahas transaksioneve në tituj të Qeverisë dhe obligacione korporative vendase, gjatë vitit 2024 vihet re një rritje e veprimtarisë së bankave në tregtimin e instrumenteve financiare të huaja për llogari të klientët, me një vëllim total prej rreth 80 milionë euro.



Procesi i integritit dhe përafrimi i kuadrit ligjor me Bashkimin Evropian

Autoriteti ka dhënë kontribut të vazhdueshëm në procesin e integritit evropian të vendit, si institucion drejtues i Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare” dhe si kontribues në gjashtë kapituj të tjerë të negociatave dhe “Kriterin Ekonomik”, në drejtim të harmonizimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullator me direktivat dhe legjislacionin e BE-së.

Në muajin tetor 2024, Komisioni Evropian publikoi Raportin e Progresit për Shqipërinë, ku vlerësoi progresin e bërë në Kapitullin 9 për shërbimet financiare. Sipas Raportit, Shqipëria paraqitet midis një niveli të moderuar dhe të mirë përgatitjeje në fushën e shërbimeve financiare. Autoriteti vijon të jetë i përkushtuar për harmonizimin e plotë dhe implementimin me sukses të legjislacionit evropian.

Autoriteti, gjatë vitit 2024 ndërmori ndryshimet e nevojshme në Ligjin nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, në zbatim të Planit Kombëtar të Integritit Evropian dhe në kuadër të angazhimit për rritjen e nivelit të përafrimit me Direktivën për Aftësinë Paguese II (Solvency II), si dhe Direktivën “Për Ndërmjetësimin në Sigurime». Në projektligjin e hartuar adresohen rekomandimet e lëna në Raportin e Vlerësimit të Përputhshmërisë së standardeve dhe praktikave të AMF-së, me Parimet Themelore në Sigurime (ICP), kryer nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), në qershor 2023, si dhe çështje të tjera të konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes. Projektligji është miratuar nga Këshilli i Ministrave në mbledhjen e datës 30 dhjetor 2024 dhe është në fazën e shqyrtimit në komisionet parlamentare.

Në zbatim të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit, Autoriteti ka punuar për ndryshime në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të cilat janë dërguar në Ministrinë e Financave për të vijuar më tej me procedurat e miratimit. Me përfundimin e procesit të miratimit të këtyre dy ligjeve, Autoriteti në një hark kohor 5-vjeçar, realizon rishikimin e të gjithë bazës ligjore, që rregullon veprimtarinë e tij dhe të tregjeve nën mbikëqyrje, duke e modernizuar dhe përafruar atë më tej me direktivat evropiane.

Gjatë vitit 2024 u punua për finalizimin e Rregullores nr.156, datë 19.09.2024, “Për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në përlllogaritjen e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e cila hyri në fuqi në 1 janar 2025. Përfshirja e faktorëve të riskut në përlllogaritjen e primeve të sigurimit të detyrueshëm në transport, duke profilizuar primet e sigurimit, mundëson tarifim më të drejtë dhe transparent për konsumatorët, referuar edhe praktikave më të mira të aplikuara në vendet e BE-së.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, Autoriteti filloi punën me hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të tij. Në vitin 2024 u përmbyll me sukses miratimi i të gjithë bazës rregullatore, brenda afateve ligjore.

Autoriteti ka bashkëpunuar me partnerë ndërkombëtarë, në drejtim të krijimit të skemës së kompensimit të investitorëve, si një mekanizëm për mbrojtjen e tyre. Ka përfunduar puna për vlerësimin dhe gjetjen e një modeli të përshtatshëm për krijimin e kësaj skeme në Shqipëri, e cila hedh bazat për hartimin e rregullave për funksionimin efektiv të saj.

Mbështetur në Ligjin 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Autoriteti ka miratuar bazën rregullatore, e cila mundëson marketimin dhe shitjen në Shqipëri të fondeve të investimeve alternative të licencuara në një vend anëtar të BE-së, duke zgjeruar më tej mundësitë e investimit për investitorët shqiptarë.

Zbatimi i standardeve ndërkombëtare në mbikëqyrje

Në fillim të vitit 2024, filloi zbatimi i Udhërrëfyesit drejt regjimit të Aftësisë Pagueuse II (Solvency II), me mbështetjen e projektit të Bankës Botërore “Për Qëndrueshmërinë dhe Zhvillimin Financiar të Shqipërisë,” të financuar nga SECO. Në aktivitetet e organizuara kanë marrë pjesë stafet teknike të Autoritetit, si dhe aktuarë dhe ekspertë të financës nga të gjithë shoqëritë e sigurimit. Këto aktivitete synojnë rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe përgatitjen e tregut të sigurimeve, për një kalim të suksesshëm drejt regjimit mbikëqyrës të Aftësisë Pagueuse II.

Gjithashtu gjatë vitit 2024, Autoriteti dhe përfaqësues të tregut të sigurimeve, kanë përfituar trajnime të dedikuara të organizuara nga partnerët ndërkombëtarë, në kuadër të asistencës teknike për zbatimin e Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF)¹⁷ “Kontratat e sigurimit”, të organizuara me asistencë teknike. Zbatimi i këtij standardi paraqet sfida për shoqëritë që operojnë në tregun e sigurimeve dhe kërkon rritje të kapaciteteve dhe kualifikimeve, si dhe ndërmarrjen e investimeve të nevojshme.

Gjatë vitit 2024 është konsoliduar më tej kuadri rregullator në fushën e tregjeve të kapitalit. Me fillimin e vitit, hyri në fuqi Rregullorja nr.16, datë 28.02.2023, “Për ushtrimin e veprimtarisë operacionale të shoqërive komisionere dhe bankave që ofrojnë shërbime investimi”, e cila vendos kërkesa dhe standarde të përmirësuara për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe ushtrimit të veprimtarisë operacionale të subjekteve, që ofrojnë shërbime investimi, me synim mbrojtjen e investitorit dhe rritjen e besimit të tij në mekanizmat e tregut.

Në janar 2024, filloi gjithashtu zbatimi i Rregullores nr. 197, datë 24.11.2023 “Për formën dhe përmbajtjen e raportimit periodik pranë Autoritetit të shoqërive komisionere/bankave, që ofrojnë shërbime investimi në tituj dhe institucionet e tregut”, e cila vendos standarde raportimi për subjektet, me qëllim rritjen e cilësisë së të dhënave të raportuara dhe përmirësimin e mbikëqyrjes së këtyre subjekteve.



Mbështetja për zhvillimin dhe diversifikimin e tregjeve

Në tregjet e kapitalit, ka avancuar puna me zbatimin e planeve të veprimit të Dokumentit Politik për Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit në Shqipëri, miratuar me VKM nr. 266, datë 27.04.2023. Me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, Autoriteti punoi në drejtim të nxitjes së emetimeve të obligacioneve nga kompanitë me kapital shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore. Progres ka patur edhe në drejtim të përmirësimit ligjor të tregut të instrumenteve financiarë derivativë, ku Autoriteti po bashkëpunon me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, me asistencë teknike të BERZH.

Në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, gjatë vitit 2024, ka patur një zgjerim të mëtejshëm të alternativave investuese në tregun e fondeve të investimit, si dhe janë ofruar produkte financiare me tipare ESG për investitorin shqiptar.

Në dhjetor 2024, Bordi i Autoriteti miratoi licencimin e një shoqërie të re në tregun e Jetës, “Vienna Life Insurance”- “Vienna Sigurim Jetë” sh.a., me aksionarë Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe (VIG) - grup lider i sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore. Me licencimin e kësaj shoqërie arrin në pesë numri i shoqërive të Jetës, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë dhe në 13 numri total i shoqërive të licencuara në tregun e sigurimeve.

Rritja e rolit të Autoritetit në marrëdhëniet ndërkombëtare

Autoriteti ka thelluar komunikimin dhe bashkëpunimin me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, rregullatorët e vendeve të rajonit dhe të BE-së, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave më të mira, në drejtim të rritjes së efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së tregjeve nën mbikëqyrje.

Autoriteti nënshkroi dy Memorandume Mirëkuptimi me autoritetet rregullatore evropiane, me Bankën Kombëtare të Hungarisë dhe me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi (ISA). Këto memorandume synojnë forcimin e bashkëpunimit midis rregullatorëve, me fokus rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) dhe sigurimeve.

Rezultat i vlerësimeve pozitive dhe bashkëpunimit të mirë ndërkombëtar, është edhe mbajtja për herë të parë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajonin e Ballkanit, në vitin 2025, e Konferencës Vjetore të IAIS-it. Kjo është ngjarja më e rëndësishme e vitit në sektorin e sigurimeve, në nivel botëror. Zhvillimi i këtij aktiviteti dëshmon rritje të reputacionit të Autoritetit në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ofron një mundësi të shkëlqyer për forcimin e bashkëpunimit të rregullatorëve të tregut të sigurimeve në nivel global.

Edukimi financiar dhe mbrojtja konsumatore

Gjatë vitit 2024, Autoriteti, në zbatim të strategjisë së tij për edukimin dhe përfshirjen financiare, ka zhvilluar aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e kulturës financiare të publikut, si dhe të njohurive të profesionistëve të tregjeve nën mbikëqyrje. Pjesë e këtyre aktiviteteve ishin leksionet e hapura me studentë, si edhe nisma të tjera në funksion të rritjes së njohurive për sektorin financiar jobankar. Autoriteti bashkëpunoi me “German Sparkassenstiftung Albania” për realizimin e edicionit të katërt të konkursit “Të mësojmë për Bursën”, si instrument për të aftësuar studentët me njohuri praktike mbi funksionimin e tregjeve të kapitalit, mundësitë e investimeve, si edhe mirëplanifikimin financiar. Me hyrjen në fuqi të Ligjit 76/2023 “për Fondet e Pensionit Privat” janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese me përfaqësues të institucioneve publike dhe private, për të prezantuar risitë dhe përfitimet nga pjesëmarrja në skemat e pensioneve private.

Autoriteti ka komunikuar me publikun përmes fushatave mediatike dhe intervistave në median e shkruar dhe atë audiovizive. Gjithashtu, në vijim të publikimeve të materialeve informuese dhe edukuese, në faqen zyrtare të Autoritetit, në një rubrikë të dedikuar, janë publikuar informacione mbi funksionimin e tregut të aseteve virtuale, parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, si edhe masat dhe sanksionet ndërkombëtare nga OKB dhe BE.

Në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe investitorëve, Autoriteti ka avancuar standardet rregullatore, duke rritur kërkesat për transparencë dhe informim. Gjatë vitit 2024, Autoriteti ka vijuar punën për monitorimin në distancë të sjelljes së operatorëve të tregut, si edhe ka realizuar inspektime në vend, pranë subjekteve të tregjeve nën mbikëqyrje. Në fokus të këtyre inspektimeve ka qenë verifikimi i përmbushjes së kërkesave ligjore për informim dhe transparencë ndaj konsumatorit dhe investitorit. Gjithashtu Autoriteti ka qenë i angazhuar në procesin e trajtimit të ankesave të depozituara, duke i dhënë zgjidhje një numri të konsiderueshëm të tyre, në funksion të përmbushjes së objektivit të tij themelor, atë të mbrojtjes së interesave të konsumatorit.

Prioritetet kryesore për periudhën në vazhdim

Veprimtaria e Autoritetit do të mbështetet në strategjinë institucionale dhe dokumentet e tjera strategjike, në funksion të forcimit të stabilitetit financiar, rritjes së efektivitetit të mbikëqyrjes dhe integritetit të tregjeve, përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit me standardet evropiane, zhvillimit dhe modernizimit të tregjeve, mbrojtjes së interesave të konsumatorit dhe investitorit, përmirësimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit, si dhe nxitjes së zhvillimit të financimit të gjelbër.

Gjithashtu, Autoriteti do të vijojë të kontribuojë në nxitjen e stabilitetit financiar, zhvillimit të mëtejshëm të tregjeve financiare jobankare, qëndrueshmërisë së tyre, nëpërmjet forcimit të funksionit të tij rregullator dhe mbikëqyrës, monitorimit të vazhdueshëm të treguesve kryesorë financiarë dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare.



Autoriteti do të vijojë zbatimin e udhërrëfyesit të regjimit mbikëqyrës në sigurime, Solvency II. Një ndër prioritetet e Autoritetit, është zbatimi i plotë i Standardit të ri Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 17 “Kontratat e sigurimit”, me qëllim përgatitjen graduale të tregut të sigurimeve për zbatimin e tij. Në tregun e fondeve të pensionit privat, prioritet mbetet monitorimi i përshtatjes së aktivitetit të shoqërive administruese e depozitarëve të licencuar, si dhe fondeve të pensionit privat, me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Gjithashtu do të synohet që përmes koordinimit ndërinstitucional të avancohet me zbatimin e planit të masave të parashikuara në dokumentin e politikave për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në vend, si një alternativë e qëndrueshme financimi për forcimin e stabilitetit financiar në vend.

Autoriteti, në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian, si institucion drejtues i Kapitullit 9 “Shërbimet financiare”, do të vijojë punën për harmonizimin e legjilacionit vendas me direktivat e BE-së, ku një nga prioritetet do të jetë finalizimi i hartimit të projektligjit, për mbikëqyrjen plotësuese të institucioneve të kreditit, shoqërive të sigurimit dhe shoqërive komisionere, në një konglomerat financiar, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë.

Në tregjet e kapitalit me mbështetje të asistencës teknike do të vijojë puna për përfarimin e legjilacionit vendas me rregulloren më të fundit evropiane “Për Tregjet e KriptoAseteve”, e njohur si MiCA, në bashkëpunim me institucionet e tjera financiare në vend. Gjithashtu do të vlerësohet mundësia për hartimin e një kuadri ligjor për Obligacionet e Mbuluara (Covered Bonds), si dhe për harmonizimin e kuadrit rregullator vendas me atë të BE-së (EMIR), sa i përket infrastrukturës së tregut.

Mbrojtja dhe informimi i konsumatorit dhe investitorit, do të vijojnë të jenë në fokus të veprimtarisë së Autoritetit edhe gjatë periudhës në vazhdim, kjo edhe në zbatim të strategjisë për edukim dhe përfshirje financiare 2023-2027.

Autoriteti, po bashkëpunon me shoqëritë e sigurimit në drejtim të proceseve digjitalizuese të kontratave të sigurimit, proces i cili do të automatizojë dhe lehtësojë lëshimin dhe verifikimin e policave të sigurimit, duke rritur efikasitetin, transparencën dhe sigurinë e të dhënave. Në të njëjtën kohë do të vijojë puna për procesin e digjitalizimit të procedurave të licencimit të agjentëve të tregut të sigurimeve dhe më tej do të vijohet edhe me aktorë të tjerë të këtij tregu.

ROLI I AUTORITETIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN

Viti 2024 rezultoi një vit historik për Shqipërinë në rrugën drejt Bashkimit Evropian, pasi Shqipëria çeli zyrtarisht negociatat me hapjen e grupkapitullit të parë “Themelorët” dhe grupkapitullin e gjashtë “Politikën e jashtme, sigurinë dhe mbrojtjen”.

Me hapjen e negociatave Shqipëria ka marrë miratimin për të nisur bisedimet për anëtarësim, duke bërë një hap të rëndësishëm përpara në procesin e integrimit evropian. Pas hapjes së negociatave Shqipëria duhet të plotësojë disa kushte paraprake dhe të marrë miratimin nga vendet anëtare të BE-së. Monitorimi i progresit në përafrimin dhe zbatimin e *acquis* të BE-së dhe standardeve përkatëse evropiane do të vazhdojë gjatë gjithë periudhës së negociatave.


Gjatë vitit 2024, Autoriteti vazhdoi të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe kontribuoi për Raport Progreset e Komisionit Evropian, Nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri, si dhe për Planin Kombëtar për Integrimin Evropian. Në kuadër të negociatave për anëtarësim në BE, Autoriteti drejton Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare” dhe kontribuon në shumë kapituj të tjerë si pjesë e grupeve ndërinstitucionale.

Në vijim të dërgimit të Raportit Screening nga Komisioni Evropian, përgatitja e pozicionit negociues për grupkapitullin e dytë “Tregu i Brendshëm” ku përfshihet edhe Kapitulli 9 “Shërbimet Financiare”, shënoi një hap të rëndësishëm drejt rrugës së anëtarësimit në BE. Pozicioni negociues përmban të gjitha angazhimet e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së. Shqipëria pranoi të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga *acquis* dhe do t'i kushtojë vëmendje të veçantë përafrimit me *acquis* dhe me standardet evropiane. Autoriteti është i përkushtuar për të fuqizuar kapacitetet institucionale për transpozimin e plotë të legjislacionit të BE-së.

Në fushën e shërbimeve financiare, Shqipëria është e angazhuar për zhvillimin dhe stabilitetin e këtij sektori, duke siguruar një mjedis të favorshëm për rritjen ekonomike dhe mirëqenien sociale. Shqipëria është angazhuar për zbatimin e politikave që nxisin një mjedis të qëndrueshëm dhe të favorshëm për zhvillimin e shërbimeve financiare.

Autoriteti ka ndjekur në vijimësi zbatimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) për periudhën 2024-2026, si dhe ka kontribuar me institucionet e tjera në hartimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) 2025 - 2027. Bashkëpunimi ka vijuar me anëtarët e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE) dhe Platformës së Integritimit Evropian dhe Anëtarësimit (PIEA), për hedhjen e *acquis* të BE-së, pasqyrimin e PKIE 2025-2027 si edhe Paketën Semestrale të Integritimit Evropian (PSIE 2025).

Në këtë kuadër, në takimet e dy Nënkomiteteve përkatësisht të Tregut të Brendshëm dhe Konkurrenca dhe Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat, Autoriteti është përfaqësuar me ekspertë të nivelit të lartë. Në kuadër të përgatitjes së Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2024, janë përgatitur dy kontribute nga institucioni ynë në cilësinë e institucionit drejtues dhe institucionet kontribuuese, për progresin e bërë, sipas pyetjeve të ekspertëve të KE-së, për Kapitullin 9.



Në muajin tetor 2024, Komisioni Evropian publikoi Raportin për Shqipërinë 2024, i cili përshkruan se “Shqipëria ka bërë progres në Kapitullin 9 për shërbimet financiare, ku përfshihen sektori bankar, i sigurimeve, pensioneve private, shërbimet e investimeve dhe tregjet e kapitalit. Shqipëria ndodhet midis një niveli të moderuar dhe të mirë përgatitjeje në fushën e shërbimeve financiare. Ka pasur progres në përafrimin e legjislacionit vendas me *acquis* e BE-së lidhur me mbikëqyrjen, rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme të bankave, si edhe për fondet e pensioneve private”.

Gjithashtu, në zbatim të pikës 8 të rezolutës së Kuvendit “Për Vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare 2023”, ka nisur puna për përafrimin e legjislacionit vendas me *acquis* të Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër, është realizuar një analizë krahasuese e legjislacionit aktual të tregjeve financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, duke e përputhur atë me Rregulloren e Bashkimit Evropian 2023/1114 “Për Tregjet e Kriptoaseteve” (MiCA), e cila vendos rregulla të harmonizuara dhe të qarta për tregun e kriptoaseteve në nivel të BE-së.

Ky proces ka për qëllim krijimin e një kornize ligjore që rregullon veprimtarinë e kriptoaseteve dhe teknologjive të lidhura me to, duke e orientuar legjislacionin vendas në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Përafrimi i legjislacionit në këtë fushë është një nga objektivat kryesore të Strategjisë së Autoritetit për periudhën 2023-2027 dhe synon të krijojë një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm për zhvillimin e tregut të kriptoaseteve në Shqipëri.

Një aspekt i rëndësishëm i këtij përafrimi është rritja e kërkesave prudenciale për ofruesit e shërbimeve të kriptoaseteve, që do të ndihmojë në përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe transparencës së këtij tregu. Po ashtu, një tjetër prioritet i Autoritetit është mbrojtja më e mirë e konsumatorëve, duke siguruar që ata të kenë akses në informacione të plota dhe të qarta për produktet dhe shërbimet e ofruara në këtë sektor. Kjo do të kontribuojë në një sistem financiar më të sigurt dhe të besueshëm, ku veprimtaritë financiare të bazuara në kriptoasete të mund të zhvillohen në një mjedis të mbrojtur dhe të rregulluar siç kërkohet nga rregulloret e BE-së.

Kapitulli 1

Ecuria e Tregjeve nën Mbikëqyrje

1.1 Tregu i Kapitalit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive

Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (SIK) në Shqipëri ka shfaqur qëndrueshmëri dhe rritje gjatë vitit 2024. Ky zhvillim ka qenë evident në rritjen e aktiveve të fondeve të investimeve, flukseve neto pozitive, kthimit nga investimet dhe numrit të investitorëve. Të gjithë këta faktorë pasqyrojnë një interes në rritje dhe besim të fortë në mundësitë e investimit, duke kontribuar në forcimin e sektorit financiar të vendit.

Totali i aktiveve neto të tregut të SIK për periudhën 31.12.2024 arriti në rreth 61.36 miliardë lekë, me një rritje 22.02% krahasuar me vitin 2023, ndikuar kryesisht nga rritja në aktivet neto të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike. Për të njëjtën periudhë, totali i aktiveve neto të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike është në vlerën rreth 55.38 miliardë lekë me një rritje prej 21.83%, krahasuar me fundvitin 2023. Totali i aktiveve neto të fondeve të investimeve alternative në 31.12.2024 është në vlerën 5.98 miliardë lekë me një rritje prej 23.84% krahasuar me fundvitin 2023.

Numri i investitorëve për 31.12.2024 në tregun e fondeve të investimit është 37,786 ku përfshihen edhe shtatë investitorë të fondeve të investimeve alternative. Numri i investitorëve të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike është 37,779 duke shënuar një rritje prej 17.40% gjatë këtij viti.

Gjatë vitit 2024, aktivet e SIK, u administruan nga gjashtë shoqëri administruese, katër prej të cilave kryejnë veprimtarinë e administrimit për SIK edhe për fondet e pensionit privat. Në tregun e SIK, gjatë vitit 2024, ka pasur zhvillime pozitive shoqëruar me rritjen e numrit të fondeve të investimit që kryejnë aktivitetin në treg si dhe rritjen e kërkesave për regjistrimin dhe miratimin e formave të reja të SIK. Gjatë këtij viti, filluan aktivitetin në tregun e SIK dy fonde investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, gjashtë nën fonde të njohura të dy fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të licencuara në BE dhe të njohura nga Autoriteti, si dhe një fond alternativ.

Tregu i fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike dominohet kryesisht nga investimet në obligacione dhe bono thesari të Republikës së Shqipërisë, të cilat përbëjnë 79.24% të aktiveve të këtij tregu.

Në kuadër të respektimit të kërkesave rregullatore për likuiditetin, shoqëritë administruese kujdesen që fondet e investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur, të cilat investojnë në tregje jo aktive, të mbajnë likuiditetin në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ në fuqi.



Tregjet e kapitalit

Gjatë vitit 2024, Autoriteti ka zbatuar një sërë rregulloresh për të siguruar funksionimin e drejtë dhe të integruar të tregjeve të kapitalit. Hyrja në fuqi e Rregullores nr. 16, në janar 2024, ka përafuar më tej kuadrin rregullator me standardet e Bashkimit Evropian, duke vendosur kriteret për organizimin dhe funksionimin e shoqërive komisionere dhe bankave që ofrojnë shërbime investimi, me qëllim mbrojtjen e interesave të investitorëve dhe forcimin e besimit në treg. Po ashtu, me hyrjen në fuqi në vitin 2024 të Rregullores nr. 197, janë përcaktuar standarde për raportimin periodik nga subjektet e tregut të kapitalit, duke përmirësuar mbikëqyrjen dhe cilësinë e të dhënave të raportuara.

Në drejtim të zhvillimit të tregjeve të kapitalit si mundësi financimi dhe investimi, Autoriteti ka avancuar planet e tij të veprimit sipas dokumentit politik "Për krijimin e një mjedisi mundësues për Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit në Shqipëri, 2023-2027" miratuar me VKM nr. 266, datë 27.04.2023. Në veçanti me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë është punuar për nxitjen emetimit të obligacioneve nga kompanitë shtetërore dhe njësitë e qeverisjes lokale. Gjithashtu, janë bërë hapa për zhvillimin e tregut të instrumenteve financiare derivative, nëpërmjet një projekti të përbashkët me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, me asistencë nga BERZH.

Në kuadër të integritimit në BE, Autoriteti ka bashkëpunuar me organizma ndërkombëtarë për përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor me direktivat e BE-së, duke përfunduar punën për vlerësimin e mundësisë së krijimit të një skeme kompensimi për investitorët, si një mekanizëm mbrojtës për ta.

Në tregjet e kapitalit, gjatë vitit 2024, ushtruan veprimtarinë e tyre subjektet e mëposhtme:

- 11 subjekte, nga të cilat 9 banka për ofrimin e shërbimeve të investimit dhe shërbimit ndihmës të kujdestarisë, 2 shoqëri komisionere;
- 1 Bursë titujsh;
- 1 Regjistrar Titujsh dhe Depozitar Qendror Titujsh, i cili krahas shërbimit të regjistrimit kryen edhe shërbimin e klerimit dhe shlyerjes së titujve.

Tabelë 2: Pjesëmarrës dhe subjekte të tregut të kapitaleve, dhjetor 2024

(Në numër)

Shoqëri Komisionere/Banka	Banka që ofrojnë shërbimin e kujdestarisë të titujve	Banka që ofrojnë shërbimin e administrimit të portofolit
11	9	1
Banka që ofrojnë shërbimin e këshillimit dhe dhënies së rekomandimeve për investime	Banka që ofrojnë shërbimin e nënshkrimit të instrumentave financiare	Banka që ofrojnë shërbimin e investimit <i>online</i>
1	2	2
Emetues të Obligacioneve me Ofertë Private	Bursë Titujsh (Tregu i Rregulluar)	Depozitar Qendror Titujsh
Emetues me Ofertë Private 12 Emetues me Ofertë Publike 1	1	1

Tregu i titujve të Qeverisë jashtë tregut të rregulluar (Bursës)


Tregu i titujve të Qeverisë Shqiptare mbetet segmenti më i madh dhe aktiv që mbizotëron në tregjet e kapitalit. Titujt e qeverisë tregtohen në Bursën Shqiptare të Titujve dhe në tregun jashtë Bursës, i organizuar në formën e tregut mbi banak (OTC). Vëllimi i përgjithshëm i transaksioneve të realizuara në tregun e titujve të Qeverisë jashtë Bursës në emër dhe për llogari të klientit, në vitin 2024, arriti në rreth 109.5 miliardë lekë. Sipas të dhënave statistikore të Autoritetit për periudhën janar-dhjetor 2024, në tregun e titujve të Qeverisë jashtë Bursës, dominojnë: transaksioni “Blerje në tregun primar”, i cili përbën rreth 50.10% të vëllimit të përgjithshëm të transaksioneve, dhe transaksioni “Shlyerje e vlerës nominale në maturim”, i cili përbën rreth 36.72% të vëllimit të përgjithshëm të transaksioneve. Përsa i përket aktivitetit në tregun sekondar, ai përbën rreth 11.5% të totalit të transaksioneve të kryera në këtë treg.

Gjatë vitit 2024, vëllimi i blerjeve nga klientët në tregun primar të titujve të Qeverisë jashtë tregut të rregulluar (Bursës), nëpërmjet subjekteve banka të licencuara arriti në 54.8 miliardë lekë, me një rritje prej 36.75% në krahasim me vitin 2023. Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë jashtë Bursës, për vitin 2024 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 97.48% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Që prej vitit 2024, të dhënat e raportuara nga subjektet që veprojnë në tregjet e kapitalit janë kryer sipas formateve standarde të raportimit, në përputhje me terminologjinë e re, sipas Ligjit nr.62/2020 “ për Tregjet e Kapitalit”. Në linjë me këtë terminologji janë përshtatur edhe raportet e nxjerra nga Autoriteti mbi bazën e informacionit të standardizuar të marrë nga subjektet raportuese për efekt të mbikëqyrjes së tregut dhe statistikave.

Grafik 1: Transaksione në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë, 2024

(Në %)






Në totalin e transaksioneve të llojit B, C dhe F të marra së bashku për vitin 2024, vihet re një rritje në vlerë absolute me rreth 5,038 milionë lekë, krahasuar me vitin 2023. Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për vitin 2024, ndryshe nga viti paraardhës (ku dominohej nga bonot e thesarit), pësoi një ndryshim dhe u dominua në masën 64.17% nga transaksione në instrumente afatgjatë (obligacione) dhe 35.83 % nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari). Normat e interesit që ofrojnë obligacionet janë faktori kryesor në rritjen e volumit për tregun sekondar.

Grafik 2: Vëllimi i tregtimit në tregun sekondar sipas llojit të titujve, 2024

(Në %)



Transaksionet në instrumente financiare të huaja

Me zgjerimin e licencës për ofrimin e shërbimeve të investimit dhe instrumenteve financiare përtej titujve të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, bankat kanë shtrirë aktivitetin e tyre, duke u ofruar klientëve mundësi investimi në një gamë më të gjerë instrumentesh financiare ndërkombëtare. Kjo përfshin edhe Eurobondin e Republikës së Shqipërisë, duke mundësuar diversifikimin e portofolieve të investimeve të klientëve të tyre.

Në vitin 2024, vëllimi total i tregtimit në instrumente financiare të huaja, arriti në rreth 80 milionë Euro. Të dhënat e raportuara nga subjektet tregojnë një dominim të dukshëm të instrumentit obligacion, i cili zë 95% të totalit të tregtimit në tituj të huaj.

Gjatë vitit 2024 janë tregtuar gjithashtu aksione si dhe produkte të strukturuar, të cilat përbëjnë respektivisht 1% dhe 4% të vëllimit total të tregtimit në tituj të huaj. Investitorët kryesorë në titujt e huaj janë individë, si dhe një numër i vogël investitorësh profesionistë dhe investitorësh të kualifikuar. Përveç investitorëve rezidentë, vihet re një rritje e interesit dhe aktivitetit edhe nga klientë jo-rezidentë, të cilët gjatë vitit 2024 përbënin rreth 6% të totalit të investitorëve në tregun e titujve të huaj.

1.2 Tregu i Sigurimeve

Gjatë vitit 2024, në tregun e sigurimeve ishin të licencuara gjithsej 13 shoqëri sigurimi, nga të cilat 12 ishin aktive dhe operonin në treg. Shoqëria e 13, e cila mori licencën në dhjetor të vitit 2024, u autorizua për të ushtruar veprimtarinë e sigurimit të Jetës. Aktiviteti i kësaj shoqërie ka filluar në vitin 2025, duke pasuruar kështu ofertën e tregut të sigurimeve dhe duke kontribuar në zhvillimin e këtij sektori. Ky zhvillim është një tregues i forcimit të tregut të sigurimeve në Shqipëri, duke ofruar më shumë mundësi për konsumatorët dhe duke rritur konkurrencën në sektorin e sigurimeve të Jetës.


Vëllimi i primeve të shkruara bruto arriti në rreth 25 miliardë lekë duke pësuar një rritje me rreth 7.01% krahasuar me vitin 2023. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto u rritën si në aktivitetin e Jetës ashtu dhe në atë të Jo-Jetës.

Gjatë vitit 2024, në aktivitetin e Jetës, primet e shkruara bruto u rritën me 10.2% krahasuar me vitin 2023. Rritja e të ardhurave erdhi kryesisht nga portofoli i sigurimit të Jetës së debitorit.

Në sigurimin e Jo-Jetës, primet e shkruara bruto, në vitin 2024 u rritën me 6.63% krahasuar me vitin 2023. Rritja e të ardhurave erdhi kryesisht nga portofoli i sigurimit të detyrueshëm motorik.

Grafik 3: Ecuria e primit të shkruar bruto në vite


(Në mln. lekë)





Grafik 4: Ndarja e primit të shkruar bruto, sipas llojit të sigurimit, viti 2024


(Në %)



Totali i dëmeve të paguara bruto për vitin 2024 arriti në 8 miliardë lekë, me një rritje prej 24.53%, krahasuar me vitin 2023. Dëmet e paguara në sigurimin e Jo-Jetës kapën shifrën 7.9 miliardë lekë, ndërsa në sigurimet e Jetës dëmet e paguara ishin rreth 334 milionë lekë. Pjesa tjetër prej rreth 463 milionë lekë të dëmeve të paguara i përkasin dëmeve të Fondit të Kompensimit dhe dëmeve të paguara si sigurues i drejtpërdrejtë.

Grafik 5: Ecuria e dëmeve të paguara bruto në vite

(Në mln. lekë)



1.3 Tregu i Fondeve të Pensionit Privat

Gjatë vitit 2024 tregu i fondeve të pensionit privat ka vijuar tendencën në rritje, si në aspektin e kontributeve të derdhura, të aktiveve nën administrim, në numrin e anëtarëve ashtu edhe në vlerën neto të aktiveve për kuotë, për secilin prej fondeve të pensionit.

Në tregun e fondeve të pensionit privat ushtruan aktivitetin e tyre gjashtë fonde pensioni, të administruara nga katër shoqëri administruese. Këto shoqëri, krahas administrimit të fondeve të pensionit, janë licencuar të administrojnë dhe sipërmarrje të investimeve kolektive. Edhe pse tregu ka pasur një ecuri pozitive, rritja e pjesëmarrjes në tregun e fondeve të pensioneve private mbetet një sfidë për zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori. Angazhimi për rritjen e pjesëmarrjes dhe përmirësimin e ofertës do të jetë thelbësor për të përballuar këtë sfidë dhe për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të tregut të pensioneve private në Shqipëri.

Viti 2024 ishte një vit i rëndësishëm pasi brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e Ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, Autoriteti përfundoi me sukses hartimin dhe miratimin e të gjitha akteve nënligjore në zbatim të tij.



2.1 Mbikëqyrja e Tregut të Kapitaleve dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive


Tregu i Fondeve të Investimit me Pjesëmarrje të Hapur me Ofertë Publike

2.1.1 Pozicioni financiar

Gjatë vitit 2024, në tregun e SIK ushtruan aktivitetin e tyre trembëdhjetë fonde investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike. Këto fonde investimesh janë administruar nga gjashtë shoqëri administruese, katër nga të cilat krahas administrimit të SIK kryejnë edhe veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat.

Aktivet neto të tregut të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike janë në vlerë 55.38 miliardë lekë në 31.12.2024, me një rritje rreth 9,9 miliardë lekë, ose 21.83%, krahasuar me vitin 2023. Në 31.12.2024 numri i investitorëve në fondet e investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike është 37,779 duke shënuar një rritje prej 17.40% gjatë këtij viti.

Grafik 6: Aktivitet neto të tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike
(Në mln. lekë)



Investimet e tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike konsistojnë në obligacione qeveritare brenda dhe jashtë R.SH, bono thesari të Qeverisë së R.SH., obligacione të shoqërive brenda dhe jashtë vendit, kuota në fonde investimi si dhe aksione në shoqëri të huaja.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ecuria e portofolit të tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, sipas periudhave tremujore, për vitin 2024.

Tabelë 3: Të dhëna mbi portofolin e fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, sipas periudhave tremujore, 2024 (Në mln. lekë)

Përshkrimi	Vlera			
	31.03.2024	30.06.2024	30.09.2024	31.12.2024
Periudha				
Asetet neto të fondeve	46,844	48,357	51,002	55,378
Totali i aseteve të fondeve	46,948	48,459	51,200	55,466
nga të cilët:				
Obligacione Qeveritare (vendase dhe të huaja)	29,274	31,104	34,271	36,946
Obligacione të Shoqërive	483	571	571	600
Bono Thesari	8,249	9,747	9,171	7,810
Investime në kuota të fondeve të investimit	1,102	1,162	1,333	1,498
Aksione në shoqëri të huaja	507	513	522	574
Mjete Monetare	6,879	4,791	4,968	7,354
Asete të tjera	355	571	364	684
Totali i Detyrimeve të Fondeve	104	102	199	88

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ndryshimi i portofolit të tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike gjatë vitit 2024 kundrejt vitit 2023, si dhe pesha që zë secili nga instrumentet financiarë të portofolit në totalin e aktiveve në vitin 2024 dhe në vitin 2023.

Tabelë 4: Ndryshimi në përbërjen e portofolit të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, 31.12.2023 - 31.12.2024

Përshkrimi	Vlera (Në mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)	Pjesa ndaj totalit (Në %)	
	31.12.'23	31.12.'24	31.12.'23 31.12.'24	31.12.'23	31.12.'24
Asetet neto të fondit	45,455	55,378	21.83		
Totali i aseteve të fondeve	45,557	55,466	21.75	100	100
nga të cilët:			25.53	64.60	
Obligacione Qeveritare (të R.SH. dhe të huaja)	29,432	36,946	8.98	1.21	66.61
Obligacione të Shoqërive	551	600	16.64	14.70	1.08
Bono Thesari	6,696	7,810	41.86	2.32	14.08
Investime në kuota të fondeve të investimit	1,056	1,498	23.84	1.02	2.70
Aksione në shoqëri të huaja	464	574	7.96	14.95	1.04
Mjete Monetare	6,812	7,354	24.99	1.20	13.26
Asete të tjera	547	547	11.67	1.17	1.20
Totali i Detyrimeve të Fondeve	102	88	-13.63	0.22	0.16



Grafik 7: Struktura e aktiveve të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike 31.12.2023 (Në %)




Grafik 8: Struktura e aktiveve të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike 31.12.2024 (Në %)



Në kuadër të respektimit të kërkesave të rregullores së likuiditetit, shoqëritë administruese kujdesen që fondet e investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, të cilat investojnë në tregje jo aktive, të mbajnë likuiditetin në përputhje me kërkesat rregullatore në fuqi.

Siç shihet në grafikun e mëposhtëm për 31.12.2024, investimet e tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në instrumente financiarë: tituj borxhi, mjete monetare e depozita, kuota të fondeve të investimit me maturim deri në një muaj, janë 18.35%.

Grafik 9: Shpërndarja e maturimit të mbetur të instrumenteve financiare tregut të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike 31.12.2024 (Në %)



2.1.2 Inspektimet

Gjatë vitit 2024, Autoriteti ka kryer pesë inspektime tematike në vend pranë njësive të depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe të fondeve të pensionit privat. Objekti i këtyre inspektivave ishte vlerësimi i zbatimit të bazës ligjore dhe rregullatore në fuqi në lidhje me kryerjen e procedurave operacionale për fondet e investimit dhe fondet e pensionit privat për të cilat kryhet funksioni i depozitarit.

Në këto inspektime, vëmendja u përqendrua në veçanti në çështje që lidhen me verifikimin e praktikave të ndjekura mbi rakordimet ditore dhe mujore, pagesat e kontributeve nga anëtarët e fondit të pensionit, pagesat e investitorëve të fondeve të investimit, shlyerjet e kuotave, investimet në tituj, komunikimi me shoqëritë administruese, zbatimi i metodologjisë së vlerësimit të aktiveve dhe raportet më të fundit të kontrollit të brendshëm të bankës për njësinë e depozitarit. Gjithashtu, u vlerësua edhe zbatimi i bazës ligjore dhe rregullatore në fuqi në kryerjen e aktivitetit të depozitarëve në lidhje me SIK dhe fondet e pensionit privat për të cilat kryejnë aktivitetin e depozitarit.

Autoriteti pas çdo inspektimi ka paraqitur rekomandimet përkatëse, për të cilat depozitarët kanë marrë masa për zbatimin e tyre.



Tregjet e Kapitalit

Rritja e rolit mbikëqyrës të Autoritetit në tregjet e kapitalit, gjatë vitit 2024 u shoqërua me fillimin e zbatimit të akteve të reja nënligjore, të përafuara me direktivat evropiane të fushës, të cilat vendosin standarde monitoruese dhe mbikëqyrëse për të gjithë subjektet nën mbikëqyrje. Gjithashtu, me përfundimin e procesit të përshtatshmërisë së subjekteve që veprojnë në tregjet e kapitalit me kërkesat e Ligjit nr. 62/2020, Autoriteti gjatë vitit 2024 vijoi me inspektimet në vend, për të siguruar që veprimtaria e ushtruar nga subjektet është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Tregu i rregulluar – Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE

Që prej fillimit të aktivitetit të Bursës Shqiptare të Titujve, ALSE, në shkurt të vitit 2018, deri në dhjetor të vitit 2024 në Bursë është realizuar një vëllim tregtimi prej rreth 4.2 miliardë lekë, prej të cilave 537.9 milionë lekë i përkasin vëllimit të tregtimit të realizuar përgjatë vitit 2024.

Me fillimin e aktivitetit dhe në vazhdimësi, në Bursën ALSE janë tregtuar tituj të qeverisë shqiptare, dhe për herë të parë, në vitin 2023 u pranuan për tregtim obligacionet e një institucioni financiar jo bankë të emetuara me ofertë publike. Përgjatë vitit 2024, në Bursë është realizuar një vëllim tregtimi prej 461 milionë lekë në tituj të Qeverisë Shqiptare, dhe 76.9 milionë lekë në obligacionin korporativ. Në totalin e transaksioneve të kryera me titujt e Qeverisë Shqiptare gjatë vitit 2024 dominuan transaksionet në obligacione thesari, si dhe transaksionet e kryera për llogari të klientëve, persona juridikë.

Tabelë 5: Ecuria në vite e vëllimit të tregtimit në bursë

(Në mln. lekë)

	2020	2021	2022	2023	2024
Vëllimi i tregtimit në bursë	452	3.03	348.2	35.1	537.9

Rritja e vëllimit të tregtimit në vitin 2024, në krahasim me vitin 2023, vjen si rezultat i rritjes së transaksioneve të realizuara në Bursë me titujt e Qeverisë Shqiptare, për llogari të individëve dhe personave juridikë. Gjithashtu, në këtë rezultat ka ndikuar edhe rritja e tregtimit të titullit korporativ në Bursë, vëllimi i tregtimit të të cilit është rritur me rreth 150% krahasuar me një vit më parë. Bursa Shqiptare e Titujve numëron aktualisht tre anëtarë (banka), të cilët kryejnë transaksione për llogari të portofolit të tyre dhe për llogari të klientëve.

Infrastruktura e pastregtimit

Infrastruktura e pastregtimit ka filluar të funksionojë plotësisht në mars 2021, me pranimin e shoqërisë “Regjistri Shqiptar i Titujve, ALREG”, si pjesëmarrës indirekt në sistemin AIPS të Bankës së Shqipërisë, i cili është një sistem pagesash ndërbankare me vlerë të madhe. Ky anëtarësim i ALREG në sistemin AIPS mundëson finalizimin e procesit të shlyerjes së transaksioneve me tituj.


ALREG ka regjistruar obligacione të emetuara me ofertë private dhe disa aksione. Me miratimin e ofertës së parë publike në 2023, ALREG ka regjistruar dhe ka kryer me sukses funksionin e klerimit dhe shlyerjes së obligacioneve korporative të emetuara nga një institucion financiar jo bankë. Shoqëria ALREG, që prej licencimit të saj në vitin 2019, ka regjistruar 37 emetime të obligacioneve me ofertë private, me një vlerë prej rreth 27.2 miliardë lekë, në 3 monedha, ALL, EUR, USD. Gjatë vitit 2024, ALREG ka regjistruar 9 emetime në shumën rreth 9.76 miliardë lekë. Obligacione të emetuara përmes ofertës publike të regjistruara në ALREG janë në vlerën 500 milionë lekë; ndërsa totali i aksioneve të regjistruara rezultojnë 14.86 miliardë ALL, në fund të vitit 2024. Aksionet e regjistruara pranë ALREG janë në monedhën ALL dhe USD.


Tregu i obligacioneve me ofertë private

Tregu i obligacioneve të emetuara me ofertë private, është konsoliduar me rritje të konsiderueshme vit pas viti. Shuma e pashlyer e këtij instrumenti financiar arriti në rreth 28 miliardë lekë në fund të vitit 2024, nga rreth 20 miliardë lekë në fund të vitit 2023, me një rritje prej rreth 40%.

Aktualisht në treg janë 12 emetues aktivë të obligacioneve me ofertë private, nga të cilët 7 banka, 3 institucione mikrokredie dhe 2 shoqëri tregtare. Gjatë vitit 2024, Autoriteti ka regjistruar 7 akt-oferta të përgatitura nga 5 emetues (4 banka dhe 1 institucion mikrokredie). Bankat kanë vijuar të jenë emetuesit më të shpeshtë për qëllim të kapitalit rregullator.

Grafik 10: Gjendja e pashlyer e obligacioneve të emetuara me ofertë private (Në mln. lekë)





Tregu i obligacioneve me ofertë publike

Gjatë vitit 2024 obligacionet e emetuara nëpërmjet ofertës publike, në shumën 500 milionë lekë, me afat 5 vjet, të institucionit financiar jo bankë, janë tregtuar në Bursën Shqiptare të Titujve, ALSE, nëpërmjet anëtarëve të saj për llogari të klientëve.

Inspektimet

Në tregjet e kapitalit, Autoriteti gjatë vitit 2024, ka kryer tre inspektime në vend pranë bankave që ofrojnë shërbime investimi në tituj në emër të klientit. Objekt i këtyre inspektimeve ka qenë vlerësimi i përputhshmërisë me rregullat dhe standardet e përcaktuara, duke siguruar që këto institucione të veprojnë në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatorët për të mbrojtur interesat e investitorëve dhe të ruajnë integritetin e tregjeve të kapitalit. Me konkretisht objekti i këtyre inspektimeve përfshin:

- Vlerësimin e veprimtarisë dhe respektimin e kërkesave ligjore e rregullatore për shërbimin e marrjes dhe transmetimit të urdhrave, si dhe ekzekutimit të urdhrave në emër të klientëve;
- Verifikimin e procedurave për kryerjen e shërbimit ndihmës të ruajtjes dhe administrimit të instrumenteve financiare në emër të klientëve (shërbimi i kujdestarisë), si dhe
- Zbatimin e procedurave për certifikimin e personave kyç.

Autoriteti po vijon punën për ndjekjen dhe monitorimin e përmbushjes së rekomandimeve të lëna, për subjektet nën mbikëqyrje.

2.2 Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve

2.2.1 Pozicioni financiar

Gjatë vitit 2024, Autoriteti ka mbikëqyrrur dhe ndjekur në vijimësi dinamikën e tregut të sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar të shoqërive të sigurimit në nivel individual dhe në tërësi për të gjithë tregun. Gjithashtu, Autoriteti ka vazhduar monitorimin e përmbushjes së kërkesave ligjore për treguesit ligjore financiare si dhe Fondin e Garancisë të shoqërive të sigurimit, zbatimin e rregullave për investimin e këtij fondi, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore.

Tabelë 6: Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve, Aktivët*

(Në mln. lekë)

	31.12' 20	31.12' 21	31.12' 22	31.12' 23	31.12' 24*
Totali i aktiveve	38,865	40,571	43,550	50,636	57,028
Jeta	4,814	5,075	5,264	5,662	6,511
Jo-Jeta	34,051	35,496	38,286	44,975	50,517
Totali i investimeve	25,029	27,585	30,575	36,890	42,205
Jeta	4,258	4,401	4,473	4,823	5,406
Jo-Jeta	20,770	23,184	26,102	32,068	36,800

Në aktivet e tregut të Jo-Jetës nuk janë të përfshira investimet në kapital të shoqërisë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. tek Sigal Life UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a., Eurosig sh.a. tek Insig sh.a. dhe Insig Jetë Sh.a., dhe Albsig sh.a. tek Albsig Jetë Sh.a.

**Vlerat për periudhën 31.12.2024, i referohen pasqyrave financiare të audituara të shoqërive të sigurimit.*


Në 31.12.2024, totali i aktiveve të tregut të sigurimeve është rreth 57 miliardë lekë, ku 88.6% e totalit të aktiveve zotërohen nga shoqëritë e tregut të Jo-Jetës dhe 11.4% i përket shoqërive të tregut të Jetës. Për këtë periudhë, aktivet kanë pësuar një rritje prej 6.4 miliardë lekë, ose 12.6% krahasuar me 31.12.2023.

Rritja e totalit të aktiveve është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorit të Jo-Jetës, me rreth 5.4 miliardë lekë, ose 11.99% më shumë, krahasuar me 31.12.2023. Edhe sektori i Jetës ka pësuar rritje të totalit të aktiveve me rreth 396 milion lekë, ose 6.99% krahasuar me 31.12.2023. Kjo rritje për të dy sektorët ka ardhur si rezultat i performancës financiare pozitive të shoqërive të sigurimit gjatë vitit 2024 dhe rritjes së zërit të investimeve.



Grafik 11: Totali i aktiveve për tregun Jo-Jetë, Jetë në vite*

(Në mln. lekë)



*Vlerat për periudhën 31.12.2024 i referohen pasqyrave financiare të audituara të shoqërive të sigurimit.


Për sektorin e Jo-Jetës, rritja e aktiveve ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e rritjes së zërit “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare” me rreth 4.7 miliardë lekë, ose 15% më shumë krahasuar me 31.12.2023.

Për sektorin e Jetës, rritja e aktiveve ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e rritjes së zërit “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare” me rreth 583 milionë lekë, ose 12% më shumë krahasuar me 31.12.2023.

Për tregun e sigurimeve në tërësi, edhe në 31.12.2024 investimet kanë vijuar të dominojnë totalin e aktiveve, me vlerë 42.2 miliardë lekë, duke zënë 74% të totalit të tyre. Rritja e investimeve krahasuar me vitin paraardhës është rreth 5.3 miliardë lekë ose 14.4% më shumë.

Grafik 12: Totali i investimeve për tregun Jo-Jetë, Jetë në vite*

(Në mln. lekë)




*Vlerat për periudhën 31.12.2024 i referohen pasqyrave financiare të audituara të shoqërive të sigurimit.

Zhvillimet kryesore në strukturën e aktiveve për të dy sektorët e tregut të sigurimeve, krahasuar me 31.12.2023, paraqiten si vijon:

- Depozitat vazhdojnë të zënë peshën kryesore të aktiveve me 33%, ndjekur nga zëri “Toka dhe ndërtesa” dhe “Bono thesari dhe obligacione”, përkatësisht me rreth 14% dhe 11.7%.
- Krahasuar me 31.12.2023, depozitat janë rritur me 3 miliardë lekë, ose 19%. Zëri debitorë në 31.12.2024 paraqitet me rënie prej 1.78%, ose rreth 59 milionë lekë kundrejt 31.12.2023, ndikuar nga rënia e debitorëve të tregut të Jo-Jetës në masën 1.9%, ose 58 milionë lekë.

Grafik 13: Struktura e Aktivit për tregun e sigurimeve 2020-2024*

(Në %)



* Vlerat për periudhën 31.12.2024 i referohen pasqyrave financiare të audituara të shoqërive të sigurimit.



Tabelë 7: Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve, Pasivi*


(Në mln. lekë)

	31.12.'20	31.12'21	31.12'22	31.12'23	31.12'24
Totali i Pasivit	38,865	40,571	43,550	50,636	57,028
Jetë	4,814	5,075	5,264	5,662	6,511
Jo-Jetë	34,051	35,496	38,286	44,975	50,517
Provizjonet teknike bruto	20,986	22,020	23,690	25,307	27,739
Jetë	2,031	2,236	2,414	2,490	2,721
Jo-Jetë	18,956	19,783	21,276	22,817	25,018
Totali i kapitaleve të veta	12,651	13,059	13,680	17,280	20,274
Jetë	2,419	2,454	2,366	2,713	3,309
Jo-Jetë	10,232	10,605	11,314	14,567	16,965
Totali i kapitalit të nënshkruar	7,473	7,743	7,783	9,542	11,243
Jetë	1,882	1,882	1,882	1,891	2,359
Jo-Jetë	5,591	5,861	5,901	7,651	8,884**
<p>* Në pasivet e tregut të Jo-Jetës nuk janë të përfshira investimet në kapital të shoqërisë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. tek Sigal Life UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a., Eurosig sh.a. tek Insig sh.a. dhe Insig Jetë sh.a., dhe Albsig sh.a tek Albsig Jetë sh.a.</p> <p>*Vlerat për periudhën 31.12.2024 i referohen pasyrave financiare të audituara të shoqërive të sigurimit.</p> <p>** Kërkesa për rritjen e kapitalit të një shoqërie sigurimi Jo-Jetë është në proces shqyrtimi nga Autoriteti.</p>					

Struktura e pasiveve të tregut të sigurimeve vijon të dominohet nga zërat e provigjoneve teknike me 48.6%, si dhe “Kapitalet e veta”, të cilat përfaqësojnë interesin e mbetur në aktivet e shoqërisë, pas zbritjes së të gjitha detyrimeve me 35.6%, ndërkohë që pjesa tjetër e pasivit janë detyrimet e tjera me rreth 15.8%. Rritja e totalit të pasiveve për tregun e sigurimeve gjatë vitit 2024 është ndikuar kryesisht nga rritja kapitaleve të veta të shoqërive, me rreth 3 miliardë lekë, ose me rreth 17.3%, si efekt i rritjes së fitimeve të mbartura si dhe rritjes së kapitalit aksionar nga dy shoqëri Jo-Jetë.

Grafik 14: Struktura e Pasivit për tregun e sigurimeve*


(Në %)



*Vlerat për periudhën 31.12.2024 i referohen pasqyrave financiare të audituara të shoqërive të sigurimit.

Aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në 31.12.2024 për tregun e sigurimeve janë në vlerën 34.8 miliardë lekë, nga të cilat 31.4 miliardë lekë janë aktive të tregut të sigurimit të Jo-Jetës dhe rreth 3.5 miliardë lekë aktive të tregut të sigurimit të Jetës. Treguesi i mbulimit të provigjoneve teknike me aktive të përshtatshme për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, në këtë periudhë është ulur në nivelin 125.39%, nga 150% që ishte në 31.12.2023. Ndërsa për shoqëritë e sigurimit të Jetës, mbulimi i provigjoneve matematike në 31.12.2024 rezulton 127.29% nga 129.64% që ishte në 31.12.2023.

Grafik 15: Struktura e aktiveve* në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike (Në %)



*Vlerat për periudhën 31.12.2024 i referohen pasqyrave financiare të audituara të shoqërive të sigurimit




Rezultati financiar

Gjatë vitit 2024, tregu i sigurimeve ka pasur një rezultat financiar pozitiv, por me rënie krahasuar me vitin 2023. Në tërësi rezultati financiar për 31.12.2024 ka rezultuar në vlerën 2.3 miliardë lekë. Respektivisht tregu i Jo-Jetës ka rezultuar me 2.01 miliardë lekë fitim dhe tregu i Jetës me 265 milionë lekë fitim.

Rezultati financiar në tregun e Jo-Jetës për vitin 2024 është ndikuar kryesisht nga rritja e primeve të shkruara bruto, të cilat kanë qenë në nivelin 21 miliardë lekë në 31.12.2023 dhe kanë arritur në 22.4 miliardë lekë në 31.12.2024 (pra rritje me 1.4 miliardë lekë), ndërkohë që shpenzimet operative kanë një rritje prej 1.03 miliardë lekë krahasuar me vitin e kaluar, gjë që ka ndikuar në uljen e rezultatit financiar. Të ardhurat nga investimet kanë patur ecure pozitive dhe kanë rezultuar në vlerën 950.4 milionë lekë, ndikuar kryesisht nga rritja e normave të interesit, dividendët, etj. Ndikim ka patur edhe kursi i këmbimit, i cili është reflektuar në uljen humbjeve nga investimet. Edhe pse kursi i këmbimit rezulton me rënie nga viti 2023, rënia nuk ka qenë aq e ndjeshme sa në vitin 2024 krahasuar me 2023.

Edhe në tregun e Jetës rezultati financiar, është ndikuar nga rritja e primeve të shkruara bruto, të cilat për vitin 2024 kanë qenë në nivelin 2.1 miliardë lekë, por si efekt i rritjes së shpenzimeve operative, rezultati financiar krahasuar me vitin 2023 është ulur.

Grafik 16: Rezultati financiar për tregun e sigurimit të Jo-Jetës dhe Jetës* (Në mln. lekë)




*Vlerat për periudhën 31.12.2024 i referohen pasqyrave financiare të audituara të shoqërive të sigurimit.

Raporti dëme/prime: Dëmet e paguara pa përfshirë pagesën e dëmeve nga risiguruesit (dëmet neto) në raport me primet e fituara neto në 31.12.2024, për tregun e Jo-Jetës rezultuan në nivelin 40.6% nga 35.2% një vit më parë.

Për tregun e Jetës raporti dëme/prime neto për 31.12.2024 është 20.4% nga 18.8% në 31.12.2023.


Graik 17: Raporti dëme/prime për tregun e Jo-Jetës dhe Jetës*

(Në %)




*Vlerat për periudhën 31.12.2024 i referohen pasqyrave financiare të audituara të shoqërive të sigurimit.

Raporti i shpenzimeve, përfaqëson raportin midis shpenzimeve operative neto dhe shpenzimeve të tjera neto për sigurimet kundrejt primeve të fituara neto. Për tregun e Jo-Jetës ky raport për 31.12.2024 rezulton rreth 51.7%, nga 49.8% në 31.12.2023. Shpenzimet në vitin 2024 kanë pësuar rritje krahasuar me vitin 2023 për tregun e Jo-Jetës. Për tregun e Jetës raporti i shpenzimeve për 31.12.2024 është 68%, nga 67.2% që ka qenë një vit më parë, duke rezultuar me një rritje prej rreth 0.8% për shkak të rritjes së shpenzimeve.



Grafik 18: Raporti i shpenzimeve për tregun e Jo-Jetës dhe Jetës*

(Në %)



*Vlerat për periudhën 31.12.2024 i referohen pasqyrave financiare të audituara të shoqërive të sigurimit.

Mbikëqyrja në distancë

Në zbatim të kuadrit rregullator, Autoriteti ka ushtruar mbikëqyrje në distancë nëpërmjet monitorimit, mbledhjes dhe verifikimit të raportimeve të depozituara nga shoqëritë e sigurimit dhe institucione të tjera. Mbikëqyrja në distancë fokusohet tek përpunimi dhe analiza e informacionit të mbledhur nga raportimet periodike apo ad-hoc të shoqërive të sigurimit, me theks të veçantë tek analizat financiare dhe aktuariale. Konkretisht, në fokus të mbikëqyrjes në distancë për periudhën raportuese ishin:

- Përgatitja e raporteve të analizave financiare në distancë për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë dhe Jetë për periudhat tremujore, bazuar në shqyrtimin dhe përpunimin e të dhënave të dërguara nga raportimet e shoqërive të sigurimit, si dhe në informacionet nga inspektimet në vend dhe analizat financiare të mëparshme;
- Shqyrtimi i raporteve të audituesve të jashtëm për shoqëritë e sigurimit dhe grupet e sigurimit për veprimtarinë e tyre gjatë vitit paraardhës;
- Monitorimi mujor i ecurisë të normës së likuiditetit për shoqëritë e sigurimit;
- Shqyrtimi i raporteve vjetore të audituesve të brendshëm të shoqërive të sigurimit;
- Shqyrtimi i planeve vjetore të biznesit të shoqërive;


- Monitorimi i publikimit të raportit vjetor të shoqërive;
- Analizimi i raporteve të vetëvlerësimit për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë;
- Llogaritja me bazë tremujore e provigjoneve teknike dhe matematike, si dhe llogaritja e kufirit minimal të aftësisë paguese për shoqëritë e sigurimit;
- Analizimi i marrëveshjeve të risigurimit dhe vlerësimi i cilësisë së risiguresve;
- Monitorimi i rreziqeve me vlerë mbi 10% të kapitalit për çdo rrezik të veçantë dhe monitorimi i dëmeve mbi 10 milionë lekë;
- Llogaritja e primit të rrezikut në nivel tregu, për kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik, në përputhje me rregullat e profesionit të aktuarit dhe legjislacionit në fuqi.

Implementimi i SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”

Me qëllim marrjen e masave nga shoqëritë e sigurimit për zbatimin e SNRF 17, shoqëritë e sigurimit, si njësi ekonomike me interes publik, hartojnë dhe raportojnë pasqyrat financiare, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), pjesë e të cilave është edhe SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”. Për të ndjekur ecurinë e procesit drejt zbatimit të plotë dhe në kohë të SNRF 17, Autoriteti miratoi Udhëzimin nr.146, datë 31.08.2023 “Mbi raportimin e shoqërive të sigurimit për zbatimin e SNRF 17 “Kontratat e sigurimit””. Ky udhëzim përcaktoi raportimin periodik të shoqërive të sigurimit në Autoritet mbi hapat që duhet të ndërmerren nga shoqëritë e sigurimit, gjatë periudhës tranzitore deri në zbatimin e plotë të SNRF 17.

Vlerësohet se zbatueshmëria e SNRF 17 parashikohet të ketë efekt mbi paraqitjen e pasqyrave financiare, si dhe të sjellë një ndikim të drejtpërdrejtë në metodologjinë e llogaritjes së provigjoneve dhe vlerësimin e tyre. Krahas vlerësimit të provigjoneve me vlerë tregu, përfshihen edhe koncepte të reja, si: marzhi i shërbimit kontraktor, rregullimi i rrezikut, etj. Zbatimi i SNRF 17 pritet të ketë efekt edhe në pasqyrat financiare, përfshirë edhe rezultatin financiar të shoqërive të sigurimit.

Autoriteti, së bashku me përfaqësues të tregut të sigurimeve, ka përfituar trajnime të dedikuara për implementimin e SNRF 17, të organizuara me asistencë teknike. Pavarësisht trajnimeve të realizuara dhe njohurive të përfituara, si dhe pritshmërive rregullatore të parashikuara në Udhëzimin e AMF nr. 146, vlerësojmë se afati i përcaktuar për zbatimin e këtij standardi, i përcaktuar në Urdhrin përkatës, duhet të rishikohet. Kjo është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të lartë të problematikave me të cilat industria e sigurimeve vazhdon të përballë, që lidhen me implementimin e këtij standardi. Përballë sfidave të vazhdueshme dhe adaptimit të nevojshëm në lidhje me ndryshimet e këtij standarti, duket e



arsyeshme të rishikohet ky afat, duke ofruar më shumë kohë për zbatimin e plotë të shoqëruar me përmirësim të efikasitetit në zbatim. Ky rishikim mund të kontribuojë në uljen e riskut të përballjes me pengesa gjatë periudhës së adaptimit, duke siguruar një kalim më të lehtë dhe më të qëndrueshëm për industrinë e sigurimeve në përmbushjen e kërkesave të reja.

Për implementimin e duhur të SNRF 17, mbeten ende sfida të mëdha për t'u adresuar nga tregu i sigurimeve dhe Autoriteti:

- Zhvillimi i mëtejshëm i teknologjisë së informacionit dhe rritja e kapaciteteve të sistemeve të informacionit, me qëllim mbledhjen, grupimin dhe përpunimin e të dhënave, sipas kërkesave të shumta të standardit;
- Vijimi i kualifikimeve teorike të shoqëruara me krijimin e përvojës praktike të kontabilistëve dhe aktuarëve të shoqërive për kryerjen e interpretimeve të duhura në hartimin e pasqyrave financiare;
- Ndryshime thelbësore në modelin e qeverisjes, rolin e shtuar të aktuarëve dhe dokumentimin e të gjitha aspekteve të procesit të marrjes së të dhënave, llogaritjet, rezultatet dhe indikatorët e rinj;
- Kryerja e testeve gjithëpërfshirëse të vlefshmërisë në të gjitha aspektet përpara fillimit të zbatimit të standardit;
- Kosto të shtuara për përballimin e sfidave të sipërpërmendura.

Udhërrëfyese për implementimin e regjimit mbikëqyrës Solvency II

Zbatimi i Solvency II është një nga prioritetet kryesore të Autoritetit në kuadër të përgatitjeve të Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Ky regjim mbikëqyrje pritet të sjellë një ndryshim të rëndësishëm në kulturën e administrimit të rrezikut nga ana e shoqërive të sigurimit, duke kërkuar që ato të përmirësojnë praktikën dhe strategjitë e menaxhimit të rrezikut për të siguruar një mbështetje më të fortë ndaj konsumatorëve dhe stabilitetin financiar të tregut.

Një kapitalizim i mirë i siguresve do t'i mundësojë sektorit të përballojë goditje të paparashikuara dhe të rrisë qëndrueshmërinë e tij në kohë krize. Objektivat kryesore të Solvency II përfshijnë: përmirësimin e mbrojtjes së konsumatorit, duke siguruar që shoqëritë e sigurimit të jenë në gjendje të përmbushin angazhimet e tyre ndaj klientëve; një mbikëqyrje më të modernizuar dhe efikase për të monitoruar risqet dhe operacionet e shoqërive të sigurimit; rritjen e konkurrencës ndërkombëtare të siguresve të BE-së, duke mundësuar më shumë mundësi për investime dhe bashkëpunime ndërkufitare; koherencën me standardet ndërkombëtare të raportimit dhe kontabilitetit, që do të ndihmojnë në harmonizimin e praktikave të raportimit financiar; dhe

harmonizimin dhe integrimin më të thellë të tregut të sigurimeve në BE, duke krijuar mundësi të reja për zhvillim dhe rritje të sektorit brenda unionit.

Autoriteti ka vijuar punën për një kalim të kujdesshëm drejt kornizës rregullatore Evropiane “Aftësia Pagueuse II” (Direktiva e Solvency II). Në fillim të vitit 2024, ka filluar zbatimi i udhërrëfyesit “Për adoptimin e Solvency II”, hartuar me asistencë të Bankës Botërore. Kjo kornizë ligjore ka si qëllim të sigurojë stabilitetin financiar për kompanitë e sigurimit dhe mbrojtjen e duhur për konsumatorët, përmes kërkesave të kapitalit, të bazuara në rrezik dhe standarde të kujdesshme të mbikëqyrjes. Zbatimi i planit 7-vjeçar të regjimit të Aftësisë Pagueuse II, po realizohet në kuadër të projektit të Bankës Botërore “Për Qëndrueshmërinë dhe Zhvillimin Financiar të Shqipërisë,” të financuar nga SECO nën Programin F4D.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024, janë zhvilluar disa aktivitete të rëndësishme që përfshijnë:

- Workshop teknik të thelluar mbi “Provizjonet teknike për sigurimet e Jo-Jetës sipas Aftësisë Pagueuse II”, me pjesëmarrjen e stafit teknik të Autoritetit, aktuarëve dhe ekspertëve të financës nga të gjithë shoqëritë e sigurimit;
- Hartimi i ndryshimeve të kuadrit ligjor (projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”), në linjë me Direktivën 2016/97 për Solvency II, përfshirë: përmirësimin e nivelit të qeverisjes korporative të shoqërive të sigurimit dhe përcaktimin e kërkesave sasiore dhe cilësore të mbikëqyrjes në nivel grupi të sigurimit, etj;
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për analizën e pasqyrave financiare të shoqërive të sigurimit, për të identifikuar dhe vlerësuar impaktin përkundrejt kërkesave të Aftësisë Pagueuse II.

Përmes këtyre aktiviteteve, Autoriteti synon të rrisë kapacitetet mbikëqyrëse dhe të mbështesë përgatitjen e tregut të sigurimeve, për të siguruar një kalim të kujdesshëm drejt regjimit mbikëqyrës të Aftësisë Pagueuse II (Solvency II). Gjatë vitit 2024 është përmbushur plani i aktiviteteve të parashikuara në udhërrëfyesin e Autoritetit. Gjatë vitit në vazhdim Autoriteti është i angazhuar për realizimin e aktiviteteve vijuese me qëllim avancimin në këtë proces.



Struktura e kuadrit rregullator Solvency II

- **Shtylla 1 përcakton kërkesat sasiore**, duke përfshirë rregulla për vlerësimin e aktiveve, detyrimeve (në veçanti të provigjoneve teknike), llogaritjen e kërkesave për kapital, si dhe identifikimin e fondeve të veta, të përshtatshme, për të këto kërkesa.
- **Shtylla 2 përcakton kërkesat cilësore**, duke përfshirë menaxhimin e rrezikut, sistemet e qeverisjes, si dhe sistemin e vetëvlerësimit të rrezikut të aftësisë paguese (ORSA) me planifikim dhe menaxhim të kujdesshëm të kapitalit, teste stresi dhe skenarësh, me qëllim garantimin e aftësisë paguese në çdo kohë.
- **Shtylla 3 mbulon raportimin mbikëqyrës dhe informimin publik të palëve të treta**. Shoqëritë duhet të bëjnë publike detajet e rreziqeve që ata marrin përsipër, mjaftueshmërinë e tyre të kapitalit dhe masat e administrimit të rrezikut që kanë përshtatur. Transparenca dhe dhënia e informacionit synojnë vendosjen e një disipline të duhur në treg.

2.2.2 Inspektimet

Inspektime të plota me fokus rrezikun

Gjatë vitit 2024, Autoriteti vijoi me inspektimin e plotë, në vend, me fokus rrezikun tek dy nga shoqëritë e sigurimit, një shoqëri Jete dhe një shoqëri Jo-Jete. Inspektimet me bazë rreziku përqendrohen në vlerësimin e rreziqeve kryesore me të cilat përballen shoqëritë e sigurimeve, të cilat varen nga aktivitetet e tyre të biznesit. Këto inspektime shqyrtojnë gjithashtu mënyrat e administrimit dhe zbutjes së këtyre rreziqeve nga drejtuesit e lartë të shoqërisë. Vlerësohen përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë së sigurimit, duke pasur parasysh rëndësinë e ruajtjes së shëndetit financiar të shoqërisë.

Këto inspektime kanë për qëllim vlerësimin e rreziqeve kryesore që përfshijnë rrezikun e kreditit, të sigurimit, operacional, ligjor/rregullator dhe strategjik, si dhe analizimin e cilësisë së kapitalit, fitimeve dhe elementeve të veçantë të aktiveve në pasqyrat financiare të shoqërisë. Gjithashtu, një aspekt i rëndësishëm i inspektimeve është vlerësimi i menaxhimit të rrezikut, sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe rolit të niveleve drejtuese të shoqërisë në menaxhimin e veprimtarisë së saj.

Në përfundim të inspektimit, Autoriteti ka vlerësuar rrezikun për çdo aktivitet të shoqërisë së sigurimit dhe ka përditësuar profilin e saj të rrezikut. Ky profil shërben si një bazë për vendosjen e prioriteteve mbikëqyrëse dhe për shpërndarjen e kapaciteteve mbikëqyrëse, sipas nivelit të ekspozimit ndaj rrezikut.

Inspektime tematike

Gjatë vitit 2024, janë realizuar pesë inspektime tematike pranë shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, të cilat janë përqendruar në aspekte që lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e konsumatorëve dhe verifikimin e vijueshmërisë së zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Autoriteti gjatë inspektimeve të mëparshme, si dhe në përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Objekti i inspektimeve tematike për dëmet ka qenë verifikimi i procedurave dhe afateve për dëmshpërblim, veçanërisht për dëmet e sigurimit të detyrueshëm motorik, si dhe vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të vendimeve të Bordit të Autoritetit. Pjesë e këtyre inspektimeve kanë qenë gjithashtu:

- Zbatimi i kërkesave ligjore dhe rregullatore në fuqi, standardeve dhe procedurave operacionale të administrimit të dokumentacionit të dëmeve, sipas linjës së raportimit dhe nivelit të kompetencave, kryesisht për dëmet pezull dhe të paguara;
- Trajtimi i ankesave për dëmshpërblim;
- Saktësia e raportimit në Autoritet të provigjoneve teknike të dëmeve, etj.

Gjithashtu, në kuadrin e inspektimeve tematike, katër prej tyre janë kryer me qëllim vlerësimin e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit lidhur me aktivitetin e marrjes në sigurim në përputhje me detyrimet ligjore dhe rregullatore në fuqi, si dhe vlerësimin e zbatueshmërisë së tyre për çështjet e parashtruara në programin e inspektimit, të fokusuar në:

- Verifikimin e zbatimit të standardeve dhe procedurave operacionale të administrimit të dokumentacionit të marrjes në sigurim dhe të përgjegjësisë të kontraktuar nga shoqëria, sipas linjës së raportimit dhe nivelit të kompetencave, bazuar në kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi;
- Verifikimi i saktësisë së të dhënave të policave të sigurimit krahasuar me raportimet periodike të kryera në Autoritet;
- Verifikimi i nivelit të komisioneve të ndërmjetësimit për kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit;
- Verifikimi i performancës së agjentëve, brokerave dhe personelit të shitjes gjatë procesit të marrjes në sigurim deri në përfundim të kontratës së sigurimit;
- Verifikimi i procedurave të brendshme lidhur me dizenjimin e produktit dhe të vendosjes së çmimeve, si dhe zbatimi i tyre;
- Verifikimi i saktësisë së të dhënave të primeve të raportuara në Regjistrin Elektronik të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, në përputhje me Rregulloren nr.159, datë 29.09.2021, “Për regjistrin elektronik online të shitjeve”;



- Verifikimi i ankesave që lidhen me informimin dhe të drejtat e konsumatorit përpara lidhjes së kontratës së sigurimit, si dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj;
- Verifikimi i zbatimit të vendimeve të Bordit dhe rekomandimeve të lëna nga Autoriteti në inspektimet e mëparshme, lidhur me procesin e marrjes në sigurim.

Në përfundim të inspektimeve, Autoriteti u ka komunikuar shoqërive të sigurimit gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, duke adresuar me vendime të Bordit të Autoritetit problematikat e konstatuara dhe masat e nevojshme për zbatimin e tyre. Ndjekja dhe zbatimi i këtyre vendimeve monitorohet vazhdimisht nga Autoriteti, duke siguruar që afatet e vendosura të respektohen dhe kërkesat e përcaktuara të përmbushen në mënyrë të plotë.

2.2.3 Mbikëqyrja e Grupeve

Në përputhje me Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti kryen mbikëqyrje plotësuese ndaj shoqërive të sigurimit të strukturuar në grup sigurimi. Grupi i sigurimit, për qëllime të mbikëqyrjes, përbëhet nga dy ose më shumë persona juridikë, ku të paktën njëri është shoqëri sigurimi dhe tjetri ka ndikim të rëndësishëm në shoqërinë e sigurimit. Ndikimi i rëndësishëm përcaktohet bazuar në kriterin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikimit dhe/ose detyrimeve të ndryshme kontraktuale, lidhjet brenda grupit, ekspozimit ndaj rrezikut, përqendrimit të rrezikut, transferimit të rrezikut, përqindjes së zotërimit të pronësisë dhe/ose transaksionet brenda grupit.

Në tregun e sigurimeve në Shqipëri, gjatë vitit 2024, kanë ushtruar veprimtari katër grupe sigurimi, nga të cilat dy grupe janë me kapital vendas dhe dy të tjerat me kapital të huaj. Mbikëqyrja efektive e grupeve të sigurimit, bazohet në parimet themelore të sigurimeve (*International Core Principles*), të miratuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS), si dhe në marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga Autoriteti me mbikëqyrësit e vendeve ku ushtrojnë veprimtarinë shoqëritë e sigurimit me kapital shqiptar dhe mbikëqyrësit e grupeve të sigurimit ndërkombëtar që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri.

Gjatë vitit 2024, janë zhvilluar takime në kuadër të kolegjeve mbikëqyrëse të grupeve të sigurimeve, Uniqa Group Austria dhe Vienna Insurance Group. Këto kolegje janë organizuar për të siguruar mbikëqyrje efektive të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, duke mundësuar shkëmbimin e informacionit mbi ecurinë e aktivitetit të tyre. Autoriteti ka raportuar mbi mbarëvajtjen dhe performancën e shoqërive të sigurimit, pjesë e këtyre grupeve, që operojnë në Shqipëri, duke monitoruar zhvillimet dhe duke siguruar përputhshmërinë me standardet rregullatore dhe ligjore.

Autoriteti, ka vijuar edhe me takime me përfaqësues të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), në kuadër të kolegjeve mbikëqyrëse rajonale për dy grupe në sigurime, në cilësinë e Autoritetit rregullator të shoqërive mëmë të grupeve të sigurimit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe në Republikën e Kosovës. Në këto kolegje janë diskutuar ecuria e shoqërive të sigurimit dhe çështje të tjera me interes të përbashkët për dy rregullatorët.

2.2.4 Provigjonet Teknike

Në vlerësimin e shëndetit financiar të shoqërive të sigurimit, një tregues i rëndësishëm është niveli i provigjoneve teknike. Autoriteti vlerëson nëse provigjonet teknike janë të mjaftueshme, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe me nivelin e rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë. Mospërbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të rregullave të menaxhimit nga shoqëritë e sigurimit.


Ecuria në nivel tregu e provigjoneve teknike ndër vite shfaq një tendencë në rritje, duke ruajtur dhe strukturën e aktivitetit Jetë dhe Jo-Jetë. Në fund të vitit 2024, provigjonet teknike bruto, në total për aktivitetin Jetë dhe Jo-Jetë janë rreth 27.74 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2023, ku vlera e provigjoneve bruto në nivel tregu rezultoi rreth 25.31 miliardë lekë, në vitin 2024 vihet re një rritje e vlerës së provigjoneve teknike bruto në nivel tregu, me rreth 9.6% ose rreth 2.43 miliardë lekë, e ndikuar nga të dy aktivitetet. Për aktivitetin e Jo-Jetës rritja rezultoi të jetë rreth 2.20 miliardë lekë, ose rreth 9.6%, ndërsa për shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin në klasat e Jetës rezultoi një rritje e provigjoneve teknike bruto me rreth 230.7 milionë lekë, ose rreth 9.3%.

Peshën më të lartë nga pikëpamja e veprimtarisë së ushtruar e mbajnë provigjonet teknike bruto të shoqërive të Jo-Jetës, me 90.2% të totalit të provigjoneve teknike bruto ose rreth 25.02 miliardë lekë. Ndërsa provigjonet teknike bruto për aktivitetin e Jetës arrijnë në 2.72 miliardë lekë, ose 9.8% e totalit. Kjo strukturë reflekton gjithashtu edhe raportin e primeve të shkruara bruto për aktivitetin e Jo-Jetës kundrejt atyre të Jetës, përkatësisht 91.6% dhe 8.4%.

Nga të dhënat në nivel tregu, të pasqyruara në grafikun e mëposhtëm, vihet re tendenca në rritje e treguesit të provigjionit teknik të dëmeve dhe primeve.

Grafik 19: Provigjoni teknik bruto në vite

(Në mld. lekë)





Provigjoni Teknik

Provigjoni teknik është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuale të caktuara, e cila mbahet nga siguruari, për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.

Provigjonet teknike përfshijnë:

- Provigjonet për prime, të cilat përbëhen nga provigjonet për primet e pafituara dhe për rreziqe të paskaduara. Këto provigjone krijohen në përpjesëtim me primet e shkruara që lidhen me mbulimet e sigurimit, të cilat janë ende të vlefshme pas përfundimit të periudhës financiare gjatë së cilës janë krijuar këto provigjone;
- Provigjonet për bonuse dhe rabate, të cilat krijohen në nivel të njëjtë me shumën e pagesave që merr i siguruari bazuar në të drejtën për përfitimet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, të drejtën për reduktim të pjesshëm të primit të sigurimit (rabat) si dhe të drejtën e rimbursimit të një pjese të primit të sigurimit në rast të përfundimit të parakohshëm të kontratës së sigurimit;
- Provigjone teknike të dëmeve, të cilat krijohen në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit para përfundimit të periudhës së sigurimit të kontratës së sigurimit dhe vlerësimi i tyre bëhet në nivel të njëjtë me përgjegjësitë e marra përsipër nga shoqëria e sigurimit nëpërmjet kontratës së sigurimit;
- Provigjone për mbrojtjen për rrezikun ndaj investimit;
- Provigjone të tjera teknike. Këto provigjone krijohen nga shoqëritë e sigurimit me qëllim për të mbuluar përgjegjësitë e pritshme dhe rreziqet për dëme të mëdha, të cilat rrjedhin nga sigurimi i përgjegjësish për humbje nga rreziqe bërthamore, përgjegjësinë e prodhuesit të produkteve farmaceutike si dhe rreziqet e përmbytjes dhe tërmetit.

Provigjonet matematike krijohen në nivel të njëjtë me vlerën aktuale të detyrimeve të ardhshme që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të Jetës, duke zbritur vlerën aktuale të parashikuar për primet e ardhshme për t'u paguar sipas kontratës në fjalë.

Provigjoni teknik bruto për sigurimin e detyrueshëm motorik (MTPL)

Provigjoni teknik bruto për produktet MTPL zë peshën specifike më të lartë në totalin e provigjoneve teknike të tregut të Jo-Jetës. Ky tregues, për 31.12.2024, arrin në rreth 16.65 miliardë lekë, duke pësuar kështu një rritje me rreth 10.1% krahasuar me vitin e kaluar. Pësha e provigjoneve teknike bruto për portofolin e MTPL është 67%, duke rezultuar pothuajse në të njëjtat nivele si në fund të vitit 2023.

Nga të dhënat për peshën dhe strukturën e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm, vërehet që peshën më të lartë e mban provigjoni teknik i dëmeve, në krahasim me provigjonin e primit të pafituar, duke ruajtur të njëjtën strukturë ndarjeje edhe gjatë vitit 2024. Në vazhdimësi, Autoriteti ka dhënë rekomandime për përmirësimin në rritje të treguesit të provigjonit teknik të dëmeve nga sigurimi i detyrueshëm, në përputhje me rritjen e aktivitetit të tregut të sigurimeve.

Këto rekomandime janë bazuar në analizat e të dhënave të shoqërive të sigurimit, në gjetjet e konstatuara gjatë inspektimeve në vend, si dhe nga informacioni për dëmet në proces gjyqësor, lidhur me detyrimet dhe rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuara shoqëritë e sigurimit.

Tabelë 8: Pesha dhe struktura e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm

(Në mld. lekë)

Pesha e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm	2020	2021	2022	2023	2024
Provigjone bruto total MTPL	12.37	13.23	14.17	15.13	16.65
Provigjone bruto total Jo-Jeta	18.96	19.78	21.30	22.82	25.02
Pesha specifike e sigurimeve të detyrueshme kundrejt totalit për tregun (Në %)	65	67	67	66	67
Struktura e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm (Në%)	2020	2021	2022	2023	2024
Provigjoni teknik për dëmet MTPL	56	56	56	56	57
Provigjoni i Primit të pafitur MTPL	44	44	44	44	43
Provigjone bruto total MTPL	100	100	100	100	100

Tarifimi në bazë të rrezikut

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti ka miratuar Rregulloren nr. 156, datë 19.09.2024, “Për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në përlogaritjen e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit», e cila ka hyrë në fuqi më 1 janar 2025.

Oëllimi i kësaj rregulloreje është të hartojë rregulla për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në përlogaritjen e primit të sigurimit në sektorin e transportit, për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik. Ajo gjithashtu përcakton metodologjinë që do të përdoret për aplikimin e faktorëve të riskut, në kuadër të mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqërive të sigurimit nga Autoriteti dhe përcakton mënyrën e raportimit nga shoqëritë e sigurimit në Autoritet.

Përpara miratimit nga Bordi i Autoritetit, rregullorja iu nënshtrua procesit të konsultimit publik me palët e interesit: Autoritetin e Konkurrencës, Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë dhe Shoqatën e Aktuarëve të Shqipërisë, si dhe u zhvillua një seancë dëgjimore në Komisionin për Ekonominë dhe Financat. Gjithashtu, në hartimin e kësaj rregulloreje, Autoriteti është mbështetur nga Banka Botërore dhe Zyra e Asistencës Teknike të Departamentit Amerikan të Thesarit (OTA), si dhe ka marrë në konsideratë edhe eksperiencën e vendeve të Rajonit.



Përveç plotësimit të detyrimeve ligjore, zbatimi i kësaj rregulloreje pritet të shërbejë edhe në drejtim të:

- Përmirësimit të transparencës në procesin e tarifimit dhe efikasitetit të tij;
- Nxitjes për kujdes të shtuar nga drejtuesit e mjeteve, edhe nga ata më të rinjtë, gjatë përdorimit të automjeteve, duke minimizuar rrezikun e aksidenteve;
- Inkurajimit për përdorimin e mjeteve më të reja, më të vogla, me qëllim kontributin në përmirësimin e sigurisë rrugore dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Nxitjes së konkurrencës në treg.

Faktorët e riskut, të përdorur dhe të pranuar gjerësisht në industrinë e sigurimeve, të cilët janë përcaktuar në rregullore dhe gjejnë zbatim edhe në tregun e sigurimeve në Shqipëri janë:

1. Historiku i dëmeve;
2. Fuqia motorike;
3. Mosha e drejtuesit të mjetit;
4. Eksperienca në drejtim të mjetit motorik;
5. Qëllimi i përdorimit të mjetit (personal apo tregtar);
6. Zona gjeografike e përdorimit;
7. Vjetërsia e mjetit.

Këta faktorë janë ndarë më tej në nënkategori, për të cilat janë përcaktuar vlera fikse ose intervale koeficientësh, brenda të cilëve shoqëritë e sigurimit, bazuar në vlerësime aktuariale, kanë përzgjedhur koeficientët që i përshtaten analizës së zhvilluar. Këta koeficientë, së bashku me bazën teknike të të dhënave për hartimin e tabelave të primit të sigurimit dhe vlerësimet aktuariale të përdorura në përlogaritjen e primeve të sigurimit, janë depozituar në Autoritet dhe janë objekt monitorimi në vazhdimësi.

2.2.5 Risigurimet

Risigurimi është forma kryesore e transferimit të rrezikut, në industrinë e sigurimeve në Republikën e Shqipërisë, duke luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe stabilitetin e këtij tregu. Bazuar në kuadrin ligjor dhe aktet rregullatore të miratuara nga Autoriteti, shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të risigurojnë në një shoqëri risigurimi atë pjesë të rrezikut të siguar, që tejkalon limitin e lejuar prej 10% të vlerës së kapitalit. Shoqëritë e sigurimit nëpërmjet risigurimit zvogëlojnë ekspozimin ndaj rreziqeve të mëdha, përmirësojnë kërkesat për kapital (aftësi paguese), rrisin mundësinë për të siguar më shumë rreziqe, si dhe marrin asistencë teknike dhe financiare nga shoqëritë risiguroese. Aktiviteti i risigurimit është i konsoliduar, ndikuar edhe nga kërkesat e përcaktuara në Rregulloren nr. 85/1, datë 30.09.2015, "Për kriteret e risigurimit", e ndryshuar.

Në bazë të kërkesave ligjore dhe rregullatore, shoqëritë e sigurimit raportojnë në Autoritet programin vjetor të risigurimit. Bazuar në funksionin e tij mbikëqyrës, Autoriteti ndjek ecurinë e zbatimit të këtij programi dhe kontratave të lidhura, duke synuar stabilitetin e vazhdueshëm financiar, në lidhje me standardet e mbajtjes së rrezikut nga këto shoqëri risigurimi dhe kriterëve të lidhura me cilësinë e risiguresve.

Marrëveshjet e risigurimit, në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës, janë të formës jo proporcionale, kryesisht të tipit *Excess of Loss* (Tejkalim humbjeje) dhe të formës proporcionale, të tipit *Quota Share/Surplus*. Në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguresve të formës proporcionale të tipit *Surplus* dhe *Quota Share*.

Primet e ceduara në risigurim për 31.12.2024 rezultojnë:

- Për totalin e tregut të sigurimeve, në vlerë rreth 3.71 miliardë lekë, ose sa 15.14% e vlerës së primeve të shkruara bruto në nivel tregu. Vlera e primeve të ceduara në risigurim, në nivel tregu, është rritur me rreth 141.95 milionë lekë, ose rreth 3.98%, krahasuar me fundvitin 2023;
- Për aktivitetin e Jo-Jetës në vlerën rreth 3.57 miliardë lekë, ose sa 15.9% e vlerës së primeve të shkruara bruto. Vlera e primeve të ceduara në risigurim, për gjithë aktivitetin e Jo-Jetës, është rritur me rreth 114.19 milionë lekë, ose rreth 3.31%, krahasuar me fundvitin 2023;
- Për sigurimin e Jetës në vlerën rreth 142.68 milionë lekë, ose sa 6.89% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës. Primet e ceduara në risigurim për sigurimin e Jetës, janë rritur me rreth 27.76 milionë lekë, ose 24.15%, krahasuar me fundin e vitit 2023.

Në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, konstatohet rritje e primeve të ceduara në risigurim pothuajse në të gjithë portofolet. Për vitin 2024, peshën më të madhe ndaj primeve totale të ceduara, e zënë produktet “Motorike” me rreth 55.12% të totalit dhe “Zjarri dhe të tjera të pronës” me rreth 31.59%.


Tabelë 9: Primet e ceduara në risigurim sipas portofoleve kryesore, 2023 dhe 2024

(Në mln. lekë)

Lloji i Sigurimit	2023	2024
Aksidente dhe shëndet	43	44
Motorike	1,835	1,967
Zjarri e të tjera të pronës	1,163	1,127
Përgjegjësi	187	228
Të tjera	226	202
Total	3,453	3,568



Grafik 20: Pesha specifike e risigurimeve sipas portofoleve kryesore për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 (Në %)



Në bazë të Rregullores nr. 57, datë 26.05.2017, “Mbi llogaritjen e Mbajtjes Neto të Mbulimit Maksimal Agregat të rreziqeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit”, referuar ekspozimit më 31.12.2024, shoqëritë e sigurimit kanë raportuar dhe normën e mbajtjes agregate neto për sigurimin nga tërmeti. Bazuar në marrëveshjet e risigurimit në fuqi, tregu i sigurimeve mund të përballojë, pa cenuar treguesit financiarë, dëme deri në rreth 206 milionë euro. Risigurimi është kryer në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 85/1, datë 30.09.2015 “Për kriteret e risigurimit”, e ndryshuar.

Referuar agjencive klasifikuese Standard & Poors, Fitch, Moody's, etj., cilësia e risiguruesve kryesorë të marrëveshjeve që mbulojnë aktualisht rreziqet e ceduara në risigurim nga shoqëritë e sigurimit rezulton së paku në kategorinë e vlerësimit A, që do të thotë edhe më cilësore nga sa kërkohet nga kuadri rregullator në fuqi.

Raportet e vetëvlerësimit të rreziqeve (ORSA)

Raporti i vetëvlerësimit të rrezikut dhe aftësisë paguese (*Own Risk and Solvency Assessment – ORSA*) dorëzohet në Autoritet, me një frekuencë vjetore, nga çdo shoqëri që ushtron aktivitet në klasat e sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës. Detyrimi për raportim periodik parashikohet në Rregulloren nr. 18, datë 28.4.2015, “Për rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit”. Ky detyrim është gjithashtu në përputhje me standardet e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS).

Kriteret mbi përmbajtjen e raportit përcaktohen në rregullore, duke siguruar, kështu, një formë standarde të raportit dhe krahasueshmëri të informacionit të paraqitur. Çdo raport pasqyron elementët e mëposhtëm:

- Kuadrin e administrimit të rrezikut;
- Kategoritë e rreziqeve;
- Kuadrin e raportimit;
- Administrimin e kapitalit;
- Rreziqet e identifikuar dhe vlerësimin e tyre;
- Planet e vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përbalimit të situatave të paparashikuara;
- Rekomandimet dhe masat;
- Proflin e përgjithshëm të rrezikut.

Qëllimi i këtij raportit është që vetë shoqëria të identifikojë, vlerësojë, mbikëqyrë, administrojë dhe raportojë, në vijimësi, rreziqet me të cilat është përballur ose mund të përballë, në nivel të shoqërisë, si një e tërë, dhe në nivel grupi. Gjithashtu, ky raport lejon Autoritetin të vlerësojë në mënyrë objektive ekspozimin e çdo shoqërie sigurimi ndaj rreziqeve me materialitet të lartë, masat e saj të kontrollit, si dhe efikasitetin e këtyre masave, me qëllim mirëfunksionimin e aktivitetit, si në nivel shoqërie sigurimi, ashtu dhe të tregut në përgjithësi.

Për vitin 2024, vërehet se nuk ka ndryshim në hartën e rreziqeve me të cilat janë përballur shoqëritë e sigurimit, krahasuar me vitin e mëparshëm. Rreziqet kryesore të evidentuara janë kryesisht rreziqet tradicionale që prekin aktivitetin e sigurimeve, të cilat pengojnë arritjen e objektivave vjetorë dhe strategjikë. Ndër rreziqet e reja, rreziku kibernetik po bëhet gjithmonë e më shumë një rrezik i përhershëm, për të cilin shoqëritë kanë punuar për përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, certifikimit të tyre me standardet e sigurisë dhe masat shtesë për sigurinë e të dhënave që zotërojnë.

Në kuadër të përafrimit të pjesshëm me Direktivën Evropiane Solvency II, janë në proces miratimi në Kuvend ndryshimet e Ligjit Nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, ku një ndër kapitujt që janë rishikuar ka të bëjë me Sistemin e Administrimit të Rrezikut, me fokus Raportin e Vetëvlerësimit të Rrezikut dhe Aftësisë Paguese (ORSA) të shoqërisë së sigurimit.



2.2.6 Ecuria e Fondit të Kompensimit


Fondi i Kompensimit në mbyllje të vitit financiar 2024, rezulton me një vlerë të paguar rreth 351 milionë lekë, ose me një realizim prej 145.5 %, të detyrimit të fondit për vitin 2024.

Bordi i Autoritetit me Vendimin nr. 5, datë 31.01.2024, ka miratuar Fondin e Kompensimit për vitin 2024 në vlerën 270 milionë lekë, nga të cilat balanca e Fondit të Kompensimit më 31.12.2024, ka rezultuar me tepriçë rreth 109 milionë lekë. Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS) ka pasqyruar, llogaritur dhe shpërndarë Fondin e Kompensimit për vitin 2024 sipas shoqërive të sigurimit, anëtare të saj.

Dëmet objekt Fond Kompensimi pezull më 31.12.2024 janë në vlerën rreth 688 milion lekë, duke pësuar ulje në vlerë me rreth 155 milion lekë, krahasuar me të dhënat e raportuara më 31.12.2023. Pjesë e konsiderueshme e dëmeve pezull vazhdojnë të jenë dëme në proces gjyqësor, që i përkasin ngjarjeve përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021, të cilat rezultojnë në vlerën rreth 459 milion lekë, ose rreth 67 % të dëmeve në proces.

Grafik 21: Ecuria e pagesave Janar-Dhjetor 2024

(Në mln. lekë)



Gjatë vitit 2024, shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së, përveç pagesave të detyrimeve të Fondit të miratuar, kanë kryer edhe pagesa si sigurues të drejtpërdrejtë në funksion të entit kompensues, për dëme shkaktuar nga mjete të pasiguruara/paidentifikuara, në vlerën rreth 113 milionë lekë, sipas kërkesave të nenit 43, të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Klasifikimi i rasteve që trajtohen nga Fondi i Kompensimit dhe nga shoqëritë e sigurimit, si sigurues të drejtpërdrejtë, sipas Ligjit nr. 32/2021, ka ndikuar në uljen e Fondit të Kompensimit për rastet e parashikuara në nenin 41, të këtij ligji.

Autoriteti, gjatë vitit 2024, ka kryer dy cikle inspektimesh në vend pranë tetë shoqërive të sigurimit, anëtare të BSHS-së. Këto inspektime lidhen me verifikimin e pagesave të kryera dhe praktikave të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit me ngjarje sigurimi para dhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, si dhe verifikimin e praktikave të dëmeve, për të cilat shoqëritë e sigurimit kryejnë funksionin e entit kompensues sipas përcaktimeve të nenit 43, të Ligjit nr. 32/2021.

Nga inspektimet e zhvilluara gjatë muajve janar dhe shkurt 2024, ndër të tjera, rezultoi se dy shoqëri sigurimi nuk kishin realizuar detyrimin e fondit të kompensimit për vitin 2023. Në përfundim të këtyre inspektimeve, Autoriteti me Vendimet nr. 45 dhe 46, datë 28.03.2024 urdhëroi shoqëritë e sigurimit plotësimin e detyrimin e mbartur të vitit 2023 si dhe detyrimin e periudhës së fondit të vitit 2024, deri më datë 31 gusht 2024.

Për verifikimin e zbatimit të Vendimeve të Bordit dhe të rekomandimeve të lëna, Autoriteti gjatë muajit korrik 2024, ushtroi inspektim nga i cili rezultoi se shoqëritë e sigurimit përkatëse kishin marrë masa në zbatim të Vendimeve të Bordit si dhe rekomandimeve të lëna në raportet e inspektimit.

Byroja Shqiptare e Sigurimit është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e Kartonit Jeshil. Monitorimi i Byrosë ka qenë në fokus të Autoritetit, veçanërisht gjatë viteve të fundit, për t'u dhënë zgjidhje problematikave të mbartura ndër vite.

Autoriteti monitoron dhe mbikëqyr në mënyrë periodike veprimtarinë e BSHS-së lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore, si nëpërmjet raportimit, ashtu dhe nëpërmjet inspektimeve në vend.

“Kartoni Jeshil” dhe masat lehtësuese në kuadër të rekomandimeve të CEFTA-s.

Byroja Shqiptare e Sigurimit është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e Kartonit Jeshil. “Kartoni Jeshil” është një dokument sigurimi ndërkombëtar, që mbulon përgjegjësinë e drejtuesve të mjeteve me targa shqiptare në rast aksidenti gjatë qarkullimit jashtë territorit të vendit.

Gjatë vitit 2024, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), për lehtësimin e lëvizjes ndërkufitare ka bashkëpunuar BSHS, për të lehtësuar lëvizjen e autovegurave me targa shqiptare drejt vendeve kufitare anëtare të CEFTA-s.

Ky proces u finalizua në fillim të vitit 2025, me lëshimin e policave të sigurimit “Karton Jeshil” 1-vjeçar me prim të reduktuar, për autovegurat me targa shqiptare që lëvizin drejt Malit të Zi si dhe për autovegurat me targa shqiptare që lëvizin drejt Maqedonisë së Veriut. Këto masa synojnë të lehtësojnë lëvizjen e qytetarëve si dhe të nxisin shkëmbimet ekonomike ndërkufitare.



Monitorimi i Byrosë ka qenë në fokus të Autoritetit, veçanërisht gjatë viteve të fundit, për t'u dhënë zgjidhje problematikave të mbartura ndër vite. Autoriteti monitoron dhe mbikëqyr në mënyrë periodike veprimtarinë e BSHS-së lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore nëpërmjet inspektimeve në vend si dhe raportimeve periodike.

2.3 Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Pensionit Privat


2.3.1 Pozicioni Financiar

Tregu i fondeve të pensionit privat që prej fillimit të aktivitetit të tij, ka pasur tendencë në rritje, përse i përket aktiveve, vlerës neto të aktiveve që administron dhe numrit të anëtarëve.

Totali i aktiveve neto të këtij tregu më 31.12.2024 është 8.11 miliardë lekë me një numër prej 44,263 anëtarë. Aktivet neto të këtij tregu kanë pësuar një rritje me 20.33% dhe numri i anëtarëve është rritur me 15.93%, krahasuar me fundin e vitit 2023.

Grafik 22: Ecuria në vite e aktiveve neto të fondeve të pensionit privat

(Në mln. lekë)



Aktivitet e këtij tregu në 31.12.2024 janë investuar kryesisht në obligacione të qeverisë shqiptare, të cilat përbëjnë 96.75% të totalit të aktiveve të tregut të fondeve të pensionit privat, me një rritje prej 21.31% krahasuar me fundin e vitit 2023. Pjesa tjetër e aktiveve të këtij tregu konsiston në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare dhe në llogari të arkëtueshme.

Aktivet e këtij tregu në 31.12.2023 janë investuar kryesisht në obligacione të qeverisë shqiptare, të cilat përbëjnë 95.95% të totalit të aktiveve të tregut të fondeve të pensionit privat, me një rritje prej 17.97% krahasuar me fundin e vitit 2022. Pjesa tjetër e aktiveve të këtij tregu konsiston në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare dhe në llogari të arkëtueshme. Struktura e aktiveve të tregut të fondeve të pensionit privat dhe ndryshimet gjatë dy viteve të fundit të jepen në tabelën e mëposhtme:


Tabelë 10: Ndryshimi i strukturës së aktiveve të tregut të fondeve të pensionit privat, 31.12.2024 krahasuar me 31.12.2023

Përshkrimi	Vlera (Në mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)	Pjesa ndaj totalit (Në %)	
	31.12.'23	31.12.'24		31.12.'23- 31.12.'24	31.12.'23
Periudha					
Asetet neto të fondeve të pensionit	6,737.99	8,107.82	20.33		
Totali i aseteve të fondeve	6,755.08	8,126.68	20.30	100	100
<i>nga të cilët:</i>					
Mjete Monetare dhe Ekuivalentë të Mjeteve Monetare	131.91	85.34	-35.30	1.95	1.05
Obligacione Thesari të R.SH.	6,481.18	7,862.44	21.31	95.95	96.75
Depozita bankare	-	-	-	-	-
Asete të tjera	141.99	178.90	25.99	2.10	2.20
Totali i Detyrimeve të Fondeve	17.09	18.86	10.36	0.25	0.23



Grafik 23: Ecuria e investimeve të tregut të fondeve të pensionit privat


(Në mln.lekë)



Politika e investimeve për të gjitha fondet e pensionit privat, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në treg është afatgjatë, duke mbartur në këtë mënyrë dhe rrezikun e tregut. Politika e investimeve të fondeve të pensionit ka synuar në maturime 5, 7, 10 dhe 15 vjeçare, siç paraqitet në grafikun më poshtë, ku vihet re se pjesën më të madhe e zënë investimet në obligacione me afat maturimi 10 vjeçar në masën 51.19%.


Grafik 24: Ndarja sipas maturimit të investimeve të tregut të fondeve të pensionit privat, 31.12.2024

(Në %)




Numri i anëtarëve në fondet e pensionit privat më 31.12.2024 ka arritur në 44,263 duke patur një rritje prej 15.93% në krahasim me 31.12.2023. Siç tregon edhe grafiku më poshtë, numri i anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit privat gjatë 5 viteve të fundit ka ardhur duke u rritur.


Grafik 25: Ecuria e numrit të anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit privat (Në numër)



Në 31.12.2024, 22,934 anëtarë, ose 51.81% e numrit të anëtarëve në treg kanë lidhur kontratë individuale me shoqërinë administrues, dhe 21,037 anëtarë ose 47.53% kanë lidhur kontratë me shoqërinë administruese dhe punëdhënësit të cilët ka zgjedhur të kontribuojmë në fondin e ofruar nga shoqëria administruese, pa krijuar një fond pensioni me pjesëmarrje të mbyllur. Ndërsa 292 anëtarë ose 0.66% kanë lidhur njëkohësisht si kontrata individuale ashtu edhe kontrata në cilësinë e punëmarrësit për anëtarësim në fondin e pensionit privat të përzgjedhur nga punëdhënësi.



Grafik 26: Ndarja e anëtarëve të fondeve të pensionit privat sipas planeve të pensionit,
31.12.2024 (Në %)



Mbikëqyrja me bazë rrezikun dhe analiza e rreziqeve të tregut

Tregu i fondeve të pensionit privat mbikëqyret sipas metodologjisë me bazë rreziku, e cila synon evidentimin në kohë të rreziqeve të mëdha që prekin këtë treg dhe zbatimin e strategjive të duhura për zbutjen e tyre në një nivel të pranueshëm.

Kjo metodologji, me qëllim zhvillimin e një procesi të shëndoshë për vlerësimin e rrezikut, ka parashikuar gjithashtu ngritjen e Komitetit të Rrezikut për Fondet e Pensionit Privat, i cili mbledhet rregullisht dy herë në vit.

Gjatë mbledhjeve të Komitetit të Rrezikut në vitin 2024 janë prezantuar matricat e rrezikut të pranishëm dhe rrezikut të mbetur në sistem dhe është kryer vlerësimi i tyre, duke identifikuar rreziqet që kërkojnë ndërhyrje më të shpejtë. Rreziku më i madh në kushtet e tregut vendas u identifikua pjesëmarrja e ulët e anëtarëve në sistem, gjë që ka lidhje edhe me besueshmërinë në sistem. Komiteti i Rrezikut, me qëllim zbutjen e rreziqeve, miraton planin e mbikëqyrjes për një periudhë afatmesme për tregun e fondeve të pensionit.

Kapitulli 3

Aktiviteti Rregullues dhe Licencues


3.1 Rregullimi i Tregut të Sigurimeve

Viti 2024 shënoi zhvillime të rëndësishme sa i përket kuadrit ligjor dhe rregullator në tregun e sigurimeve. Autoriteti hartoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 862, datë 30.12.2024 dhe pritet të diskutohet pranë Kuvendit të Shqipërisë, për vijimin e miratimit të tij. Ky projektligj ka si qëllim realizimin e angazhimit të Autoritetit për rritjen e nivelit të përfarimit me Direktivën 2009/138/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 nëntor 2009 “Për fillimin dhe zhvillimin e veprimtarive të sigurimit dhe të risigurimit” (Direktiva për Aftësinë Pagueuse II/Solvency II), si dhe Direktivën 2016/97 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 janar 2016 “Për ndërmjetësit në sigurime”. Projektligji adreson dhe pasqyron rekomandimet e lëna nga Raporti i Vlerësimit të Përputhshmërisë së standardeve dhe praktikave të AMF-së, me Parimet Themelore në Sigurime (ICP), qershor 2023, kryer nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve së Sigurimeve (IAIS).

Nëpërmjet miratimit të ndryshimeve dhe shtesave në Ligjin nr. 52/2014, Autoriteti synon arritjen e objektivave si më poshtë:

1. Rritja e nivelit të përfarimit me Direktivën e BE që rregullojnë tregun e sigurimeve dhe risigurimeve;
2. Rregullimi i mëtejshëm i sistemit të administrimit të rrezikut;
3. Forcimi i kërkesave për përshtatshmëri dhe aftësi të organeve drejtuese dhe funksioneve kryesore;
4. Përmirësim i mbrojtjes së konsumatorit nëpërmjet rishikimit të kërkesave për informim dhe transparencë duke garantuar një nivel uniform dhe të zgjeruar të mbrojtjes së të siguruarve si dhe mundësi të lidhjes së kontratës së sigurimit në internet dhe me mjete elektronike;
5. Rishikimi i kornizës rregullatore në lidhje me mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit;
6. Parashikimi, si risi, e nocionit të “ndërmjetësit në sigurime ndihmëse”, si dhe kushtet që duhet të plotësojnë personi fizik ose juridik që të konsiderohet ndërmjetës në sigurimet ndihmëse;
7. Plotësimi dhe rishikimi i dispozitave për administrimin e përkohshëm dhe prishjen e shoqërisë së sigurimit.

Zhvillim i rëndësishëm ligjor në tregun e sigurimeve është hartimi dhe miratimi i Rregullores nr. 156, datë 19.09.2024 “Për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në përlogaritjen e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.



Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i faktorëve të riskut që përfshihen në përlogaritjen e primit të sigurimit në sektorin e transportit në produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik, përcaktimin e metodologjisë që do të përdoret në aplikimin e faktorëve të riskut, në funksion të mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit nga Autoriteti, si dhe mënyrën e raportimit të shoqërive të sigurimit në Autoritet.

Rregullorja është hartuar nga Autoriteti në konsultim me Bankën Botërore dhe me Zyrën e Asistencës Teknike (OTA) të Departamentit Amerikan të Thesarit. Kjo rregullore është diskutuar me grupet e interesit dhe aktorë të tjerë, si me Shoqatën e Siguruesve & Shoqatën e Aktuarëve të Shqipërisë, si dhe me Autoritetin e Konkurrencës.


3.2 Rregullimi i Tregut të Fondeve të Pensionit Privat

Autoriteti ka vijuar angazhimin e tij, duke përbushur detyrimin për plotësimin e kuadrit nënligjor në zbatim të Ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”. Ky proces është realizuar nëpërmjet një pune intensive dhe voluminoze. Të gjitha rregulloret e hartuara kanë kaluar procesin e konsultimit publik dhe konsultimit me grupet e interesit si shoqëritë administruese të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive dhe Bankat Depozitare.

Rregulloret e miratuara në zbatim të Ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat” janë si më poshtë:

1. Rregullore nr. 1, datë 31.01.2024 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave për licencimin e shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat në Republikën e Shqipërisë dhe miratimin e fondit të pensionit privat, si dhe licencimin dhe veprimtarinë e depozitarit të fondit të pensionit privat.
2. Rregullore nr. 2, datë 31.01.2024 “Për përcaktimin e elementëve të kontratës së anëtarësimit, të deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, të kontratës së administrimit të aktiveve të shoqërisë administruese dhe përmbajtjes e strukturës së prospektit të fondit”. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i elementëve të kontratës së anëtarësimit në fondin me pjesëmarrje të hapur për anëtarin individ, të deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, si për punëmarrësit e një punëdhënësi në fondin me pjesëmarrje të hapur, ashtu dhe për punëmarrësit e një sponsori në fondin me pjesëmarrje të mbyllur, të kontratës së administrimit të aktiveve ndërmjet sponsorit dhe shoqërisë administruese, si dhe përmbajtjen dhe strukturën e prospektit të fondit të pensionit.

3. Rregullore nr. 3, datë 31.01.2024 “Për përcaktimin e kërkesave mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, formën, llogaritjen dhe shumën e fondeve të veta që duhet të ketë shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat”. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërisë administruese, si dhe i formës, llogaritjes dhe shumës së fondeve të veta që duhet të ketë në çdo kohë shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat.
4. Rregullore nr. 4, datë 31.01.2024 “Për delegimin e funksioneve të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat”. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i llojeve të funksioneve, rregullave dhe procedurave për delegimin e funksioneve të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat te palët e treta.
5. Rregullore nr. 91, datë 31.05.2024 “Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve që duhet të plotësojë personi juridik që do të veprojë si agjent i fondit të pensionit privat”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve dhe kritereve që duhet të plotësojë personi juridik që do të veprojë si agjent i fondit të pensionit privat, rregullave për t’u regjistruar nga shoqëria administruese, si edhe të kushteve për të ushtruar veprimtarinë si agjent i fondit të pensionit privat.
6. Rregullore nr. 104, datë 28.06.2024 “Për mënyrën dhe afatin e përlogaritjes së vlerës neto të aktiveve, të fondit të pensionit privat, çmimit të kuotës, shndërrimin e kontributeve në kuota si dhe mënyrën e raportimit të informacionit”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës së vlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të fondit të pensionit privat, kërkesat për llogaritjen e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit privat, çmimit të kuotës si dhe shndërrimin e kontributeve në kuota; shpeshtësinë e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit, çmimit të kuotës si dhe mënyrën, kohën e publikimit dhe raportimit të informacionit lidhur me këta tregues. Kjo rregullore përcakton kërkesat që zbatohen nga shoqëritë administruese dhe depozitarët e fondeve të pensionit privat, lidhur me qëllimin e kësaj rregulloreje.
7. Rregullore nr. 123, datë 31.07.2024 “Për formën, përmbajtjen dhe afatet kohore të raporteve dhe pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe vjetore të shoqërisë administruese, fondit të pensionit privat dhe depozitarit”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave lidhur me formën, përmbajtjen dhe afatet kohore të raportimit të pasqyrave financiare dhe raporteve të tjera të shoqërisë administruese, fondit të pensionit privat dhe depozitarit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.
8. Rregullore nr. 141, datë 28.08.2024 “Për përmbajtjen e materialeve promovuese për fondin e pensionit privat dhe shoqërinë administruese”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i përmbajtjes, formës së reklamimit, ndryshimet dhe ruajtjen e materialeve promovuese për fondin e pensionit privat dhe shoqërinë administruese.



9. Rregullore nr. 142, datë 28.08.2024 “Për përcaktimin e penaliteteve të zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohshme nga fondi i pensionit privat”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i masës, mënyrës së llogaritjes dhe zbatimit të penaliteteve në rastet e tërheqjes së parakohshme të aktiveve nga llogaria individuale e anëtarit në fondin e pensionit privat.
10. Rregullore nr. 154, datë 19.09.2024 “Mbi rregulla të mëtejshme për investimet dhe veprimtarinë e fondit të pensionit privat”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të mëtejshme për investimet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të aktiveve të fondit të pensionit privat të miratuar në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcaktimin e kërkesave për veprimtarinë e fondit të pensionit privat që duhet të zbatohen nga shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët e licencuar në Republikën e Shqipërisë dhe nga subjektet të cilave shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët i kanë deleguar aktivitetet përgjegjëse.
11. Rregullore nr. 155, datë 19.09.2024 “Për përcaktimin e elementëve dhe niveleve të tarifave dhe kostove, si dhe mënyrën e llogaritjes së tyre”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i elementëve dhe niveleve të tarifave dhe kostove që do të zbatohen për fondin e pensionit privat, si dhe mënyra e llogaritjes së tyre.
12. Rregullore nr. 174, datë 08.10.2024 “Për procedurën, dokumentacionin, kushtet dhe mënyrën e zbatimit të ndryshimeve të formës së fondit të pensionit privat”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës, dokumentacionit, kushteve dhe mënyrën e zbatimit të ndryshimeve të formës së fondeve të pensionit privat.
13. Rregullore nr. 190, datë 01.11.2024 “Për regjistrin e pronësisë së fondit të pensionit privat dhe vërtetimin për gjendjen e llogarisë së anëtarit në fondin e pensionit”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave dhe kriterëve në lidhje me formën e organizimit dhe mbajtjen e regjistrit të pronësisë së fondit, publikimin e të dhënave nga regjistri i pronësisë dhe formatin dhe përmbajtjen e vërtetimit për gjendjen e llogarisë së anëtarit të fondit të pensionit privat. Kjo rregullore përcakton kërkesat dhe kriteret për regjistrin e pronësisë së fondit, që zbatohen nga shoqëritë administruese dhe depozitarët e fondit të pensionit privat, si dhe kërkesat për vërtetimin e gjendjes së llogarisë së pensionit të anëtarit të fondit, që zbatohen nga shoqëritë administruese, sipas qëllimit të ligjit dhe kësaj rregulloreje.
14. Rregullore nr. 191, datë 01.11.2024 “Për mënyrën, afatet dhe procedurën e pagesës së pensionit privat”. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e mënyrës, afateve dhe procedurës për marrjen e pagesës së pensionit privat, në llogarinë e anëtarit të fondit të pensionit, pasi ka i lindur e drejta e pagesës së pensionit, sipas legjislacionit në fuqi.

15. Rregullore nr. 192, datë 01.11.2024 “Për transferimin vullnetar dhe transferimin e detyruar të administrimit të fondit të pensionit privat”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave, afateve kohore dhe përmbajtjes së kontratës së transferimit vullnetar dhe transferimit të detyruar të administrimit të fondit të pensionit privat, likuidimin e vetë fondit dhe çregjistrimin e tij nga regjistri, si dhe shpërndarjen e anëtarëve të fondit në fonde të tjera.

Autoriteti për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor ka ndryshuar dhe rregullore ekzistuese si më poshtë:


- Rregullore nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar», e ndryshuar;
- “Manuali i Mbikëqyrjes me Bazë Rreziku të Fondeve të Pensionit Privat, nr. 146, datë 29.09.2016.

3.3 Rregullimi i Tregjeve të Kapitalit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Në tregun e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive si pasojë e rritjes së interesit për marketimin në Republikën e Shqipërisë të fondeve të investimeve alternative të themeluara jashtë vendit, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Autoriteti hartoi dhe miratoi Rregulloren nr. 58, datë 30.04.2024 “Për njohjen e administruesit të fondeve të investimeve alternative të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe regjistrimin e fondit të investimeve alternative të themeluar në një vend anëtar të BE-së». Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës, rregullave dhe dokumentacionit për njohjen e administruesit të fondeve të investimeve alternative të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe regjistrimin e fondeve të investimeve alternative të themeluara në një vend anëtar të BE-së, që do t’u marketohen dhe shiten investitorëve profesionistë dhe të kualifikuar në Republikën e Shqipërisë.

Me Vendimin e Bordit nr. 59, datë 30.04.2024, u miratuan disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren nr. 38, datë 31.03.2023, “Për regjistrimin e agjentit të shitjes së sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuara në një vend anëtar të BE-së”.



Përmirësimi i kuadrit ligjor të Autoritetit

Me qëllim përmirësimin e Ligjit në fuqi nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar”, si dhe në përmbushje të detyrimeve të lëna nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së AMF-së për vitin 2023”, Autoriteti hartoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar”. Me anë të këtij projektligji synohet të forcohet dhe garantohet pavarësia funksionale dhe financiare e institucionit, në funksion të veprimtarisë mbikëqyrëse dhe rregullative të Autoritetit.

Autoriteti është institucion publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit financiar jobankar dhe operatorëve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë sektor. Veprimtaria e institucionit është e rëndësishme jo vetëm për mbarëvajtjen e tregjeve nën mbikëqyrje, mbrojtjen e konsumatorit, por edhe për stabilitetin financiar të vendit, ndryshe nga institucionet e tjera publike.

Amendimet e propozuara synojnë gjithashtu rregullimin e aspektit financiar të Autoritetit me qëllim rritjen e fleksibilitetit të tij për të mundësuar vendosjen e një niveli të kërkuar të Fondit të Rezervës, në linjë me rekomandimet e Shoqatës Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) dhe rekomandimet e audituesit të pavarur të veprimtarisë së Autoritetit.

Autoriteti ka vijuar punën për të rregulluar më tej procedurën e regjistrimit të personave juridikë e fizikë, të licencuar, autorizuar, njohur, regjistruar apo të miratuar nga Autoriteti, në regjistrat përkatës. Në zbatim të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Ligjit nr. 56, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Ligjit nr. 62, datë 14.05.2020 “Për tregjet e kapitalit”, të Ligjit nr. 76, datë 06.11.2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, si dhe Ligjit nr. 66, datë 21.05.2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, ka miratuar Rregulloren nr. 143, datë 28.08.2024 “Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuar, njohura, regjistruara dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”. Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i mënyrës së mbajtjes dhe ruajtjes së regjistrave nga Autoriteti për personat juridikë e fizik dhe fondet, e licencuar, autorizuar, njohura, regjistruar apo të miratuar.

Me qëllim përmirësimin e bazës ligjore në fuqi është ndryshuar me Vendim Bordi nr. 59, datë 30.04.2024, Rregullore nr. 93, datë 31.05.2023 “Për procedurat dhe shqyrtimin e ankesave në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

3.4 Licencimi dhe Qeverisja

3.4.1 Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Aktiviteti i Licencimit

Në vitin 2024 u licencua fondit i investimit “Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid”, fond me pjesëmarrje të hapur, me ofertë publike, në tituj të transferueshëm, i administruar nga shoqëria administruese “Raiffeisen Invest” sh.a., si Fond furnizues i Fondit kryesor “Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide” (Raiffeisen Sustainable Solid), i administruar nga shoqëria administruese Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H., Vienë, Austri. Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid investon tërësisht në një fond kryesor të klasifikuar si i qëndrueshëm dhe për herë të parë investitori ka mundësi që të investojë në mënyrë jo direkte në një fond investimi Evropian, i cili ka integruar në procesin e përzgjedhjes së investimeve kriteret ESG.

Gjatë vitit 2024 Autoriteti ka vijuar me njohjen e katër nënfondeve të SIKTT “Eurizon Manager Selection Fund”: Eurizon Manager Selection Fund – MS 10; Eurizon Manager Selection Fund – MS 20; Eurizon Manager Selection Fund – MS 40; Eurizon Manager Selection Fund – MS 70 dhe një nënfondit të SIKTT “Eurizon Fund”: Eurizon Fund - Bond Aggregate EUR Short Term, miratuar nga CSSF në Luksemburg, nën administrimin e shoqërisë administruese të njohur “Eurizon Capital” S.A., nënfonde të cilat do të marketohen dhe shiten në Republikën e Shqipërisë. Në vijim të njohjes së këtyre nënfondeve, u regjistrua shoqëria “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit të shitjes në Republikën e Shqipërisë edhe për këto nënfonde.

Gjithashtu u miratua regjistrimi i dy Fondeve të Investimit Alternativ (FIA) “Credins Optimal” dhe “Credins Global Bonds”, ofruar vetëm për klientët profesionistë dhe të kualifikuar, administruar nga shoqëria administruese “Credins Invest” sh.a. - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

Aktualisht në tregun e fondeve ushtrojnë aktivitetet gjashtë shoqëri administruese nga të cilat tre janë shoqëri administruese të fondeve të pensionit privat dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) me ofertë publike, dy janë shoqëri administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) me ofertë publike dhe një është shoqëri administruese e fondeve të pensionit privat, të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) me ofertë publike dhe të fondeve të investimeve alternative, për klientët profesionistë dhe të kualifikuar.

Shoqëritë administruese të fondeve, administrojnë katërmëdhjetë SIK në formën ligjore të fondit të investimit, me pjesëmarrje të hapur, me ofertë publike, gjashtë fonde pensioni privat dhe katër fonde të investimit alternativ për klientët profesionist dhe të kualifikuar.



Në tregun e fondeve ushtrojnë aktivitetin e depozitarit të fondeve gjashtë banka, nga të cilat tre janë të licencuara si depozitar i aseteve të fondeve të pensionit privat dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, dy janë depozitar të aseteve të fondeve të pensionit privat dhe një bankë është depozitar i aseteve të fondeve të pensionit privat, të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe të fondeve të investimeve alternative, për klientët profesionistë dhe të kualifikuar.

Tabelë 11: Të dhëna mbi subjektet që ushtrojnë veprimtari në tregun e fondeve (Në numër)

Subjekte	2020	2021	2022	2023	2024
Shoqëri Administruese:	6	6	6	6	6
Shoqëri Administruese të SIK me ofertë publike	2	2	2	2	2
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit Privat	1	1	-	-	-
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit Privat dhe SIK me ofertë publike	2	2	3	3	3
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit Privat dhe SIK me Ofertë Publike dhe Fondeve të Investimit Alternativ për Klientë Profesionistë dhe të Kualifikuar	1	1	1	1	1
Sipërmarrje të Investimeve Kolektive (Fonde investimi)	9	11	12	13	14
Fonde Investimi Alternativ	-	2	2	2	4
Fonde Pensioni Privat	4	4	6	6	6
Depozitarë të fondeve:	6	6	6	6	6
Depozitar i Fondeve të Pensionit Privat	2	2	2	2	2
Depozitar i Fondeve të Pensionit Privat dhe Fondeve të Investimit	3	3	3	3	3
Depozitar i Fondeve të Pensionit Privat dhe SIK me ofertë publike dhe Fondeve të investimit alternativ për klient profesionist dhe të kualifikuar.	1	1	1	1	1
Subjekte të njohura/regjistruara:				3	3
Shoqëri administruese e SIK				1	1
SIKTT				1	6
Agjentë shitje				1	1

Qeverisja

Në mbështetje të kërkesave ligjore dhe nënligjore, shoqëritë administruese janë të organizuara sipas sistemit të organizimit me një nivel qeverisje. Autoriteti miratoi pesë emërimë në funksione drejtuese si administrator/anëtar të këshillit administrues dhe personel kyç të shoqërive administruese të fondeve, katër riemërimë në këto funksione, si dhe dy emërimë si personel kyç të depozitarit.

Tabelë 12: Të dhëna për aksionarët e shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensionit privat

Subjekte	Numër	%
Shoqëri administruese	6	
Aksionarë gjithsej	18	
Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese:		100
nën 10%	9	50.00
mbi 10% nën 20%	1	5.56
mbi 20% nën 33 %	1	5.56
mbi 33% nën 50%	1	5.56
mbi 50%	6	33.33
Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës:		100
Aksionarë të huaj	7	38.89
Aksionarë vendas	11	61.11
Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit:		100
Aksionarë individë	11	61.11
Aksionarë shoqëri	7	38.89

Në vitin 2024 është miratuar ndryshimi i statutit të shoqërisë “Credins Invest” sh.a. - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionare.

Tabelë 13: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutores

(Në numër)

Arsyeja e ndryshimit të Statutit	2020	2021	2022	2023	2024
Statut i ri/ndryshime të tjera	1	-	-	-	-
Rritje kapitali	1	-	1	-	-
Ndryshim i strukturës aksionare	-	-	1	-	1



Gjatë vitit 2024, është miratuar delegimi i funksionit të auditit të brendshëm të shoqërisë administruese «Credins Invest» sh.a. - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, tek shoqëria “FF-FB” sh.p.k.

3.4.2 Tregjet e Kapitalit

Aktiviteti i Licencimit

Në tregun e kapitaleve ushtrojnë veprimtari një Bursë titujsh, dy Regjistrarë, 11 shoqëri komisionere që ofrojnë shërbime investimi në tituj nga të cilat nëntë janë banka të cilat ofrojnë dhe shërbime ndihmëse të ruajtjes dhe administrimit të instrumenteve financiare në emër të klientëve, dhe një bankë e cila ofron shërbime investimi online, nëpërmjet platformës “Smart Invest”.

Tabelë 14: Të dhëna historike mbi subjektet që veprojnë në tregun e kapitalit (Në numër)

Subjekte	2020	2021	2022	2023	2024
Bursë titujsh	1	1	1	1	1
Shoqëri komisionere/Banka	12	13	13	11	11
<i>Nga këto:</i>					
<i>Banka që ofrojnë shërbim ndihmës për ruajtjen dhe administrimin e instrumenteve financiare</i>	9	9	10	9	9
<i>Banka që ofrojnë shërbim investimi online</i>			1	1	1
Regjistrar titujsh	2	2	2	2	2
Agjentë të lidhur të shoqërive komisionere të huaja	4	2	-	-	-

3.4.3 Tregu i sigurimeve

Aktiviteti i licencimit

Aktiviteti licencues i Autoritetit në tregun e sigurimeve u fokusua kryesisht në miratimin paraprak dhe licencimin e një shoqërie të re të sigurimeve të Jetës; miratimin e rritjes së kapitalit e pjesëmarrjes influencuese të aksionarëve të shoqërive të sigurimit; miratimin e emërimeve/riemërimeve për administrator/anëtar këshilli mbikëqyrës/administrimit të shoqërive të sigurimit/brokerimit si edhe në licencimin/rinovimin e licencës së vlerësuesve të dëmeve në sigurime e miratimin e ushtrimit të veprimtarisë së agjentëve në sigurime etj.

Shoqëri sigurimi

Aktualisht në tregun e sigurimeve ushtrojnë aktivitet 13 shoqëri sigurimi nga të cilat 8 në sigurimin e Jo-Jetës dhe 5 shoqëri në sigurimin e Jetës. Ky numër ndryshoi në vitin 2024, pas shumë vitesh, duke u shtuar një shoqëri sigurimi Jete. Licencimi i shoqërisë së re të sigurimeve të Jetës “Vienna Life Insurance”-“Vienna Sigurim Jetë” sh.a., me aksionarë Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe (VIG) - grup lider i sigurimeve në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore (75%) dhe NOA Holding sh.p.k. - grup shqiptar që ka një portofol të diversifikuar dhe ofron shërbime me standarde të larta në disa fusha (25%). Bordi i Autoriteti të Mbikëqyrjes Financiare në mbledhjen e datës 31.07.2024 vendosi dhënien e miratimit paraprak dhe në datë 24.12.2024 licenoi shoqërinë “Vienna Life Insurance”-“Vienna Sigurim Jetë” sh.a. për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit të Jetës në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria “Vienna Life Insurance”-“Vienna Sigurim Jetë” sh.a. do të ushtrojë veprimtarinë e sigurimit të Jetës nëpërmjet përgatitjes, ofrimit, nënshkrimit dhe zbatimit të kontratave të sigurimit të Jetës, në të gjitha klasat e Aneksit 1, shkronjat B dhe C të Ligjit 52/2014.

Ndërmjetës në sigurime

Veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime ushtrohet, si broker ose si agjent në sigurime. Ndërmjetësimi në sigurime mund të kryhet nga individët e licencuar si ndërmjetës fizikë të pavarur ose nga shoqëritë e ndërmjetësimit apo bankat e licencuara për të ushtruar veprimtari ndërmjetësimi nëpërmjet ndërmjetësve të licencuar.

Në tregun e sigurimeve aktualisht janë të licencuara për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime 12 shoqëri brokerimi dhe 5 banka, nga të cilat 6 shoqëri brokerimi dhe 1 bankë, ushtrojnë veprimtari vetëm në fushën e sigurimit të Jo-Jetës, 3 shoqëri brokerimi ushtrojnë veprimtari brokerimi në sigurime të Jetës, të Jo-Jetës dhe risigurime, 3 shoqëri brokerimi dhe 4 banka, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të dy klasat e sigurimit, të Jetës dhe Jo-Jetës.

Tabelë 15: Shoqëri brokerimi sipas klasave të sigurimit

(Në numër)

Viti	2020	2021	2022	2023	2024
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë	8	8	7	7	7
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë dhe Jetë	7	7	7	7	7
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë, Jetë, Risigurime	4	4	4	3	3
Totali	19	19	18	17	17



Autoriteti miratoi 159 persona fizikë (agjentë) për ushtrimin e veprimtarisë si agjentë në sigurime si dhe licenoi 11 subjekte juridike për të vepruar si agjentë në sigurime. Në tregun e sigurimeve janë të miratuar 1068 individë për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe janë të licencuar 62 subjekte juridike nga të cilat 4 janë banka. Të dhënat për licencimin/miratimin për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime jepen në tabelën më poshtë.

Tabelë 16: Të dhëna mbi agjentë të licencuar në sigurime

(Në numër)

Agjent në sigurime	Të licencuar në fund të vitit 2023	Licenca të reja në 2024	Tërheqje licence, ndërprerje kontrate në 2024	Të licencuar në fund të vitit 2024
Persona juridikë	56	11	5	62
<i>Nga këto, banka</i>	4			4
Person fizikë	973	159	64	1068

Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Në tregun e sigurimeve janë të licencuar 58 individë si vlerësues dëmsh në sigurime nga të cilët 33 individë e ushtrojnë këtë veprimtari si të punësuar pranë një shoqërie sigurimi dhe 25 si vlerësues të pavarur. Në vitin 2024 ka pasur 11 licencime dhe 11 rinovime licencash për vlerësues dëmsh në sigurime.

Tabelë 17: Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të dëmeve të licencuar në sigurime (Në numër)

Vlerësues sipas statusit/llojit të licencës	Të licencuar në fund të vitit 2023	Rinovuar licenca në 2024	Licenca të reja në 2024	Përfunduar afati i licencës në 2024	Hequr licenca në 2024	Të licencuar në fund të vitit 2024
Sipas statusit të personit						
Të pavarur	24	8	2	8	1	25
Të punësuar	27	3	9	6	-	33
Sipas llojit të Licencës						
Dëme materiale	8	2	5	-	-	15
Dëme shëndetësore	13	5	-	4	1	13
Dëme materiale dhe shëndetësore	30	4	6	10	-	30
TOTALI	51	11	11	14	1	58

Në tregun e sigurimeve janë të licencuar 13 aktuarë.

Qeverisja

Shoqëritë e sigurimit që operojnë në tregun shqiptar janë të organizuara sipas sistemit me një dhe me dy nivele qeverisjeje. Në shoqëritë e sigurimit me një nivel qeverisjeje, këshilli i administrimit ushtron funksionet e administrimit dhe të mbikëqyrjes, ndërsa tek shoqëritë me dy nivele qeverisjeje, këshilli mbikëqyrës ushtron funksione mbikëqyrjeje dhe administratori, apo bordi i drejtorëve, ushtron funksione administrimi. Nga 13 shoqëri sigurimi në fund të vitit 2024, 12 prej tyre janë të organizuara sipas sistemit me dy nivele dhe vetëm një shoqëri me një nivel. Autoriteti miratoi tre emërimet në funksionin e administratorit të shoqërisë së sigurimeve dhe pesë në funksionin e anëtarit të këshillit mbikëqyrës të shoqërive të sigurimit, si dhe 12 riemërimet në funksionet administrator, anëtar këshilli administrues/mbikëqyrës.

Për sa i përket shoqërive të brokerimit, Autoriteti miratoi tre emërimet në funksione drejtuese si anëtar të këshillit administrues/mbikëqyrës ose administrator të shoqërive të brokerimit, si dhe katër riemërimet në këto funksione.

Shoqëritë e sigurimit janë kryesisht me kapital vendas, konkretisht nga 13 shoqëri sigurimi tetë janë me kapital vendas dhe pesë me kapital kryesisht të huaj. Gjithashtu, nga 13 shoqëri sigurimi, 12 prej tyre kanë aksionar influencues që zotëron mbi 50% të aksioneve.

Tabelë 18: Të dhëna për aksionarët e shoqërive të sigurimit

<i>Subjekte</i>	<i>Numër</i>	<i>%</i>
Shoqëri sigurimi	13	
Aksionarë gjithsej	39	
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i>		100
nën 10%	18	46.15
mbi 10% nën 20%	4	10.26
mbi 20% nën 33 %	4	10.26
mbi 33% nën 50%	1	2.56
mbi 50%	12	30.77
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës:</i>		100
Aksionarë të huaj	3	5.26
Aksionarë vendas	36	94.74
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit</i>		100
Aksionarë individë	28	76.32
Aksionarë shoqëri	11	23.68



Për vitin 2024 nga Autoriteti ka patur dy miratime në lidhje me ndryshimet statutore të shoqërive të sigurimit, si rezultat i rritjes së kapitalit dhe një miratim të pjesëmarrjes influencuese.

3.5 Masat mbikëqyrëse dhe administrative

Gjatë vitit 2024, Bordi i Autoritetit ka marrë 15 vendime, si masa administrative e korigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura, kryesisht si rezultat i konstatimeve të dala nga analizimi i treguesve financiarë, nga inspektimet e kryera në vend nga Autoriteti, por edhe pezullim licencash për ushtrimin e aktivitetit.

Në tregun e sigurimeve janë marrë 11 vendime, të cilat sipas llojit të tyre janë:

- 10 vendime me marrje masash mbikëqyrëse, “Urdhër eliminim shkeljesh” ndaj shoqërive të sigurimit (katër nga masat e marra ndaj shoqërive të sigurimit përfshijnë edhe sanksion me gjobë.);
- Një vendim me heqje licence ndaj një vlerësuesi dëmsh;

Në tregun e titujve janë marrë dy vendime ndaj shoqërive që ushtrojnë veprimtari në ofrimin e shërbimeve të investimit, të cilat sipas llojit të tyre janë:

- Masë korigjuese ndaj një shoqërie;
- Masë korigjuese dhe sanksion me gjobë ndaj një shoqërie.

Në tregun e fondeve të pensionit privat dhe SIK janë marrë dy vendime, të cilat janë vendime me urdhër eliminim shkeljesh dhe parregullsish ndaj shoqërive depozitare të fondeve të pensionit privat dhe SIK.

Në gjykatë nuk është ankimuar asnjë nga vendimet e Bordit të Autoritetit, të marra gjatë vitit 2024.

Kapitulli 4

Bashkëpunimi Ndërinstitucional

4.1 Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

Autoriteti, gjatë vitit 2024 është angazhuar në plotësimin e pyetësorëve të Komitetit Moneyval të Këshillit të Evropës, në kuadër të raundit të 6 të vlerësimit.

Si pjesëmarrës në Grupin Teknik Ndërinstitucional të Punës së Komitetit të Bashkërendimit të Luftës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Autoriteti ka udhëhequr nëngrupin e dedikuar për asetet virtuale. Ky nëngrup përbëhet nga përfaqësues të Autoritetit, Bankës së Shqipërisë, Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë së Inteligjencës Financiare, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse për monitorimin dhe adresimin e rreziqeve që lidhen me përdorimin e aseteve virtuale në vend.


Gjatë vitit 2024, grupi ka zhvilluar tre takime pune, ku janë shkëmbyer informacione të rëndësishme mbi monitorimin e perimetrit rregullator të tregjeve të mjeteve virtuale, si dhe mbi hetimet e zhvilluara për raste të përdorimit të paligjshëm të këtyre mjeteve. Diskutimet kanë synuar forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe identifikimin e masave të nevojshme për të adresuar sfidat në këtë sektor. Autoriteti mbetet i angazhuar në këtë proces, duke kontribuar në hartimin e politikave efektive për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në tregjet e aseteve virtuale.

Autoriteti ka dhënë kontribut edhe në kuadër të hartimit të “Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030”, e cili u miratua gjatë muajit korrik 2024, në takimin e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP), si dhe “Strategjisë për edukimin e publikut mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit në shoqërinë tonë” 2025-2027.

Autoriteti gjatë këtij viti ka vijuar ndjekjen, zbatimin dhe raportimin e planit të veprimit të “Vlerësimit kombëtar të riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Shqipëri” dhe planit të veprimit në kuadër të “Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030”.

Në faqen zyrtare *online* të Autoritetit është hapur rubrika e re <https://amf.gov.al/kujdes.asp>, me qëllim informimin e publikut lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si një kërcënim serioz për sigurinë dhe integritetin e sistemit financiar. Gjithashtu, në këtë seksion janë publikuar edhe listat e sanksioneve ndërkombëtare si: Lista e sanksioneve të OKB-së; Lista e sanksioneve të BE-së; Njoftimet e OKB-së; si dhe Lista e Integruar e Personave të shpallur.

Autoriteti, ka përmbyllur me sukses asistencën teknike të ofruar “Për vlerësimin e masave të ndërmarra nga autoritetet shqiptare për të siguruar përputhjen e plotë me rekomandimin 15 të FATF, të ndryshuar”, në kuadër të projektit “Veprimi kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri”,



lidhur me vlerësimin e kuadrit ligjor shqiptar në përputhje me rekomandimin 15 të raportit të vlerësimit të Komitetit Moneyval të KE, me titull “Teknologjitë e reja”.

Inspektimet e kryera në kuadër të PPP/FT

Gjatë vitit 2024, Autoriteti ka realizuar në total gjashtë inspektime lidhur me zbatimin nga subjektet që mbikëqyr të kërkesave të Ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar. Gjithashtu, në kuadër të inspektimeve të përbashkëta, si dhe në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit në fuqi, Autoriteti ka marrë pjesë në inspektimin e kryer nga Autoriteti Austriak i Tregjeve Financiare (FMA) pranë një shoqërie sigurimi Jete.

Me qëllim mbikëqyrjen e subjekteve *off-site*, është bërë kategorizimi i rrezikut për subjektet e ligjit për PPP/FT, nën mbikëqyrjen e Autoritetit, bazuar në formularët e vetëvlerësimit. Për subjektet banka që ushtrojnë veprimtarinë si shoqëri komisionere, është shkëmbyer informacion me Bankën e Shqipërisë. Rezultati i analizës për kategorizimin e rrezikut, dalë nga matrica e vlerësimit, ka rezultuar “Nivel i ulët i rrezikut”. Një informacion përmbledhës për rezultatet e rrezikut i është dërguar Agjencisë së Inteligjencës Financiare, si autoritet përgjegjës.

Trajnime për PPP/FT

Gjatë vitit 2024, punonjës të Autoritetit kanë marrë pjesë në disa trajnime të organizuara nga institucione ndërkombëtare, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale. Në korrik 2024, Autoriteti në bashkëpunim me Agjencinë e Inteligjencës Financiare, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për rrezikun e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë, ka organizuar një trajnim për subjektet nën mbikëqyrje. Gjatë këtij trajnimi u trajtuan edhe çështjet për investigimin e pastrimit të parave nëpërmjet përdorimit të personave juridikë, strukturave komplekse, profesionistëve, për pastrimin e parave si vepër autonome, etj., duke ju referuar praktikave ndërkombëtare dhe duke e shoqëruar me tipologji të ndryshme.

4.2 Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar

Bashkëpunimi i Autoritetit me organizatat, shoqatat, institucionet financiare, partnerët dhe donatorët është shtrirë më tej edhe gjatë vitit 2024. Autoriteti ka zgjeruar bashkëpunimin me autoritetet homologe evropiane nëpërmjet nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit, shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencave në aspektin rregullator e mbikëqyrës. Synimi kryesor i bashkëpunimeve dhe projekteve lidhet me rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe konsolidimit të saj në tregjet financiare jobankare, si edhe mirërregullimit të tregjeve.

4.2.1 Memorandume Mirëkuptimi, 2024

Memorandum Mirëkuptimi me Bankën Kombëtare të Hungarisë

Në nëntor 2024, në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit me rregullatorët evropianë, si dhe shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit mes dy rregullatorëve, Autoriteti nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Bankën Kombëtare të Hungarisë, në Budapest. Memorandumi i Mirëkuptimit përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi mes dy rregullatorëve financiarë, në fushat ku ata ushtrojnë funksionet mbikëqyrëse, me fokus kryesor tregun e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive. Kuadri i përgjithshëm i këtij Memorandumi është në përputhje me objektivat dhe parimet për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare, të përcaktuara nga organizatat dhe shoqatat ndërkombëtare (IOSCO, IAIS, dhe IOPS), si dhe me direktivat e BE-së. Gjithashtu, memorandumi synon të mundësojë konsultimin dhe të nxisë bashkëpunimin në nivel teknik, me qëllim ndarjen e njohurive dhe shkëmbimin e pikëpamjeve mbi çështjet rregullatore dhe mbikëqyrëse, fokusuar kryesisht në tregun e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, si edhe promovimit të integritetit, stabilitetit dhe eficiencës në këto tregje.

Memorandum Mirëkuptimi me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi (ISA)

Në dhjetor 2024, Autoriteti nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi (ISA), në kuadër të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit mes dy rregullatorëve në fushën e sigurimeve. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet dy autoriteteve rregullatore, synon të krijojë një bazë formale për bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre të ndërsjellë, si dhe të sigurojnë shkëmbimin e informacionit dhe përvojës dhe praktikave më të mira, në lidhje me përgjegjësitë rregullatore dhe mbikëqyrëse, në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve. Kuadri i përgjithshëm i këtij Memorandumi është në përputhje me Parimet Themelore të Sigurimeve (ICP), të përcaktuara nga IAIS, për rregullimin dhe mbikëqyrjen efektive të tregut global të sigurimeve, si dhe me direktivat e BE-së.

Marrëveshje Bashkëpunimi me Bordin e Mbikëqyrjes Publike të Republikës së Shqipërisë

Në tetor 2024, Autoriteti nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me Bordin e Mbikëqyrjes Publike. Kjo marrëveshje ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional përmes shkëmbimit të informacionit në fushën e mbikëqyrjes së auditimit ligjor, lidhur me sigurimin e cilësisë së standardeve të audituesve ligjorë, rezultateve të procesit të kontrollit dhe përmirësimit të nivelit të sigurisë nga auditimet ligjore. Marrëveshja shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e partneritetit ndërmjet Autoritetit dhe Bordit të Mbikëqyrjes Publike, për një mbikëqyrje më efektive të tregut financiar jobankar dhe profesionit të auditimit ligjor, drejt një sistemi financiar të qëndrueshëm, të besueshëm dhe transparent.



4.2.2 Bashkëpunime me Autoritete Homologe

Gjatë vitit 2024, Autoriteti ka vijuar bashkëpunimin me **Bankën Qendrore të Kosovës (BQK)**, me vizita dhe takime pune të përbashkëta. Në shkurt 2024, drejtues të lartë të Autoritetit, zhvilluan takime pune pranë BQK-së, ku u diskutua qasja ndaj reformave që lidhen me SNRF 17, regjimin mbikëqyrës Solvency II në sektorin e sigurimeve, edukimin financiar, ngritjen e kapaciteteve ndërinstitucionale, etj.

Gjithashtu, një delegacion i nivelit të lartë drejtues të BQK-së, në korrik 2024, zhvilloi një vizitë pune pranë Autoritetit. Në fokus të diskutimeve ishin zhvillimet kryesore në tregun financiar jobankar, përfshirë ndryshimet në kuadrin ligjor dhe rregullator, si dhe shkëmbimi i ndërsjellë të përvojave, me interes të veçantë në tregjet e kapitalit. Gjatë këtyre takimeve u vlerësua bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet të dy rregullatorëve, në funksion të rregullimit dhe mbikëqyrjes efektive të tregjeve nën mbikëqyrje.

Bashkëpunimi me BQK ka vijuar edhe me takime në kuadër të Kolegjeve Mbikëqyrëse Rajonale për grupet e sigurimit, në cilësinë e autoritetit rregullator të shoqërive mëmë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe në Republikën e Kosovës.

Autoriteti edhe gjatë vitit 2024 ka forcuar bashkëpunimin me **Autoritetin Austriak të Tregjeve Financiare (FMA)**, edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në takimet e përvitshme të Kolegjeve Mbikëqyrëse të grupeve të sigurimit, organizuar nga FMA. Këto kolegje zhvillohen në funksion të mbikëqyrjes efektive të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, në lidhje me ecurinë e aktivitetit të tyre.

Në kuadër të bashkëpunimit me **Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë (AZN)** Autoriteti, në shtator 2024, Autoriteti mori pjesë në Konferencën e 9të Ndërkombëtare të Sigurimeve, organizuar nga AZN, në Lubjanë me temë *“It's Getting Hot. Temperature is Rising, is Insurance #COOLing”*. Kjo konferencë mblodhi së bashku ekspertë nga fusha të ndryshme, të cilët diskutuan efektet e ndryshimeve klimatike në tregun e sigurimeve, mënyrat për të reduktuar hendekun e sigurimeve dhe domosdoshmërinë e gjetjes së zgjidhjeve efektive për të mbrojtur mjedisin dhe asetet tona.

Bashkëpunimi me **Agjencinë e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare të Kroacisë (HANFA)** ka vijuar edhe gjatë vitit 2024. Në tetor 2024, Autoriteti ka marrë pjesë në Konferencën e Pensioneve Private të organizuar nga HANFA, në bashkëpunim me OECD dhe EIOPA. Tema e kësaj konference ishte *“E ardhmja e pensioneve, të ardhura më të larta në moshën e pensionit”*.

Në vijim të bashkëpunimit rajonal, Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit mori pjesë aktive si paneliste në Konferencën Ndërkombëtare me fokus, tregjet financiare, organizuar nga **Autoriteti i Tregut të Kapitaleve të Malit të Zi**, në bashkëpunim me Bankën Qendrore, Ministrinë e Financave dhe Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi. Konferenca

mblodhi së bashku, politikëbërës, përfaqësues të nivelit të lartë të autoriteteve rregullatore dhe tregjeve financiare nga rajoni e më gjerë, si dhe ekspertë të industrisë financiare, për të diskutuar mbi trendet aktuale, sfidat dhe mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre tregjeve. Drejtoresha e Autoritetit, si pjesë e një paneli, ndau me audiencën progresin dhe transformimin e tregjeve financiare në Shqipëri, duke vënë theksin në rolin e Autoritetit në forcimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe iniciativat e ndërmarra për zhvillimin e tregjeve të kapitalit.

Autoriteti është pjesëmarrës aktiv në nismën rajonale **“Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE-ISI)”**. Në tetor 2024, Autoriteti ka marrë pjesë në takimin e 22të të CESEE ISI, zhvilluar në Prishtinë, ku u ndanë eksperiencat të ndryshme mbikëqyrëse dhe rregullatore, në tregun e sigurimit dhe risigurimit, si dhe risitë e Direktivës së Ndërmjetësimit në Sigurime (IDD).


Gjithashtu në kuadër të kësaj nisme, në tetor 2024, përfaqësues të Autoritetit morën pjesë në Seminarin Rajonal me temë **“Fokusi mbikëqyrës në vitet e ardhshme: Ndryshimi i klimës, inovacioni digjital dhe Solvency II”**, që u zhvillua në Budapest. Pjesëmarrësit në sesionet e ndryshme të seminarit fokusuan diskutimet mbi tendencat aktuale dhe praktikën mbikëqyrëse që lidhen me qëndrueshmërinë dhe faktorët ESG, rreziqet e lidhura me klimën, duke përfshirë *greenwashing*, si dhe inovacionin digjital duke përfshirë rreziqet FinTech, SupTech dhe kibernetike.

Në kuadër të angazhimit për forcimin e bashkëpunimit në tregjet e kryptoaseteve, gjatë 2024, përfaqësues të Autoritetit në cilësinë e panelistëve kanë diskutuar mbi kuadrin rregullator respektiv të tregjeve të kryptoaseteve dhe ndikimin e Rregullores së Tregjeve të Kryptoaseteve (MiCA) në vende të ndryshme. Autoriteti vlerëson këto iniciativa si një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të një qasjeje të përbashkët dhe efektive për mbikëqyrjen e tregjeve të regjistruara të shpërndarë në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

4.2.3 Bashkëpunimi me Organizata Ndërkombëtare e Rregullatore

Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar kanë mbështetur në vijimësi Autoritetin si partnerë kryesorë dhe të rëndësishëm. Ky bashkëpunim i shërben forcimit institucional, përmes mbështetjes në organizimin e trajnimeve nga ekspertët ndërkombëtarë, me qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit të Autoritetit, si edhe të operatorëve të tregut financiar jobankar.

Në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë me Bankën Botërore, janë zhvilluar disa takime të misioneve të Bankës dhe drejtuesve të lartë të Autoritetit. Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit, ishte pjesë e një paneli në workshopin e organizuar nga Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore në kuadër të integritetit të Shqipërisë në sistemin evropian të pagesave. Në sesionin **“Përpjekjet për rritjen e përfshirjes dhe edukimit financiar si nxitës të inovacionit**



financiar dhe qëndrueshmërisë në Shqipëri”, Autoriteti prezantoi iniciativat konkrete që po ndërmerr për të rritur aksesin dhe edukimin financiar në vend. Nëpërmjet këtyre nismave, Autoriteti synon të rrisë aksesin dhe informimin e qytetarëve për shërbimet financiare, duke ndërtuar një kulturë të qëndrueshme të edukimit financiar për shoqërinë.

Gjatë vitit 2024, Autoriteti mori pjesë në Konferencën e organizuar nga FMN dhe Bordi i Stabilitetit Financiar (FSB) në Washington DC, mbi implementimin e rekomandimeve të këtij Bordi, në lidhje me rregullimin e kryptoaseteve. Konferenca ofroi një platformë të rëndësishme për të analizuar qasjet rregullatore dhe mbikëqyrëse të ndjekura nga vendet anëtare dhe jo-anëtare të FSB-së në adresimin e sfidave që paraqesin këto tregje të reja. Përfaqësuesit e Autoritetit ndanë eksperiencën e tyre në lidhje me rregullimin e ekosistemit të mjeteve virtuale.

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS)

Autoriteti është anëtar me të drejta të plota e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) që nga viti 2001 dhe nënshkruese e MMoU-së së IAIS-it që nga viti 2022. Kjo organizatë synon vendosjen e standardeve dhe zbatimin e parimeve themelore në mbikëqyrjen e sigurimeve, duke zhvilluar tregjet dhe mbrojtur të siguruarit, si dhe duke kontribuar në stabilitetin financiar global.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, Autoriteti ka marrë pjesë në takime të rëndësishme dhe seminare të ndryshme të organizuara nga IAIS. Autoriteti, si çdo vit, ka marrë pjesë në Seminarin Global, në Mbledhjet e Komiteteve Teknike dhe Konferencën Vjetore të organizuara nga IAIS, etj. Diskutimet në panele dhe tryezat interaktive ndër të tjera trajtuan tema lidhur me rëndësinë e rolit të tregut të sigurimeve, në forcimin e qëndrueshmërisë shoqërore.

Shqipëria në vitin 2025, do të jetë për herë të parë vendi organizator i Konferencës Vjetore të IAIS-it, eventit më i rëndësishëm global në fushën e sigurimeve. Në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore të IAIS-it dhjetor 2024, Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit, prezantoi platformën dhe vizionin e Autoritetit për organizimin e këtij eventit. Konferenca Vjetore IAIS 2025, do të mbledhë në Tiranë mbi 500 drejtues të nivelit të lartë nga autoritetet mbikëqyrëse dhe tregu i sigurimeve nga mbarë bota, për të diskutuar mbi zhvillimet dhe sfidat në fushën e sigurimeve. Zhvillimi i këtij aktiviteti për herë të parë në Shqipëri, pasqyron marrëdhënien e shkëlqyer të Autoritetit me IAIS-in, si dëshmi e angazhimit të vazhdueshëm për bashkëpunim ndërkombëtar dhe harmonizim të praktikave mbikëqyrëse me standardet ndërkombëtare në sigurime.

Në vijim të bashkëpunimit me IAIS, ekspertë nga Autoriteti i janë bashkuar programit të IAIS-it, si anëtarë të Ekipit të Vlerësimit të Kuadrit të Përgjithshëm (*Holistic Framework Targeted Jurisdiction Assessment (TJA)*). Objekti i këtij vlerësimi, mbulon aspekte të ndryshme të kornizës gjithëpërfshirëse mbikëqyrëse, si identifikimi i grupeve aktive ndërkombëtare të

sigurimit, rimëkëmbja dhe ndërhyrja e jashtëzakonshme, rreziku i likuiditetit, mbikëqyrja makroprudenciale, bashkëpunimi dhe menaxhimi i krizave. Programi i Vlerësimit do të zgjasë rreth 18 muaj dhe do të mbulojë disa juridiksione.

Autoriteti ka kontribuar edhe në plotësimin e pyetësorëve, lidhur me veprimtaritë mbikëqyrëse për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e mbikëqyrjes, në fushën e tregut të sigurimeve.

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Titujve (IOSCO)

Autoriteti është anëtar me të drejta të plota i Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Titujve (IOSCO) dhe njëkohësisht nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit të IOSCO-s që prej vitit 2009, i cili vendos standardet për bashkëpunim ndërkombëtar mes shteteve nënshkruese. Autoriteti merr pjesë në mbledhjet vjetore të Komiteteve të IOSCO-s, si dhe aktivitete apo workshop-e të organizuara prej saj.


Drejtues të lartë të Autoritetit ishin të pranishëm në takimin e 49-të vjetor, në të cilin zhvillohen Mbledhjet e Komitetit Rajonal Evropian (ERC), Komiteti i Tregjeve në Rritje e Zhvillim (GEMC), Komiteti i Presidentëve, Grupi i Monitorimit të Marrëveshjeve Shumëpalëshe të Mirëkuptimit (MMoU MG) dhe konferenca globale për tregjet e kapitalit. Gjatë konferencës globale u diskutuan çështje të ndryshme lidhur me sfidat dhe mundësitë që paraqesin Obligacionet e Qëndrueshme.

Edhe gjatë vitit 2024, Autoriteti ka marrë pjesë aktive në seminare dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga IOSCO. Në trajnimin virtual të organizuar nga Toronto Centre mbi *“Risk Based Supervision for Securities Regulators”*, Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit, në panelin hapës të tij ndau me pjesëmarrësit përvojën e AMF, mbi avantazhet e zbatimit të metodologjisë me bazë rreziku, sfidat e hasura gjatë implementimit dhe adresimin e tyre në tregjet e kapitalit.

Autoriteti ka kontribuar edhe në plotësimin e pyetësorëve, lidhur me veprimtaritë mbikëqyrëse për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e mbikëqyrjes, në fushën e tregjeve të kapitalit.

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS)

Autoriteti është anëtar me të drejta të plota, si dhe pjesë aktive e strukturave të Organizatës Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), që nga viti 2006. IOPS është organizatë e pavarur ndërkombëtare e krijuar në vitin 2004, me iniciativë të OECD-së dhe Rrjetit Ndërkombëtar të Rregullatorëve dhe Mbikëqyrësve të Pensioneve (INPRS), e cila përfaqëson interesat e rregullatorëve të pensioneve private.



Autoriteti merr pjesë rregullisht në aktivitetet e organizuara nga IOPS-i, si në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore, Mbledhjet e Komiteteve Teknike të IOPS-it, Forumin Global për Pensionet Private, si edhe Konferencën Vjetore. Në vitin 2024 tema e Konferencës Vjetore ishte “Pensionet dhe Teknologjia”.

Edhe gjatë vitit 2024, Autoriteti ka marrë pjesë në aktivitete dhe seminare të IOPS-it dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Kërkimit të Pensioneve (IPRA), si webinarin me temë “*From Pillars to Pagodas: Future-proofing Pension Systems*”, forumin e 11-të mbi Financat e gjelbra dhe investimet.

Autoriteti ka kontribuar edhe në plotësimin e pyetësorëve, lidhur me veprimtaritë mbikëqyrëse për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e mbikëqyrjes, në fushën e pensioneve private, plotësimin e pyetësorëve mbi rreziqet e likuiditetit, Sup Tech, si edhe informacione të ndryshme statistikore.

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA)

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) është një institucion rregullator financiar i Bashkimit Evropian, i cili ka si mision të mbrojë interesin publik duke kontribuar në stabilitetin dhe efektivitetin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të sistemit financiar për ekonominë e Unionit. Ky mision ndiqet duke promovuar një kuadër rregullator të shëndoshë dhe praktika të qëndrueshme mbikëqyrëse, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të policave, anëtarëve të skemave të pensioneve dhe përfituesve, si dhe për të kontribuar në besimin e publikut në sektorët e sigurimeve dhe pensioneve profesionale të Bashkimit Evropian.

EIOPA është një organ i pavarur këshillues për Komisionin Evropian, Parlamentin Evropian dhe Këshillin e Bashkimit Evropian, për të ndihmuar në formimin e politikave dhe ligjeve të informuara në nivel të BE-së dhe në nivel kombëtar.

Gjatë këtij viti, Autoriteti ka marrë pjesë në Konferencën e Organizuar nga EIOPA në Gjermani, që synon të ofrojë mbështetje në procesin e përshtatjes ose zbatimit të legjislacionit të sigurimeve të BE-së. Gjatë kësaj konference u diskutuan çështje të ndryshme, si sfidat e qëndrueshmërisë në sigurime, katastrofat natyrore si pasojë e ndryshimeve klimatike, ndikimi i inflacionit, dhe mbikëqyrja me bazë rrezikun.

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (CEFTA)

Shqipëria është anëtare *Central European Free Trade Agreement (CEFTA)* dhe Autoriteti është një ndër institucionet e përfshira në zbatimin e planit të veprimit dhe angazhimeve në kuadër të saj, nën leadershipin e MEKI. Kështu në vijim të bashkëpunimit me këtë organizatë, Autoriteti merr pjesë në takimet që ai organizon, si dhe kontribuon me informacione, statistika apo komente për raportet e Shqipërisë.

Në vendimet e Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s të miratuara në takimin e veçantë të datës 9 tetor 2024, adresohen dhe ato që lidhen me lehtësimin e përdorimit të sigurimit MTPL, përfshirë rekomandimin Nr. 1 “Për Lehtësimin e Sigurimit të Përgjegjësishë nga Automjetet ndaj Palëve të Treta në kuadër të CEFTA”. Konkretisht, nga prioritet e propozuara për bllokun 2 (*free movement of services*), lidhur me Udhërrëfyesin për lehtësimin e sigurimit motorik për palët e treta, trajtuar në nënkomitetin e tregtisë në shërbime, Autoriteti mbështet lehtësimin e sigurimit motorik ndaj palëve të treta brenda CEFTA-s. Autoriteti ka përcjellë pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit udhërrëfyesin dhe rekomandimet konkrete të propozuara së fundmi nga nënkomiteti për tregtinë dhe shërbimet të CEFTA-s, duke kërkuar hartimin një plani të detajuar me hapa konkretë.

Autoriteti është në vazhdimësi në ndjekje të angazhimeve të Shqipërisë në kuadrin e CEFTA duke bashkërenduar hapat e nevojshëm me BShS dhe aktorët e tregut të sigurimeve deri në zbatimin e plotë të tyre.


4.3 Projekte

Projekti “Qëndrueshmëria dhe Zhvillimi Financiar: Rritja e qëndrueshmërisë financiare dhe aksesit në financa të gjelbra dhe novatore” – BB/SECO

Banka Botërore si një nga partnerët kryesorë, mbështet Autoritetin në projektin ndërsektorial “Qëndrueshmëria dhe Zhvillimi Financiar: Rritja e qëndrueshmërisë financiare dhe aksesit në financa të gjelbra dhe novatore”. Ky projekt financohet nga Qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO).

Fokusi i Autoritetit për këtë projekt është në fushat:

1. Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Autoritetit për të mbikëqyrur:
 - Sektorin e Sigurimeve – zbatimi i udhërrëfyesit drejt Solvency II dhe IFRS 17;
 - Fondet e pensioneve private – rishikimi i akteve nënligjore;
 - Tregjet e kapitalit - obligacionet e gjelbra.
2. Përmirësimi i sistemeve të brendshme të IT, platformave të raportimit për t'u përballur me tregjet në rritje dhe zhvillimet FinTech, si dhe sigurinë kibernetike.
3. Zhvillimi i financave të gjelbra – në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.



Në kuadër të këtij projekti, gjatë vitit 2024, janë zhvilluar disa aktivitete të rëndësishme që përfshijnë:

- Workshop teknik të thelluar mbi “Provigionet teknike për sigurimet e Jo-Jetës sipas Aftësisë Pagueuse II”, me pjesëmarrjen e stafit teknik të Autoritetit, aktuarëve dhe ekspertëve të financës nga të gjithë shoqëritë e sigurimit.
- Hartimi i ndryshimeve të kuadrit ligjor (projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”), në linjë me Direktivën 2016/97 për Solvency II, përfshirë: përmirësimin e nivelit të qeverisjes korporative të shoqërive të sigurimit dhe përcaktimin e kërkesave sasiore dhe cilësore të mbikëqyrjes në nivel grupi të sigurimit, etj.
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për analizën e pasqyrave financiare të shoqërive të sigurimit, për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimin përkundrejt kërkesave të Aftësisë Pagueuse II.

Përmes këtyre aktiviteteve, Autoriteti synon të rrisë kapacitetet mbikëqyrëse dhe të mbështesë përgatitjen e tregut të sigurimeve, për të siguruar një kalim të kujdesshëm drejt regjimit mbikëqyrës Solvency II.

Projekti: “Forcimi i cilësisë së auditimit dhe raportimit (SOARP) - Forcimi i përcaktimit të standardeve dhe rritja e kapaciteteve të rregullatorëve financiarë për raportimin financiar” – BB / SECO

Projekti i financuar nga SECO dhe administruar nga Banka Botërore, ka për qëllim të përmirësojë kapacitetet institucionale të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit. Fokusi i këtij projekti janë monitorimi i zbatimit të standardeve të kontabilitetit, zhvillimi dhe zbatimi i metodologjisë së monitorimit të pasqyrave financiare të bazuara në rrezik. Gjithashtu, kjo asistencë teknike ka mbështetur Autoritetin në drejtim të rritjes së kapaciteteve, për zbatimin e Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 17 “Kontratat e Sigurimit”, si dhe përballjen me sfidat e sektorit të sigurimeve.

Gjatë vitit 2024 janë kryer disa trajnime profesionale me synim rritjen e kapaciteteve të stafit mbikëqyrës të Autoritetit dhe të shoqërive të sigurimit, duke ofruar informacion themelor cilësor, të nevojshëm për zbatimin e SNRF 17 në tregun e sigurimeve. Komponenti që lidhet me rritjen e kapaciteteve të Autoritetit ka përfunduar me sukses, sipas afateve të termave të referencës.

Projekte të mbështetura nga Zyra e Asistencës Teknike të Departamentit Amerikan të Thesarit të Shtetit (OTA)

Gjatë vitit 2024, projektet me mbështetjen e Zyrës së Asistencës Teknike të Departamentit Amerikan të Shtetit (OTA), u shtrinë në disa drejtime, si: në tregjet e kapitalit, teknologjisë së informacionit, edukimit financiar dhe mbrojtjes së konsumatorit në fushën e sigurimeve. Në kuadër të këtyre projekteve, janë zhvilluar disa takime pune në Tiranë me ekspertët e OTA-s nga të gjitha fushat e asistencës, me drejtues të Autoritetit, stafin teknik dhe palë të tjera të interesit.

Puna e Autoritetit u fokusua, në drejtim të:

- Rritjes së mbikëqyrjes së sigurisë kibernetike të sektorit financiar shqiptar;
- Forcimit të sigurisë së përgjithshme të infrastrukturës së TI dhe asetëve të informacionit të AMF-së dhe garantimi i reagimit të sistemeve ndaj nevojave të biznesit aktual dhe të ardhshëm;
- Ndërtimit të kapaciteteve të AMF-së për edukimin financiar dhe rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve, për produktet dhe shërbimet financiare në tregun e sigurimeve.
- Zhvillimit të tregjeve të kapitalit, përmes obligacioneve të qeverisë lokale, obligacioneve të kompanive me kapital shtetëror dhe përmirësimit të aspekteve ligjore dhe rregullatore.

Gjithashtu Autoriteti, në tetor 2024, zhvilloi një workshop me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të grupeve të synuara, sipas Strategjisë së Autoritetit “Për edukim dhe përfshirje financiare 2023-2027”. Diskutimet në workshop u fokusuan në përcaktimin e mekanizmave efikas për rritjen e informimit publik dhe dhënien e këshillave për konsumatorin në sigurime, duke i ndihmuar ata të kuptojnë rreziqet për të zgjedhur mbulimin e duhur të sigurimit.

Projekte të mbështetura nga GIZ në kuadër të mbështetjes së negociatave drejt BE-së, në kapitujt e ekonomisë “Support to Accession Negotiations in Economic Chapters of the Acquis” (SANECA II)

Në vijim të angazhimeve të ndërmarra në kuadër të Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare”, për përafrimin me direktivat e BE-së, Autoriteti në cilësinë e drejtuesit të këtij kapitulli, ka përfituar mbështetje teknike nga GIZ, në procesin e transpozimit të Direktivës 2002/87/KE për “Kërkesat e shtuara të mbikëqyrjes së institucioneve të kreditit, shoqërive të sigurimit dhe shoqërive komisionere në një konglomerat financiar”. Gjatë vitit 2024, është punuar me konsulentin për finalizimin e raportit “Policy Impact Assessment”, i cili do të shërbejë si bazë për hartimin e legjislacionit specifik për mbikëqyrjen e konglomerateve financiare.

Në shtator të vitit 2024, Autoriteti filloi një projekt tjetër me GIZ për Skemën e Kompensimit të Investitorëve (*Investor Compensation Scheme*) në tregjet e kapitalit.



Ky projekt synon të kryejë një analizë të detajuar të praktikave më të mira në BE, vlerësimin e mundësive për Shqipërinë, duke hartuar një udhërrëfyes për implementimin e kësaj skeme. Gjatë vitit 2024 është punuar intensivisht për finalizimin e Raportit “Skema e kompensimit të investitorëve-Vlerësimi i praktikave më të mira dhe opsioni i përshtatur për Shqipërinë”.

4.4 Bashkëpunimi me Institucionet e Vendit

Autoriteti ka vijuar bashkëpunimin me **Bankën e Shqipërisë** edhe përgjatë vitit 2024, si në projekte të përbashkëta, ashtu edhe në vijim të bashkëpunimeve ekzistuese. Autoriteti është anëtar e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF) së bashku me Bankën e Shqipërisë dhe **Ministrinë e Financave**. Autoriteti ka vijuar bashkëpunimin me Bankën e Shqipërisë për ndërtimin e iniciativave të përbashkëta për rritjen e edukimit dhe përfshirjes financiare. Autoriteti ka qenë pjesëmarrëse në takimet për Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave, KKSP, i cili synon të mbështesë dhe të kontribuojë në rritjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri. Gjithashtu, Autoriteti është pjesë e projektit të përbashkët me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë me asistencë teknike të **BERZH**, për plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e produkteve derivative, me qëllim nxitjen e investimeve të huaja në këto produkte.

Gjithashtu është avancuar edhe në drejtim të nxitjes dhe zhvillimit të tregut të instrumenteve financiare derivative. Autoriteti, si pjesë e projektit të përbashkët me Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë me asistencë teknike të BERZH, ka vijuar komunikimin ndërinstitucional lidhur me plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e produkteve derivative.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve institucionale mbikëqyrëse në tregjet e kapitalit, një numër i konsiderueshëm punonjësish të Autoritetit, janë bërë pjesë e një programi trajnimi një vjeçar në formatin E-Learning, mundësuar nga BERZH. Këto trajnime mbulojnë fusha si: menaxhimi i riskut të kreditit, riskut të portofolit të investimeve, faktorëve ESG, riskut klimatik, qëndrueshmërisë financiare, FinTech, etj.

Autoriteti vijon bashkëpunimin me **Ministrinë për Ekonominë, Inovacionin dhe Kulturën dhe me Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit**, në drejtim të ndarjes së eksperiencave, informacioneve dhe praktikave më të mira, si dhe raporton periodikisht në përputhje me ligjin për mbrojtjen e konsumatorit. Gjithashtu, Autoriteti kontribuon dhe mbështet institucionet në fjalë, në procesin e përafrimit të legjislacionit për Kapitullim 28, pika 9.1 “Mbrojtja e konsumatorit”.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional në funksion të rregullimit të tregjeve nën mbikëqyrje gjatë vitit 2024, ka vijuar komunikimin me **Autoritetin e Konkurrencës**.

Autoriteti dhe **Agjencia e Inteligjencës Financiare AIF**, kanë vijuar edhe gjatë vitit 2024 bashkëpunimin, përmes inspektimeve të përbashkëta dhe shkëmbimit të informacionit për tregjet dhe subjektet nën mbikëqyrje.

Kapitulli 5

Mbrojtja Konsumatore dhe Transparenca me Publikun

5.1 Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit

Gjatë vitit 2024, Autoriteti ka vijuar punën e tij në mbrojtje të interesave të konsumatorit dhe investitorit, duke vijuar punën me:

- Shqyrtimin e ankesave, lidhur me trajtimin e problematikave të tyre nga subjektet e mbikëqyrura nga Autoriteti;
- Monitorimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në tregjet nën mbikëqyrje, lidhur me transparencën e tyre në shërbimin e ofruar konsumatorit/investitorit, duke respektuar të drejtat dhe interesat e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve dhe investitorëve

Shqyrtimi i ankesave të konsumatorit/investitorit synon zgjidhjen në mënyrë profesionale, të paanshme dhe të shpejtë të ankesave të depozituara, me qëllim ndërhyrjen në kohë, për të shmangur përsëritjen e problematikave të njëjta në të ardhmen. Gjatë vitit 2024, në Autoritet janë depozituar 248 ankesa, kundrejt 160 ankesave të trajtuara në vitin 2023, duke pësuar një rritje prej 49% të numrit të ankesave nga viti paraardhës. Rreth 92% e tyre janë paraqitur në rrugë elektronike, në adresën konsumatori@amf.gov.al, ose amf@amf.gov.al, si edhe nëpërmjet regjistrit *online* të ankesave, i cili gjendet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit. Pas ndërhyrjes së Autoritetit janë zgjidhur rreth 57% të ankesave, çka ndikon në rritjen e nivelit të besimit tek konsumatori dhe ofrimi i një mbrojtje efektive të interesave të konsumatorit dhe investitorit.


Tregu i sigurimeve dominon me 95% të numrit të ankesave, tregu i pensioneve/investimeve me 1% të ankesave, ndërsa 4% janë ankesa jashtë kompetencave të Autoritetit.

Në ankesat e tregut të sigurimeve, sigurimi TPL është segmenti me numrin më të madh të ankesave, me 92% të numrit të ankesave. Pas sigurimit TPL, numrin më të madh të ankesave e zë Sigurimi Kufitar/Kartoni Jeshil, me 5% të numrit të ankesave dhe ndiqet më pas nga ankesat në lidhje me sigurimin e jetës dhe shëndetit me 3% të numrit të ankesave.



Grafik 27: Ankesat sipas llojit të sigurimit


(Në %)



Në ankesat e depozituara për produktet në tregun e sigurimeve nga totali prej 248 në numër, mbizotërojnë ato me objekt “dëmin material” prej 211 në numër, ndjekur nga ankesat me objekt “dëmin shëndetësor” prej 20 në numër, si dhe 17 me objekt “të tjera”.

Grafik 28: Ankesat sipas llojit të dëmit


(Në numër)



Ankesat me objekt vonesën e pagesës së dëmshpërblimit mbizotërojnë me 53% të numrit total të ankesave, e ndjekur më pas nga ankesat me objekt pretendimi për vlerën e dëmshpërblimit me 12% të numrit total të ankesave, duke vijuar me ankesat me objekt refuzim i kërkesës për dëmshpërblim me 10% të numrit total të ankesave, si dhe 24% me objekt të tjera në të cilin përfshihen edhe ankesat me objekt vonesë trajtimi të kërkesës për dëmshpërblim.

Grafik 29: Ankesat sipas arsyes së ankimit

(Në numër)




Monitorimi i subjekteve lidhur me transparencën e tyre në shërbimin e ofruar

Autoriteti gjatë vitit 2024, ka vijuar punën për monitorimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në tregjet nën mbikëqyrje, lidhur me transparencën e tyre në shërbimin e ofruar konsumatorit/investitorit, duke respektuar të drejtat dhe interesat e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Monitorimi është kryer edhe nëpërmjet inspektimeve në vend, kryesisht për tregun e sigurimeve, ku pjesë e programit të inspektimeve kanë qenë edhe çështje që lidhen me mbrojtjen e interesave të konsumatorit, në subjektet si shoqëri sigurimi, banka tregtare, ndërmjetës dhe shoqëri brokerimi.

Inspektimet kishin në fokus verifikimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore, si për informimin e nevojshëm të konsumatorit, në lidhje me llojin e produktit, rreziqet, përfitimet, taksat/tatimet dhe komisionet, para nënshkrimit të kontratës, si dhe ngritjen e një mekanizmi ankimi, lehtësisht të aksesueshëm dhe që i përgjigjet në afat dhe cilësi kërkesave për dëmshpërblim. Pas mangësive të konstatuara nga inspektimi në vend, Bordi i Autoritetit mori masat përkatëse ndaj subjekteve.

5.2 Monitorimi i Ndërmjetësve Financiarë

Gjatë vitit 2024, AMF ka monitoruar rast pas rasti nëpërmjet raportimeve periodike, apo verifikimeve në vend, zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullatore të aktivitetit të ndërmjetësve të tregjeve nën mbikëqyrje.



Në kuadër të monitorimit në distancë (*off-site*), Autoriteti, ka kryer analizën e pasqyrave financiare të ndërmjetësve në sigurime, bazuar në raportimet e tyre me frekuencë 6 mujore, me qëllim monitorimin në vazhdimësi të treguesve kryesorë të aktivitetit, sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullatore në fuqi. Në këtë kuadër monitorohen në vazhdimësi, tregues si kapitali, fondi i garancisë, mjetet monetare, rezultati financiar i aktivitetit, duke i krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Këto rezultate i janë vënë në dispozicion edhe Bordit të Autoritetit, i cili ka dhënë rekomandimet përkatëse, për ndjekje në vazhdimësi të tyre.

Gjithashtu janë kryer edhe inspektimin në vend pranë:

- Katër shoqërive të brokerimit në sigurime;
- Një banke tregtare, që kryen dhe funksionin e agjentit në sigurime;
- Një banke tregtare, që kryen dhe funksionin e brokerit në sigurime.

Inspektimet kishin në fokus aspektet teknike dhe organizative të këtyre ndërmjetësve, kryesisht infrastrukturën për kryerjen e veprimtarisë, si dhe respektimin e kërkesave ligjore e rregullatore në fuqi për kryerjen e aktivitetit të ndërmjetësimit dhe mbrojtjen e konsumatorit.

5.3 Edukimi Financiar dhe Marrëdhëniet me Publikun

Autoriteti e vlerëson edukimin financiar si një nga prioritetet e punës së tij, në funksion të zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje. Në zbatim të “Strategjisë së Edukimit dhe Përfshirjes Financiare 2023-2027” janë zhvilluar aktivitete me qëllim rritjen e besimit të konsumatorit dhe investitorit për tregjet nën mbikëqyrje, ndërgjegjësimin e publikut dhe shtrirjen më të gjerë të edukimit dhe kulturës financiare në vend.

Edhe gjatë vitit 2024 vijoi puna për organizimin e trajnimeve të profesionistëve të tregjeve nën mbikëqyrje, për ciklin kualifikim profesional dhe edukim në vazhdim, për kategoritë broker në sigurime dhe vlerësues dëmsh në sigurime. Gjatë trajnimeve të kryera i është kushtuar vëmendje e veçantë paraqitjes së risive të kuadrit rregullator, akteve të reja nënligjore të përafuara me direktivat evropiane, si dhe përditësimit të njohurive me zhvillimet e reja globale. Trajnimet u zhvilluan në bashkëpunim me shoqatat e profesionistëve të tregut të sigurimeve.

Duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit financiar të studentëve për tregjet e mjeteve virtuale, Autoriteti zhvilloi leksione të hapura me studentët e fakulteteve të ekonomisë të dy universiteteve, me fokus teknologjinë “blockchain” dhe tregjet e kriptomonedhave, si dhe për rolin e Autoritetit si mbikëqyrës dhe rregullator në tregjet financiare jobankare. Këto sesione u fokusuan në karakteristikat kryesore të ekosistemit të kryptoaseteve dhe rreziqet e lidhura me të. Studentët u njohën me historikun e krijimit të kryptoaseteve, entitetet kryesore që operojnë në këto tregje dhe rreziqet e ndryshme që lidhen me këto aktivitete, duke përfshirë abuzimin në treg, mashtrimin, pastrimin e parave, çështjet e integritetit dhe shmangien fiskale. Gjithashtu, u ofrua një pasqyrë e qasjes rregullatore të ndjekur në Shqipëri për këtë sektor.

Gjatë 2024, Autoriteti zhvilloi takimin informues mbi Ligjin 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat” me drejtuesit e financës dhe të burimeve njerëzore të 20 institucioneve publike, në nivel qendror dhe lokal. Takimi kishte si qëllim rritjen e njohurive të punonjësve të sektorit publik për pjesëmarrje në skemat e pensionit privat, nëpërmjet prezantimit të risive dhe lehtësirave fiskale që sjell ligji.

Në kuadër të zbatimit të “Strategjisë së Autoritetit për Edukim dhe Përfshirje Financiare”, me mbështetje të Zyrës së Asistencës Teknike (OTA), të Departamentit Amerikan të Shtetit, Autoriteti zhvilloi një workshop për të rritur edukimin financiar dhe njohuritë në tregun e sigurimeve. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin përfaqësues të shoqërive të sigurimit, broker në sigurime, përfaqësues të organizatave që mbështesin biznesin e vogël, si dhe studentë të degëve të ndryshme. Diskutimet në workshop u përqendruan edhe në përcaktimin e mekanizmave efikas për rritjen e informimit publik, si dhe këshillimin për konsumatorët në sigurime, për t'i ndihmuar ata të kuptojnë reziqet dhe të zgjedhin mbulimin e duhur të sigurimit.

Autoriteti, në funksion të mbështetjes së edukimit financiar dhe rritjes së ndërgjegjësimit publik për tregjet e kapitaleve, bashkëpunoi me German Sparkassenstiftung Albania për realizimin e konkursit “Të mësojmë për Bursën” – *Stock Market Learning Competition 2024*. Ky ishte viti i katërt i zhvillimit të këtij konkursi me pjesëmarrjen e skuadrave të studentëve nga fakultetet e ekonomisë të universiteteve. Këtë vit, edhe një skuadër me punonjës të rinj të Autoritetit ishte pjesëmarrëse në këtë konkurs.

Marrëdhëniet me Publikun

Një ndër format më aktive të komunikimit me publikun, edhe gjatë vitit 2024, ka qenë përmes faqes *online* të Autoritetit. Numri i kërkimeve në faqen online arriti në 335.967 klikime. Nënseksionet më të kërkuara të faqes janë ato që përmbajnë informacione lidhur me kuadrin ligjor e rregullator, subjektet e licencuara, informacionet statistikore për ecurinë e tregjeve, ashtu edhe për komunikimin e drejtpërdrejtë për ankesat e konsumatorëve. Mesatarisht një vizitor në faqen online shikon disa nënseksione të saj, me një kohëzgjatje mesatare prej mbi 4 minuta.

Faqja tërheq gjithnjë vizitorë të rinj, dhe rreth 10% e klikimeve në faqe janë nga vizitorët e rinj. Faqja online e Autoritetit është lehtësisht e aksesueshme në formatet e ndryshme teknologjike, dhe shifrat e klikimeve tregojnë shtrirje thuajse të barabartë midis përdoruesve të faqes që e kanë aksesuar atë nga desktop, dhe pjesës tjetër që e ka vëzhguar faqen online nga aparatet e telefonisë celulare. Faqja *online* e Autoritetit është e organizuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Të dyja formatet e faqes japin informacion për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare të sigurimeve, pensioneve private, fondeve të investimeve dhe letrave me vlerë në Shqipëri. Faqja vizitohet edhe nga vizitorë jashtë vendit, kryesisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Italia, Gjermania, Spanja, Kosova dhe Austria.



Në përputhje me rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Komisionit Evropian (KE) mbi edukimin financiar dhe informimin lidhur me kuadrin ligjor të teknologjisë së regjistrave të shpërndarë, Autoriteti ka publikuar një faqe të dedikuar brenda seksionit të edukimit financiar. Kjo iniciativë synon të rrisë transparencën dhe ndërgjegjësimin mbi tregun e mjeteve virtuale, duke ofruar informacion të strukturuar dhe të qartë për aktorët e tregut dhe publikun e gjerë. Kjo nënfaqe <https://amf.gov.al/edukimi.asp> përmban materiale informuese mbi funksionimin e tregut të aseteve virtuale dhe adreson rekomandimet e identifikuara në raportin e KE, duke përfshirë:

- Llojet e licencave dhe aktivitetet e mbuluara nga kuadri ligjor, duke sqaruar veprimtaritë e rregulluara dhe kriteret për pajisjen me licencë;
- Kushtet dhe përgjegjësitë e subjekteve për hyrjen në treg, duke shpjeguar kriteret që duhet të plotësojnë operatorët e interesuar;
- Qasjen e autoriteteve ndaj veprimtarive të paautorizuara, duke përfshirë masat administrative dhe sanksionet e zbatuara;
- Ndërgjegjësimin mbi detyrimet për parandalimin e pastrimit të parave, me fokus në përmbushjen e standardeve rregullatore nga subjektet e licencuara.

Një tjetër rubrikë me informacione të përditësuara në faqen *online* të Autoritetit është edhe rubrika “Kini Kujdes”, në të cilën pasqyrohen informacionet lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit si një kërcënim serioz për sigurinë dhe integritetin e sistemit financiar. Me qëllim informimin e publikut në këtë seksion <https://amf.gov.al/kujdes.asp> janë publikuar edhe listat e sanksioneve ndërkombëtare të tilla si Lista e sanksioneve të OKB-së, Lista e sanksioneve të BE-së, Njoftimet e OKB-së, si edhe Lista e Integruar e Personave të shpallur.

Botimet e Autoritetit të realizuara në vitin 2024

- Buletini Zyrtar
- Raporti Vjetor
- Raporti i Mbikëqyrjes
- Gjeografia e Sigurimeve

Publikime elektronike të Autoritetit

- Periodiku mujor informativ
- Buletini Statistikor i tregut të sigurimeve
- Buletini Statistikor i tregut të letrave me vlerë
- Buletini Statistikor i tregut të pensioneve private
- Buletini Statistikor i tregut të fondeve të investimeve

Kapitulli 6 Organizimi Institucional

6.1 Burime Njerëzore

Në funksion të arritjes së objektivave dhe zbatimit të politikave të burimeve njerëzore, administrimi i kapaciteteve njerëzore është orientuar në drejtim të rritjes profesionale të stafit, forcimit dhe ruajtjes së një mjedisi pune motivues, si dhe plotësimit të strukturës organizative.

Në drejtim të motivimit profesional, është synuar ruajtja e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së stafit, si një ndër sfidat kryesore në këtë fushë. Qarkullimi i stafit për vitin 2024 është 2.8%.


Për vitin 2024, plotësimi i strukturës organizative ka vijuar me punësimin dhe promovimin në karrierë të stafit për të siguruar një organizim strukturor sa më profesional dhe fleksibël. Përmes procedurave të hapura dhe transparente të konkurrimit janë realizuar 6 procedura punësimi me fokus tërheqjen e punonjësve me njohuri profesionale dhe përvojë cilësore dhe 1 procedurë e konkurrimit të brendshëm për ngritje në detyrë.

Ruajtja e një mjedisi pune motivues për punonjësit, rritja e bashkëpunimit mes departamenteve si dhe ofrimi i mundësisë së promovimit, mbeten prioritet i punës së Autoritetit.

Një kujdes i veçantë i është kushtuar edhe kombinimit të stafit profesional me përvojë me stafin e ri. Përfaqësimi gjinor në Autoritet, raporti burra-gra në nivel drejtues është 24% kundrejt 76%, si dhe mosha mesatare e stafit është 41 vjeç.

Grafik 30: Ndarjet funksionale sipas departamenteve

(Në %)




Gjithashtu, kujdes i veçantë i është kushtuar edhe ruajtjes së raportit të stafit profesional me përvojë me stafin e ri. Përfaqësimi gjinor në Autoritet, raporti burra-gra në nivel drejtues është 25% kundrejt 75%, si dhe mosha mesatare e stafit është 41 vjeç.



Grafik 31: Struktura e punonjësve të AMF-së sipas grupmoshës

(Në numër)



Kualifikimi profesional

Duke vlerësuar rëndësinë e aftësive profesionale të punonjësve në realizimin me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit, Autoriteti në mënyrë të vazhdueshme ka nxitur dhe ka mundur kryerjen e trajnimeve dhe aktiviteteve profesionale të punonjësve. Gjatë vitit 2024, rreth 61% e stafit teknik të Autoritetit ka qenë pjesëmarrës në trajnime, seminare dhe aktivitete të tjera, të cilat kanë shërbyer për zhvillimin e njohurive dhe rritjen e ekspertizës profesionale. Aktivitetet kanë konsistuar në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira profesionale me autoritetet homologe, institucionet financiare, si dhe me shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve ku Autoriteti është anëtar. Rëndësi i është kushtuar edhe aktiviteteve trajnuese të realizuara në vend, në bashkëpunim me projektet e ndryshme me institucione të huaja duke i shërbyer forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit.

6.2 Sistemet e Teknologjisë së Informacionit

Në vitin 2024, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka realizuar përmirësime të ndjeshme në mekanizmat e sigurisë për të përballuar sfidat në këtë drejtim. Këtu përfshihen përmirësimet e aplikacioneve ekzistuese dhe metodat e monitorimit të tyre. Të gjitha këto masa janë të orientuara drejt krijimit të një mjedisi më të sigurt dhe të besueshëm për operacionet e AMF-së. Aktivitetet kryesore gjatë vitit 2024, përfshijnë:

Forcimin e sigurisë kibernetike, harmonizimin e politikave dhe procedurave, sipas standardeve ndërkombëtare

Në kuadër të forcimit të mbikëqyrjes së sigurisë kibernetike dhe përmirësimit të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, Autoriteti me mbështetjen e Zyrës së Asistencës Teknike të Departamentit Amerikan të Thesarit (OTA), ka ndërmarrë disa nisma strategjike dhe aktivitete të rëndësishme. Një ndër objektivat kryesore ka qenë hartimi i një manuali sipas standardit ndërkombëtar ISO 27002, i cili synon të unifikojë dhe përmirësojë vlerësimin e rezistencës së operacioneve digjitale në tregun financiar. Manuali pritet të krijojë një standard të harmonizuar për menaxhimin e sigurisë kibernetike, duke garantuar qëndrueshmëri dhe përputhshmëri me standardet më të mira ndërkombëtare.

Gjithashtu, si pjesë e projektit, është zbatuar me sukses një proces gjithëpërfshirës për rishikimin dhe përmirësimin e rregulloreve dhe politikave në fushën e teknologjisë së informacionit, mbrojtjes së të dhënave personale dhe sigurisë së informacionit. Ky proces, i realizuar me asistencë teknike, ka siguruar përputhshmëri të plotë me legjislacionin kombëtar dhe rregulloret ndërkombëtare, të tilla si:


- GDPR (*General Data Protection Regulation*) – Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave, e miratuar nga BE në 2016 dhe hyrë në fuqi që në 2018;
- DORA (*Digital Operational Resilience Act*) – Akti për Qëndrueshmërinë Operative Digjitale, miratuar nga BE në 16 Janar 2023 dhe zbatohet nga 17 Janari 2025;
- NIS2 (*Network and Information Security Directive 2*) – Direktiva e dytë për Sigurinë e Rrjeteve dhe Informacionit, miratuar nga BE në Janar 2023 dhe në fuqi nga 18 Tetori 2024.

Digjitalizimin e Regjistrimit të Licencimit në AMF, nëpërmjet formave *online* të aplikimit.

Për të përmirësuar proceset dhe për të rritur efikasitetin e shërbimeve të ofruara, Autoriteti ka ndërmarrë iniciativën për digjitalizim të Regjistrimit të Licencimit me anë të disa formave *online* për aplikimin. Ky proces ka për qëllim të thjeshtojë procedurat dhe të ofrojë një mundësi më të mirë dhe më të shpejtë për përdoruesit, duke reduktuar ndjeshëm kohën dhe burimet e nevojshme për trajtimin e kërkesave.

Mbështetjen dhe konfigurimin e Log Collector-it për mbledhjen e Log-ëve dhe analizimin e tyre nga AKSK.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit mes Autoritetit dhe AKSK (Agjencia Kombëtare të Sigurisë Kibernetike), Sektori i Zhvillimeve të Platformës dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me Qendrën e Informacionit, ka vendosur në dispozicion infrastrukturën TI të nevojshme për instalimin dhe konfigurimin e log collector-it. Kjo mundëson mbledhjen, analizimin dhe ruajtjen e



informacionit të sigurisë në kohë reale, duke përmirësuar ndjeshëm monitorimin e aktiviteteve të sistemeve dhe mbrojtjen nga kërcënimet kibernetike.

Konfigurimin e sigurisë *Zero Trust* në aksesimin e sistemeve të AMF-së nga palët e treta.

Autoriteti ka zbatuar arkitekturën *Zero Trust* për të siguruar aksesimin e sistemeve nga palët e treta. Ky është një model i sigurisë që, përmes një strategjie të fortë, synon të eliminojë besimin e natyrshëm ndaj përdoruesve, pajisjeve ose shërbimeve, duke e detyruar çdo kërkesë për akses të kalojë nëpër një proces rigoroz verifikimi dhe autorizimi, pavarësisht nëse kërkuesi ndodhet brenda ose jashtë rrjetit të autoritetit.

Procesi *Zero Trust* është zbatuar duke përdorur një kombinim të teknologjive dhe politikave të avancuara, të cilat përfshijnë:

- Autentifikimin e shumë faktorëve (MFA): Ky mekanizëm siguron që përdoruesit të verifikohen me disa faktorë të ndryshëm, duke e bërë më të vështirë për aktorët keqdashës të depërtojnë në sistem.
- Segmentimin e rrjetit: Ky proces ndihmon në ndarjen e sistemeve dhe burimeve të ndryshme të AMF-së në pjesë të izoluara, duke kufizuar mundësinë e qasjes të paautorizuar në pjesë të tjera të infrastrukturës.
- Monitorimin e vazhdueshëm: Përdorimi i mjeteve të avancuara për monitorimin në kohë reale të aktiviteteve të sistemit, ndihmon në identifikimin dhe reagimin ndaj çdo aktiviteti të dyshimtë, duke siguruar që çdo hyrje e palëve të treta është e kontrolluar dhe e sigurt.
- Kriptimin: Ky proces është përdorur për të siguruar që çdo informacion që kalon midis përdoruesve dhe sistemeve të AMF-së është i mbrojtur dhe i paaksesueshëm nga palë të paautorizuara.

Përditësimin e elementëve të sigurisë sipas rekomandimeve të AKSK mbi kërcënimet e fundit.

Përditësimi i elementeve të sigurisë, duke u bazuar në rekomandimet e AKSK, është një hap i rëndësishëm për të siguruar mbrojtjen e sistemeve dhe infrastrukturës ndaj kërcënimeve të fundit. AKSK shpesh publikon udhëzime dhe rekomandime për rrethana të reja të kërcënimeve të sigurisë dhe ndihmon entet publike e private në përditësimin e masave të sigurisë. Kjo përfshin përditësimin e mbrojtjes nga viruse, IP malinje, konfigurimin e fortë të mbrojtjes së rrjetit, përdorimin e SSL/TLS, dhe përmirësimin e masave të mbrojtjes ndaj sulmeve DDoS dhe automatikëve për mbrojtjen e sistemeve të AMF-së.

Monitorimin e trafikut në të gjithë infrastrukturën teknologjike të AMF-së për evidentimin e sulmeve të mundshme.


Monitorimi i trafikut në infrastrukturën teknologjike të AMF-së është një proces i vazhdueshëm dhe i nevojshëm për të siguruar mbrojtjen e sistemeve nga sulme të mundshme. Autoriteti ka përdorur mjete të monitorimit dhe analizimit të trafikut me mbështetjen e AKSK, duke mundësuar reagimin në kohë reale dhe rritjen e sigurisë në nivelin institucional. Ky proces ndihmon AMF të parandalojë sulmet dhe të mbrojë informacionin e ndjeshëm të institucioneve dhe palëve të treta që bashkëpunojnë me të.

Mbështetjen dhe trajnimet për stafin e AMF-së, në lidhje me politikat dhe procedurat e sigurisë së informacionit.

Trajnimet janë fokusuar në përditësimin e politikave të sigurisë së informacionit dhe përgatitjen e stafit për të reaguar ndaj kërcënimeve të mundshme, për të siguruar një menaxhim efikas të informacionit të ndjeshëm. Ruajtja e integritetit të sistemeve dhe të dhënave të AMF-së është thelbësore për të krijuar një kulturë të sigurisë dhe mbështetje për zbatimin e procedurave të saj.

Analizimin e sistemeve digjitale në ofrimin sa më të thjeshtë të informacionit ndaj palëve të treta, si dhe monitorimin apo përmirësimin e raportimit të ankesave *online*.

Implementimi i këtyre sistemeve ka siguruar që informacioni të ofrohet në mënyrë të thjeshtë dhe të sigurt për palët e treta dhe ka mundësuar që ankesat të menaxhohen në mënyrë efikase dhe transparente. Ky proces ka kontribuar në rritjen e besueshmërisë dhe efikasitetit të shërbimeve të AMF, si dhe në përmirësimin e komunikimit me qytetarët dhe institucionet.



6.3 Auditi i Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka orientuar aktivitetin e saj drejt realizimit të objektivave të përcaktuara në Planin Vjetor dhe Strategjik të miratuar me Vendim Bordi nr. 208, datë 27.12.2023. Njësia e Auditimit të Brendshëm, si pjesë integrale e strukturës organizative të Autoritetit, ka funksionuar me një auditues të profilit të përgjithshëm financiar dhe një auditues të teknologjisë së informacionit. Veprimtaria audituese është realizuar në përputhje me procedurat e auditimit të rregulluara në aktet ligjore në fuqi dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, duke ndjekur një qasje të integruar që përfshin auditime të kombinuara, përputhshmërie dhe të sistemeve të informacionit.

Gjatë vitit 2024, auditimi është përqendruar në vlerësimin e fushave me nivel të lartë rreziku, bazuar në analizën e kryer nga Njësia e Auditimit të Brendshëm. Cilësia e auditimit konsiderohet një faktor i rëndësishëm në përgatitjen dhe prezantimin e raportit të auditimit, por edhe në rritjen e përgjegjshmërisë së njësive të audituara gjatë zbatimit të rekomandimeve.

Angazhimet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2024 janë fokusuar në dhënien e opinionit mbi mjaftueshmërinë e kontroleve të brendshme për funksionet dhe proceset e audituara, vlerësimin e aplikacioneve dhe sistemeve mbështetëse në kryerjen e aktiviteteve, për të siguruar integritetin dhe sigurinë e informacionit dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, duke vendosur një sistem më efektiv dhe proaktiv ndjekjeje.

Treguesi kryesor i ndikimit të punës audituese është përmirësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke siguruar një qasje më të strukturuar dhe të disiplinuar në menaxhimin të rrezikut dhe rritja e efektivitetit të proceseve kontrolluese. Nëpërmjet auditimeve, synohet forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm, rritja e transparencës dhe sigurimi i zbatimit të rekomandimeve në mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë.

STRATEGJI DHE OBJEKTIVA

Drejtimit kryesore të veprimtarisë së Autoritetit gjatë vitit 2025, në zbatim të objektivave të Strategjisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare 2023-2027, do të përqendrohen në:


- Forcimin e stabilitetit financiar, rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe integritetit të tregjeve;
- Përafrimin e legjislacionit me standardet evropiane, zhvillimin dhe modernizimin e tregjeve;
- Mbrojtjen e interesave të konsumatorit dhe investitorit;
- Zhvillimin e financimit të gjelbër dhe harmonizimin me praktikën evropiane;
- Digjitalizimin dhe përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

1. Forcimi i stabilitetit financiar, rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe integritetit të tregjeve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të vijojë të kontribuojë në nxitjen e stabilitetit financiar, zhvillimit dhe shëndetshmërisë të tregjeve financiare jo bankare nën mbikëqyrje, nëpërmjet forcimit të mëtejshëm të funksionit të tij mbikëqyrës, monitorimit të treguesve kryesorë financiarë dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare.

Autoriteti, me qëllim avancimin drejt procesit të përafrimit të akteve ligjore dhe nënligjore me *acquis* të BE-së, do të ndjekë procedurën e miratimit të ndryshimeve të parashikuara në Ligjin e sigurimeve 52/2014, i cili sjell përmirësime në kuadrin rregullator të qeverisjes korporative; mbikëqyrjes së grupeve të sigurimeve, etj, duke adresuar edhe rekomandimet e ekspertëve të IAIS-it në raportin e tyre të vlerësimit të përputhshmërisë së bazës ligjore dhe rregullatore me Parimet Themelore në Sigurime (ICP). Baza rregullatore do të rishikohet me qëllim plotësimin e saj sipas amendimeve të ligjit 52/20214, përfshirë edhe hartimin e akteve të reja për të adresuar këto ndryshime ligjore. Autoriteti do të vijojë zbatimin e udhërrëfyesit të regjimit mbikëqyrës në sigurime, Solvency II, si angazhim në kuadër të përafrimit të legjislacionit me direktivat e BE-së dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën e mbikëqyrjes, në bashkëpunimin dhe me ekspertët e Bankës Botërore. Gjatë vitit në vijim parashikohet zhvillimi i vlerësimit sasior të ndikimit (Quantitative Impact Study) të këtij regjimi të ri të mbikëqyrjes në tregun e sigurimeve në Shqipëri. Gjithashtu do të vijohet me trajnimet teknike ku stafi i Autoritetit dhe i shoqërive të sigurimeve do të pajisen më aftësitë e nevojshme për zbatimin e kësaj direktive në vendin tonë, në kuadër të përafrimit me *acquis* të BE-së.

Prioritet dhe sfidë afatshkurtër e Autoritetit, është zbatimi i plotë i Standardit të ri Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 17 “Kontratat e sigurimit”, me qëllim përgatitjen graduale të tregut të sigurimeve drejt zbatimit të këtij standardi. Pavarësisht trajnimeve, njohurive të përfituara prej tyre, si dhe pritshmërive rregullatore të parashikuara në udhëzimin përkatës të



AMF-së, për implementimin e duhur të SNRF 17, mbeten ende sfida të mëdha për t'u adresuar nga tregu i sigurimeve dhe Autoriteti, që lidhen me zhvillime të teknologjisë së informacionit dhe rritjen e kapaciteteve dhe kualifikimeve, në përputhje me kërkesat e këtij standardi.

Në vijim të hyrjes në fuqi të Ligjit 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” dhe miratimit të kuadrit rregullator në mbështetje të këtij Ligji, prioritet i Autoritetit në lidhje me këtë treg mbetet monitorimi i përshtatjes së aktivitetit të shoqërive administruese e depozitarëve të licencuar si dhe fondeve të pensionit privat me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi.

Autoriteti do të vijojë të ketë prioritet rolin e tij proaktiv në sigurimin e eficiencës, integritetit dhe zhvillimit në përgjithësi të tregjeve të kapitalit në vend. Në këtë drejtim, synohet që përmes koordinimit ndërinstytucional të avancohet me zbatimin e planit të masave të parashikuara në dokumentin e politikave për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në vend si një alternativë e qëndrueshme financimi, përkundërt burimeve tradicionale të financimit në funksion të diversifikimit të sistemit financiar dhe rrjedhimisht sigurimit të stabilitetit financiar në vend.

2. Përafrimi i legjislacionit me standardet evropiane, zhvillimi dhe modernizimi i tregjeve

Në vijim të miratimit të Pozicionit Negociues për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, Autoriteti si institucion drejtues i këtij kapitulli ka pranuar detyrimet që burojnë nga *acquis*, si dhe ka marrë angazhimin për përafrimin gjithëpërfshirës të legjislacionit të brendshëm brenda vitit 2027. Në këtë kuadër Autoriteti do të vijojë punën për përgatitjen e një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore me qëllim transpozimin e direktivave të BE-së në legjislacionin e brendshëm. Autoriteti, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, mbështetur edhe me asistencë teknike, synon të finalizojë hartimin e projektligjit dhe paketës që shoqëron këtë projektligj, për mbikëqyrjen plotësuese të institucioneve të kreditit, shoqërive të sigurimit dhe firmave të investimeve, në një konglomerat financiar. Puna do të vijojë me hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili pritet të miratohet në Kuvendin e RSH-së.

Në procesin e negociatave, Autoriteti do të vijojë të japë kontributin e tij, si pjesë e grupeve ndërinstytucionale për kapitujt e tjerë, pjesë e kriterit ekonomik. Avancimi legjislativ drejt standardeve evropiane, mbështet zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje, përmes krijimit të mundësive të reja, duke i modernizuar më tej këto tregje.

Në tregjet e kapitalit me mbështetje të asistencës teknike Autoriteti do të angazhohet për rishikimin e vazhdueshëm të kuadrit ligjor dhe rregullativ për përafrimin e plotë me direktivat e BE-së dhe amendimet e tyre. Në këtë kontekst do të vijohet puna për përfarimin e legjislacionit vendas me direktivat dhe rregulloret e BE-së në tregjet e kapitalit. Veçanërisht do të vlerësohet mundësia për hartimin e një kuadri ligjor për Obligacionet e Mbuluara (*Covered Bonds*),

si dhe për harmonizimin e kuadrit rregullator vendas me atë të BE-së (EMIR) sa i përket infrastrukturës së tregut.

Autoriteti do të vijojë punën për përafrimin e legjislacionit me rregulloren më të fundit evropiane “Për Tregjet e KriptoAseteve”, e njohur si MiCA, në bashkëpunim edhe me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave, Agjencinë e Inteligjencës Financiare, etj.

3. Mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit

Mbrojtja dhe informimi i konsumatorit dhe investitorit, do të vijojnë të jenë në fokus të veprimtarisë së Autoritetit edhe gjatë 2024, si një nga objektivat themelore të strategjisë për edukim dhe përfshirje financiare 2023-2027.

Ligjet e miratuara vitet e fundit, si për tregjet e kapitalit, sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe të fondeve të pensionit private janë shoqëruar me akte nënligjore të Autoritetit, të cilat synojnë rritjen e kërkesave për transparencë dhe informacion, sipas standardeve ndërkombëtare. Autoriteti do të vijojë me plotësimin e kësaj baze ligjore edhe në ardhmen. Në këtë kuadër, Autoriteti do të vijojë bashkëpunimin me shoqatat e profesionistëve të tregjeve nën mbikëqyrje, për të realizuar planin e tij të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese.

Në tregun e sigurimeve, nëpërmjet një projekti me asistencë teknike të huaj, do të vlerësohet niveli i informimit të konsumatorëve dhe sjelljes së tregut, problematikat ku duhet ndërhyrë për të rritur përfshirjen financiare, në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorit/investitorit. Autoriteti do të krijojë një ekip trajnerësh që do të zhvillojnë aktivitete për ndërgjegjësimin dhe edukimin e konsumatorëve. Gjithashtu, Autoriteti do të vijojë përmirësimin dhe digjitalizimin e sistemit të ankesave, monitorimin e produkteve që ju ofrohen online konsumatorëve dhe investitorëve dhe forcimin e standardeve për rregullimin dhe monitorimin e praktikave promociionale. Kanalet e reja të komunikimit, mediat tradicionale dhe rrjetet sociale, format e tjera të komunikimit jo mediatik, në grupe më të vogla të synuara, do të vijojnë të përdoren për të rritur transparencën dhe komunikimin publik. Do të avancohet në hartimin e rregullave për krijimin dhe funksionimin e skemës së kompensimit të investitorëve, si një mekanizëm që nxit besueshmërinë në treg dhe që synon të mbrojë investitorët kundrejt riskut të humbjeve në rastin e paaftësisë së shoqërisë komisionere për të paguar detyrimet në para apo instrumente financiare, të mbajtura në emër të klientit dhe të administruara prej saj.

4. Zhvillimi i financimit të gjelbër dhe harmonizimi me praktikën evropiane

Sfidë e punës së Autoritetit është integrimi i faktorëve ESG për investime të qëndrueshme, rritja e ndërgjegjësimin të investitorit shqiptar dhe promovimit të standardeve ndërkombëtare të qëndrueshmërisë për të orientuar vendimmarrjen e tij drejt produkteve financiare të gjelbra. Autoriteti do të synojë promovimin dhe zbatimin e parimeve faktorëve mjedisorë, social dhe të qeverisje korporative (ESG) në praktikën e pjesëmarrësve të tregut. Suksesi i



objektivitet për riorientimin e kapitalit drejt investimeve të qëndrueshme dhe të gjelbra, kërkon bashkërendimin e përpjekjeve dhe angazhimin e të gjithë aktorëve, sektorit publik, atij privat, rregullatorëve dhe të gjithë palëve të interesit. Krijimi i një sistemi të unifikuar klasifikimi përmes vendosjes së rregullave për taksonominë, do të përmbajë kriteret që përcaktojnë se kur aktivitetet ekonomike apo investimet do të konsiderohen të gjelbra dhe qëndrueshme nga ana mjedisore, duke ofruar qartësi për të gjithë palët e interesuara. Autoriteti në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse do të përfshihet në krijimin e një taksonomie për aktivitetet e gjelbra, në linjë me praktikën dhe rregullat e BE-së për taksonominë.

5. Digjitalizimi dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit


Autoriteti do të punojë për implementimin e teknologjive të reja me qëllim përmirësimin e proceseve mbikëqyrëse dhe rregullatore, si dhe rritjen e sigurisë kibernetike. Ky proces do të realizohet duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet përgjegjëse për sigurinë kibernetike në vend dhe jashtë tij, për të siguruar që standardet e sigurisë të përmbushen në përputhje me legjislacionin në fuqi.


Prioritet kryesor do të vazhdojë të jetë siguria kibernetike, për shkak të rritjes së kërcënimeve dhe sulmeve ndaj sistemeve financiare. Për këtë do punohet për përmirësimin dhe forcimin e infrastrukturës ekzistuese, zbatimin e mekanizmave të avancuar të mbrojtjes së të dhënave dhe rritjen e kapaciteteve për menaxhimin e rreziqeve kibernetike. Implementimi i procedurave dhe rregulloreve sipas standardeve të sigurisë ISO/IEC 27001, do të ndihmojë në ruajtjen e sigurt të të dhënave, konfidencialitetit, integritetit dhe besueshmërisë së informacionit që disponon Autoriteti. Në këtë proces AMF është mbështetur nga Zyra e Asistencës Teknike (OTA) e Departamentit Amerikan të Thesarit.

Përmirësimi i sistemeve të raportimit për tregjet që mbikëqyren nga AMF, është një proces i vazhdueshëm në kuadër të digjitalizimit dhe modernizimit të sistemeve. Për këtë qëllim në mënyrë periodike do të punohet dhe mendohet në drejtim të automatizimit të procesit të grumbullimit të të dhënave, rritjes së transparencës dhe sigurimit të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, etj. Do të shtohen forma të reja raportimi që do të ndihmojnë në procesin e vendimmarrjes dhe do të mundësojnë një pasqyrim më transparent të treguesve tekniko-financiarë të industrisë. Automatizimi i procesit të raportimit dhe menaxhimit të të dhënave do të ndihmojë në ruajtjen e integritetit të tregut financiar dhe në menaxhimin më efikas të tregjeve nën mbikëqyrje.

Autoriteti, po bashkëpunon me shoqëritë e sigurimit në drejtim të proceseve digjitalizuese të kontratave të sigurimit, proces i cili do të automatizojë dhe lehtësojë lëshimin dhe verifikimin e policave të sigurimit, duke rritur efikasitetin, transparencën dhe sigurinë e të dhënave. Në të njëjtën kohë do të vijojë puna për procesin e digjitalizimit të procedurave të licencimit të agjentëve të tregut të sigurimeve dhe më tej do të vijohet edhe me aktorë të tjerë të këtij tregu.

SHTOJCA A
STRUKTURA ORGANIZATIVE E AMF-SË, 2024





Auditimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2024

Në vëmendje të Drejtimit dhe Menaxhimit të Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Të nderuar

Ne jemi emëruar për të kryer auditimin e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024 për AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE (ose Institucioni) të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Bazuar në kontratën e lidhur për kryerjen e angazhimit, ne kemi audituar në përputhje me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, Pasqyrat Financiare të AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe në përfundim të angazhimit kemi lëshuar Raportin e Auditimit që mban datën 21.03.2025.

Gjatë planifikimit dhe kryerjes së procedurave tona të auditimit mbi pasqyrat financiare të AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024; ne morëm në konsideratë strukturën e kontrollit të brendshëm të Institucionit në mënyrë që të përcaktonim procedurat e auditimit tonë me qëllim shprehjen e një opinioni mbi pasqyrat financiare dhe jo për të dhënë siguri specifike mbi strukturën e kontrollit të brendshëm. Ne kemi raportuar vetëm ato çështje që kanë qenë në vëmendjen tonë gjatë procesit të auditimit duke përfshirë dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm deri në masën e nevojshme për të përcaktuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të tjera. Puna jonë nuk ka pasur si qëllim kryesor zbulimin e dobësive, zbulimin e mashtrimeve ose parregullsive të ngjashme dhe si rrjedhojë nuk duhet të merret si bazë që asnjë dobësi tjetër nuk ekziston.

Çështjet e ngritura në këtë leter janë vetëm ato të cilat kanë qenë në vëmendjen tonë gjatë procesit të auditimit dhe që ne besojmë se duhet të sillen në vëmendjen tuaj. Nuk përfshihen të gjitha çështjet e mundshme, dhe në veçanti, ne nuk mund të jemi përgjegjës për raportimin e të gjitha rreziqeve ose të gjitha dobësive të kontrollit të brendshëm. Rrjedhimisht, komentet në këtë leter i referohen vetëm çështjeve, të cilat kanë ardhur në vëmendjen tonë gjatë rrjedhës normale së punës sonë dhe nuk paraqet të gjitha përmirësimet e mundshme, të cilat mund të identifikohen nga një shqyrtim i veçantë.

Ky raport lëshohet vetëm për qëllim informativ dhe për përdorim nga Drejtimi dhe Menaxhimi i AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE si dhe nga pjestarë të tjerë brenda Institucionit, e për rrjedhojë nuk mund të përdoret nga persona të tjerë. Ne duam të shprehim vlerësimin tonë ndaj drejtimit dhe punonjësve për ndihmesën dhe bashkëpunimin gjatë procesit të auditimit.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

Nuriona Bërdica
Audituese Ligjore
Partnere Angazhimi
Kreston Albania shpk



Tiranë, më 21/03/2024

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë në Lekë)

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVE		
Aktivët afatgjatë		
Aktivët afatgjatë materiale	59,196,154	6,158,298
Aktivët afatgjatë jomateriale	10,970,784	14,627,712
Totali i aktiveve afatgjatë	70,166,938	80,786,010
Aktivët afatshkurtra		
Llogari të arkëtueshme	51,640,560	69,107,917
Paradhënie dhe të ardhura të përlogaritura	2,969,940	2,454,202
Garanci të dhëna	463,580	463,580
Investime në depozita dhe Bono Thesari	163,538,500	160,393,600
Mjetet monetare në arkë e në bankë	86,505,526	58,855,842
Totali i aktiveve afatshkurtra	305,118,106	291,275,141
Totali i aktiveve	375,285,044	372,061,151
KAPITALI		
Fonde bazë	119,287,505	119,287,505
Rezerva	201,842,000	184,758,000
Totali i kapitaleve të veta	321,129,505	304,045,505
DETYRIMET		
Grante për asete		
Totali i detyrimeve afatgjatë	6,685,262	7,041,061
Totali i detyrimeve afatgjatë	6,685,262	7,041,061
Detyrime afatshkurtra		
Llogari të pagueshme	1,910,145	1,273,874
Detyrime për tatim taksë	9,936,585	8,853,470
Detyrime nga shoqërive të mbikëqyrura	10,502,043	29,271,203
Të tjera të pagueshme	20,430	342,736
Fondi i provizionit	25,101,074	21,233,302
Totali i detyrimeve afatshkurtra	47,470,277	60,974,585
Totali i detyrimeve	54,155,539	68,015,646
Totali i kapitalit dhe kapitalit	375,285,044	372,061,151



Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(Vlerat janë në Lekë)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga tregu i sigurimeve	371,342,557	46,556,475
Të ardhura nga tregjet kapitale	3,513,113	3,139,020
Të ardhura nga tregu i sipërmarrësve të investimeve kolektive	30,949,373	27,468,954
Të ardhura nga tregu i pensioneve vullnetare	4,549,790	3,820,175
Totali i të ardhurave	410,354,833	380,984,624
Zbritje për të ardhurat të trajtuara paradhenje e subjekteve të mbikeqyrura për periudhën pasardhese	(10,502,043)	(29,271,203)
Totali i të ardhurave përfshire paradhenjet	399,852,790	351,713,421
Të ardhura të tjera	5,741,099	9,775,510
Totali i të ardhurave	405,588,702	361,488,931
Shpenzime personeli	(315,304,358)	(274,676,777)
Shpenzime administrative	(56,638,671)	(54,636,202)
Shpenzime amortizimi	(11,583,643)	(15,036,607)
Total shpenzime	(383,526,672)	(344,349,586)
Të ardhura nga interesat e depozitave	3,914,147	4,130,869
Fitim/humbje nga kembimet valutore	(8,897,364)	(16,799,214)
Rezultati i vitit	17,084,000	4,471,000

